RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
"AUDITIMIN FINANCIAR"

BASHKIA PRRENJAS

Tiranë, 2022

🕮 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	**PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**	**3 – 13**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit……	**3 - 3**
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve……	**3 – 12**
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit…….	**12 – 13**
II	**HYRJA**	**13 - 18**
	a. Objektivat e auditimit..... *b. Qëllimi i auditimit.....* *c. Identifikim i cështjes.....* *d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....* *e. Përgjegjësitë e Audituesve.....* *f. Kriteret e vlerësimit .....* *g. Standardet e auditimit.....* *h. Metodat e auditimi .....* *i. Dokumenti i auditimit.....*	
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**18 - 72**
1.	**Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**	**18 – 20**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit.**	**20 - 72**
2.1	*Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm*	*20 – 21*
2.1.2	*Mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm*	*21 – 22*
2.2.	*Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit,.....*	*22 – 36*
2.2.6	*Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.*	*36 - 54*
2.3	*Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021.....*	*54 - 71*
2.4	*Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditim i fundit.....*	*71 – 72*
IV.	**GJETJE DHE REKOMANDIME**	**72 – 100**
V.	**ANEKSE**	**100 - 132**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e vijim KLSH)*, në periudhën nga data 30.05.2022 deri më datë 24.06.2022, realizoi auditimin financiar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Prrenjas, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në hartimin e pasqyrave financiare viti 2021, hartimin dhe zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.
Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.
Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ dhe të ardhurave të munguara, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.
Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Prrenjas për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një opinion të ***pamodifikuar, me theksim çështjeje*** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2021) dhe të të ardhurave.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara për vitin 2021 paraqitet në masën 82 %, ku nga vlera planifikuar prej 727,420 mijë lekë është realizuar vlera prej 496,829 mijë lekë, kjo nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve dhe parashikimit të investimeve dhe pa dokumentacion të rregullt (mungesë projektesh), veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk	I lartë	22-36	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social Bashkia Prrenjas, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave dhe pa dokumentacionin përkatës ligjorë. Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), të cilat janë mbajtur pjesërisht konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin **2021** ato janë në shumën **35,554 mijë lekë.** Sipas të dhënave të buxhetit të vitit 2021, konstatohet se nga bashkia nuk është planifikuar për likujdim e gjithë vlera e faturave të palikujduara e cila është në shumën 35,554 mijë lekë, por është planifikuar në masën 44.5% ose në vlerë 38,395 mijë lekë, *nga e cila:* për llog. 602 në shumën 11,757 mijë lekë dhe për llog 230+231 në shumën 22,819 mijë. *Situata financiare e bashkisë Prrenjas, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 10% të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.* Mos planifikimi i plotë e vlerës së faturave të palikujduara me miratimin e buxhetit, si dhe mos zbatimi i radhës së pagesës, janë veprime në kundërshtim me nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" me ndryshime; ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar. pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" pikat 82-91.			dhe në kontabilitet. Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Prrenjas. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.
2	KLSH-ja me shkresën e saj nr. 1117/17 prot, datë 17.01.2022 ka dërguar në Bashkinë Prrenjas rekomandimet e auditimit. Bashkia Prrenjas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk ka kthyer përgjigje**, duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor.	I mesëm	71-72	Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 117/17, datë 17.01.2022 "*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në*

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Bashkia Prrenjas duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 17.6.2022, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA me shkresën nr. 1117/17, datë 17.01.2022. Nga Bashkia Prrenjas nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit. Bashkia Prrenjas ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve, por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak). - *Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar* **11 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa. - *Për masa mungesë të ardhurash* janë rekomanduar **6 masa** me vlerë **58,782,491 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 58,190,294, nga e cila likujduar vlera 12,840,136 lekë dhe mbetur per likujdim vlera 45,350,158 lekë, si dhe nuk është zbatuar një masë në vlerën 592,197 lekë. - *Për masa disiplinore*, janë rekomanduar gjithsej **15 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenet 15 dhe 30, si dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50-Auditimi i jashtëm.			*Bashkinë Prrenjas*", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për*: - **6 masa** organizative. - **6 masa** mungesë të ardhurash në vlerën **45,942,355 lekë.** - Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Shërbimit Civil, për masat e marra nga Komisioni Disiplinorë për 15 punonjësit e Bashkisë Prrenjas, referuar shkeljeve të evidentuara nga raportin përfundimtar të auditimit dhe përcjellë subjektit për zbatim me shkresën nr. 114/17, datë 17.01.2022. Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH.
3	Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 627,348,792 lekë, përveç 30 objekteve, pjesa tjetër nuk është pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë: - llog 210 "*Toka troje terrene*", elementë në vlerën neto 4,918,360 lekë -llog. 211 "*Pyje plantacione*", elementë në vlerën neto 22,928,105 lekë, -llog. 212 *"Ndërtesa e konstruksione*", objekte me vlerën neto 599,502,327 lekë -Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dukumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.	I lartë	54-71	Bashkia Prrenjas duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik, të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
4	Llogaria 202 "*Studime dhe Kërkime*" paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto 13,137,127 lekë, dhe në fund të vitit 2020 në vlerën neto 6,037,127 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të 2	I lartë	54-71	Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	projekteve infrastrukturore me vlerë 7,100,000 lekë. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Pikërisht kjo vlerë konsiston në 5 projekte, disa prej tyre të trashëguara dhe nga ish komunat sot njësi administrative, me vlerë kontabël neto prej 1,173,980 lekë.			investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rishihet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 1,173,980 lekë.
5	Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 42,08% të aksioneve të "U.....E" sh.a. me *NUIS "J....V"* e cila është shoqëri aksionere me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtje e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve*". Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 415,720 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **415,720,000** lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 42,08 % aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Prrenjas në "U.....E " Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021 ,më konkretisht në llogarinë ***26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta"*** në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 *"Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*" . Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **174,935,046** lekë dhe investori është Bashkia Prrenjas. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **174,935,046** lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.	I lartë	54-71	Nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 42,08% në kapitalin aksionar të "U.....E " sh.a me vlerë kontabël **174,935,046** lekë në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
6	Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, rezulton se gjendja e debitorëve nga taksat/ tarifat vendore më 31.12.2021 paraqitet në shumën **62,185,903 lekë**, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD. Kjo vlerë vjen në rritje nga viti 2020 në shumën	I lartë	36-54	Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **26,042,222 lekë**, *si më poshtë vijon*: *a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	14,287,806 lekë, pasi nga vlera 47,898,097 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera 62,185,903 lekë. Referuar të dhënave të tabelës konstatohet se niveli i borxhit është 77.5% e planit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore dhe 16.2% e shpenzimeve buxhetore, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie në menaxhimin e borxhit fiskal. Nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas janë llogaritur kamatëvonesa në vlerën 759,914 lekë, vlerë kjo shumë herë më e vogël se vlera reale e llogaritjes së tyre, pasi sipas dispozitave ligjore (0.06%), detyrimi për kamatëvonesën duhej të ishte në vlerën **4,562,475 lekë** (24,303,147 * 0.06% x 365 – 759,914), më 31.12.2021. Vlera totale e debisë (borxhit tatimor) prej **65,748,378 lekë** ***(62,185,903 lekë*** *detyrime të papaguara dhe* ***4,562,475 lekë*** *kamatëvonesa)*, duhet të kontabilizohet dhe t'u njoftohet subjekteve përkatëse nga ana e administratës së Bashkisë Prrenjas **dhe përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.** Për një pjesë të subjekteve të cilat janë debitorë në vite, nuk janë zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre sipas ligjit, duke bërë që këto subjekte të kthen në debitorë pa shpresë arkëtimi, **gjithsej 55 subjekte me vlerë 10,729,869 lekë 16% e totalit të detyrimeve.** Në lidhje me masat e marra, konstatohet se nga bashkia është zbatuar vetëm bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe bllokimi në Drejtorinë Rajonale ASHK Elbasan, duke kërkuar arkëtimin e vlerës 11,254,342 lekë, *nga e cila arkëtua vlera 3,480,2756 lekë.* Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngese nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është zbatuar. Mungon bashkëpunimi me Policinë Bashkiake për arkëtimin e tyre. Gjithashtu dhe në rastet kur është zbatuar, evidentohet se vlera e zbatuar në krahasim me nivelin e tyre është në masën 17.7%, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie. Nga të dhënat evidentohet se një numër subjektesh me status pasiv/mbyllur paraqiten me situatë debitorë, gjithsej **5** me vlerë **566,397 lekë**, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Librazhd, po ashtu dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e			urdhër bllokimet e llogarive bankare. *b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),. *c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar*, Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. *d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave <u>të bëhet *kallëzim penal*</u>. **e-** Të bashkërendojë punën me QKB Dega Librazhd për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq. f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve. g- Të bëhet llogaritja e saktë e kamatëvonesave për të gjithë subjektet të cilat nuk likuidojnë në afat detyrimet sipas njoftim detyrimit nga momenti i lindjes deri në datën e pagesës së detyrimit. Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas të bashkëpunojë me QKB Dega Librazhd dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan për evidentimin e subjekteve me status pasiv/mbyllur nëse ushtrojnë ose jo aktivitet dhe të mos lejohen të mbyllin veprime pa bërë likujdimin e detyrimeve të prapambetura, për të shmangur fenomenin e krijimit të borxhit të keq dhe pamundësinë e gjetjes së tyre për arkëtim.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	tyre në borxh **të paarkëtueshëm ose të keq**. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995,"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 - Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – "*Çregjistrimi i subjekteve tatimore*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", me ndryshime.			
7	Në totali e detyrimeve të prapambetura *(62,185,903 lekë)*, konstatohet se peshën kryesore e zëne detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 64% e totalit të detyrimit ose me vlerë **39,706,156 lekë**. Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Prrenjas nuk kishte aktmarrëveshje me Nd/ Ujësjellës Kanalizime dhe menaxhimi bëhej nga vetë bashkia nëpërmjet postës *(shpërndarjen e njoftim detyrimit)* dhe për njësitë e largëta nga punonjësit e taksave. Një menaxhim i tillë është jo frytdhënës për bashkinë, pasi niveli i detyrimeve debitore vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku për vitin 2021 kemi një rritje për vlerën 22,260,537 lekë, *pasi nga vlera 17,445,619 lekë në vitin 2020 në vitin 2021 paraqitet në vlerën 39,706,156 lekë*. Gjithashtu evidentohet fakti se nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas për abonentët familjare nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05. i ndryshuar kreu IX pagesa dhe rimbursim i tatimit, Neni 74 "*Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor*", ku përcaktohet se: "1. Tatimpaguesi shlyen detyrimet tatimore brenda afateve të parashikuara në ligjin tatimor përkatës. 2. Kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor, në përputhje me kreun VIII të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose vlerësohet të ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë. Në rastet kur një person i tatueshëm nuk e paguan shumën e plotë	I lartë	36-54	Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve të marri masa për lidhjen e aktmarrëveshjes si agjent tatimorë më Ndërmarrjet e Ujësjellësit Librazhd/Prrenjas, për një mirëmënaxhim më të mirë detyrimeve nga abonentët familjarë dhe jo vetëm. Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **39,706,156 lekë** nga abonentët familjarë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	të detyrimit tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, ai detyrohet të paguajë kamatëvonesa 0,06% mbi shumën e detyrimit tatimor të papaguar duke filluar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme për tu paguar, deri në datën në të cilën pagesa kryhet.”			
8	Nga auditim mbi menaxhimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) dhe të ndërtimeve pa leje (ALUIZNI-t), rezulton se *për vitin 2021* është realizuar në masën 134% ose nga vlera 7,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 9,367 mijë lekë. Ky tejkalim vjen nga mungesa e bashkëpunimit midis drejtorive mbi mundësinë e lejeve të ndërtimit që Drejtoria e PZHT ka parashikuar për vitin ushtrimorë 2021. Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet pa leje *(ALUZNI-t)*), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën **1,597,190 lekë,** *e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas*, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve**.** Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Prrenjas ti jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalimizt dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.	I lartë	36-54	Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **1,597,190 lekë** nga abonentët familjarë. Kryetari i Bashkisë Prrenjas nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Elbasan, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
9	Nga auditimi i regjistrave të subjekteve fizik/juridik mbi ngarkesën fiskale të detyrimeve vjetore për taksat e tarifat vendore në vitin 2021 (sipas ligjit dhe VKB), rezulton se për një pjesë të subjekteve me aktivitet *HEC, përpunimi i peshkut/mishit, karriere guri(gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, shfrytëzim minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjor dhe industri te tjera te cilat ndikojnë ne mjedis*, nuk është bërë i munduar aplikimi dhe arkëtimi i tarifës për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit, kjo për 7 subjekte me vlerë **1,850,000 lekë**, si mungesë të ardhurash ne buxhet, në kundërshtim me kapitullin B pika 16 *Tarifa per mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit*, të Vendimit të KB nr. 97, datë 01.12.2020 “*Për miratimin e*	I lartë	36-54	Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e mjedisit për **7** subjektet në vlerë **1,850,000 lekë**, respektivisht: **- vlera 350,000 lekë,** *nga shoqëria **“G.I”** shpk, me administrator SH.K.* **- vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **“F.A”** shpk, me administrator A.G.* **- vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **“A.A”** shpk, me administrator H.H.* **- vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **“D.E”***

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	paketës fiskale të vitit 2021".			*shpk, me administrator L.K.* **- vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"J.O"** shpk, me administrator F.P.* **- vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"E.T"*** shpk. **- vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"V.C."** shpk, me administrator V.C.*
10	Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se në këtë njësi vendore ushtrojnë aktivitet 6 subjekte me destinacion tregtim karburanti. Në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk aplikimi i taksës nuk është i saktë, po kështu dhe mënyra e arkëtimit nuk është zbatuar sipas ligjit. Sipas bazës ligjore të mësipërme, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e liçencës duhet të paguajnë si më sipër. Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifat vendore deri në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën 2,454,032 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet e bashkisë Prrenjas, kjo për **4 subjekte**, *respektivisht*: shoqëria "L.L" shpk në vlerën 1,000,00 lekë, subjekti "L.I" shpk ,e vlerë 900,000 lekë, subjekti "K." shpk me vlerë 232,949 lekë dhe subjekti "G.R" shpk me vlerë 321.083 lekë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".	I lartë	36-54	Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve bashkia Prrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrat9ive e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,454,032 lekë nga 6 subjektet**, respektivisht; - **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti "L. LL" ShPK - **vlera 900,000 lekë** nga subjekti "K.I" ShPK; - **vlera 232,949 lekë** nga subjekti "K." ShPK; - **vlera 321,083 lekë** nga subjekti "G.R" ShPK
11	Sipas evidencës së të ardhurave për vitin 2021, rezulton se të ardhurat nga qiratë janë realizuar në masën 89%, ku nga vlera e planifikuar prej 6,200,00 lekë është arkëtuar vlera 5,533,081 lekë**.** Nga auditimi i dokumentacionit mbi kontratat e qirave të lidhura nga Bashkia Prrenjas, konstatohet se operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontratë qiraje me aktivitet HEC, Gurore, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, etj, duke përllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 8,792,005 lekë, nga e cila likujduar vlera 6,001,818 lekë dhe mbetur pa likujduar vlera **3,816,519 lekë** (*sipas aneksit 2.6.4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), respektivisht:	I lartë	36-54	Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për: - Subjektet të cilat nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale sipas afateve të përcaktuara në kontratë të llogaritet, kontabilizohet dhe arkëtohen **kamatëvonesat në vlerën 289,239 lekë*)*,** si e ardhur munguar në buxhet. - Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga **15 subjekte** që ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	a- 8 subjekte për HEC me vlerë kontrate vjetore 5,881,823 lekë. *b- 2 subjekte shfrytëzim karrierë me vlerë kontrate 74,000 lekë.* *c- 2 subjekte veprimtarie ekonomie me vlerë kontrate 41,202 lekë.* *d- 4 subjekte me veprimtari telefonisë celulare me vlerë kontrate vjetore 906,510 lekë.* *e- 6 subjekte për kullota me vlerë kontrate 80,300 lekë* Për subjektet të cilat kanë lidhur kontratë dhe nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale, nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), referuar pikës 5.5 të nenit 5 të kontratës, nuk janë llogaritur penalitet në masën 0.1% jo më shumën se 10%, **duke evidentuar një kamatëvonesë në vlerën 289,239 lekë** *(sipas aneksit 2.6.5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)***, si e ardhur munguar në buxhet**. Sipas kërkesës së bere nga Bashkia Prrenjas në adresë të AKBN në lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore (karriera), nga kjo e fundit është konfirmuar me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 se në këtë njësi vendore ushtrojnë këtë lloje aktiviteti **19 subjekte**, ku dy prej të cilave janë me pezullim, dy kanë kontratë me bashkinë dhe **15 subjekte** ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës. Me shkresën nr. 569, datë 18.2.2022, Bashkia Prrenjas i ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që për 4 subjekte është kërkuar heqje nga fondi pyjore i sipërfaqeve sipas lejes minerale. Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2050/1, datë 28.2.2022 është kthyer përgjigje se mungon një pjesë e dokumentacionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës dhe nga bashkia nuk është vijuar me tej. Detyrimi i munguar në buxhetin e bashkisë Prrenjas vetëm për një vit ushtrimorë nga mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi përllogaritet në **shumën 20,488,050 lekë, e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*). Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe			ministrinë e linjës deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në vlerën **20,488,050 lekë, për periudhën e shfrytëzimit të sipërfaqeve, si një e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale. - Sipërfaqen rrugë kalimi dhe vend depozitimit që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Prrenjas. 15 shoqëritë që shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore/kullosore pa kontratë me Bashkinë Prrenjas, duke vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Prrenjas, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	shërbimin pyjor", të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor", me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2021, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një "***Opinion pamodifikuar, me theksim çështjeje"***, pasi ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që konstatohet se nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.

Gjithashtu u evidentuar përdorimin pa efektivitet, efiçencës dhe ekonomicitet (3-E), të fondeve të prokuruar në vlerën 22,597 mijë lekë, në mos menaxhimi i mirë i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë për vlerën **28,120 mijë lekë**, mos arkëtimi dhe mos zbatimi i plotë i procedurave ligjore në arkëtimin e debitorëve me vlerë **67,345 mijë lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë Prrenjas.

Opinioni i auditimit.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Prrenjas, për vitin ushtrimor 2021 , të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit për vitin 2021 prej 2% (*vlerën 6,431 mijë lekë (Aneksi 1, bashkëlidhur Raport Auditimit*) për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje[1]:
*Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705[2], dhe ISSAI 1200[3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi "**Theksimi i Çështjes**".*

Baza për opinionin:
Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Prrenjas, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.

***Theksimi i çështjeve*:**
Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Prrenjas, sa i takon llogarive të mëposhtme**:**
Llogaria 202 "Studime e kërkime" është pasqyruar më shumë për vlerën 1,173,980 lekë
Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" është pasqyruar më pak për vlerën 174,935,046 lekë;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Prrenjas.
Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Prrenjas, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" .

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo

[1] ***Opinioni i pamodifikuar me theksim cështjeje.*** *Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.*

[2] *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

[3] *Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi,*

anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 515/1, datë 27.5.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 27.5.2022 deri në datë 24.6.2022, në subjektin Bashkia Prrenjas, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, u krye auditimi *Financiar* nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ**, *Përgjegjës Grupi*
2. **E.C**, *Auditues*

a- Objektivat dhe qëllimi i auditimit: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- ***Objektivat e auditimit*** synojnë***:***

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-Nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit.

-Nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare.

<u>Procedura e ndjekur</u>*:* Raport Auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Prrenjas, pasi nga subjekti audituar me shkresën nr. 2237/3, datë 10.08.2022 janë paraqitur kundërshtitë mbi Projektraport Auditimi dërguar me shkresën nr. 515/12 datë 22.07.2022.

Grup i auditimit pasi analizojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim kundërshtitë e subjektit, mori në konsideratë ato që kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion shoqërues, ndërsa gjetjet e tjera të cilat sipas grupit të KLSH nuk kishin argumentin e duhur ligjorë, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar auditim, i cili i dërgohet subjektit për zbatim dhe përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

b- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Prrenjas, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiare në fuqi.

c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar*:* Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) **N.B.** Kryetar i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ) **S.K.**, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Prrenjas, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34, pika 6, neni 65, pika 1 dhe neni 91, pika 1.3.

d- Përgjegjësitë e Audituesve.
Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Prrenjas dhe menaxhimin e të ardhurave. Auditimi është kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

e- Kriteret e vlerësimit.

- ✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
- ✓ Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar.
- ✓ Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-^{së} ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020.
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve.
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi "Auditimin e përputhshmërisë", Manualet e Auditimit Financiar, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore".
- ✓ Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", ligji nr. 137/2020, datë

16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021" dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.

- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte te monitorimit te buxhetit te Njësive te vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26,datë 27.12.2007, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006".
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 05, datë 21.2.2022" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".

f- <u>Standardet e auditimit</u>:

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

 ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*" që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

 Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t.

INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

 Manuali i Auditimit Financiar të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

i- <u>Dokumentimi i rezultateve të auditimit</u>*:* Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

j- <u>Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit</u>. Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i** cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231), ku vlera e precizonit për vitin 2021 në shumën 6,431 mijë lekë (gabim lejuar), *të dhëna të paraqitura në Aneks 1 bashkëlidhur Raport Auditimit*.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c)

funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon[4].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike **(ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partiture, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

k- <u>Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit.</u>
<u>1. Kontrolli aritmetik</u>.
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*
<u>2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese</u>.
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
<u>3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese</u>.
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.
<u>4. Kontrolli i vlerësimit</u>.
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
<u>5. Konfirmim nga të tretët.</u>

[4] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
7. Intervistimi
8. Raporte dhe Informacione

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Prrenjas u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në hartimin e pasqyrave financiare, materiale dhe jo të përhapura, si dhe të meta e dobësi në drejtim të shpenzime jo sipas 3-E, të menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, etj.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Nga subjekti Bashkia Prrenjas me shkresën përcjellëse nr. 2273/3, datë 10.08.202, në momentin e përgatitjes së Raport Auditimit u paraqitën kundërshtitë mbi problemet e konstatuara nga grupi i auditimit dhe të reflektuara në Projektraport Auditimit dërguar subjektit me shkresën nr. 515/12, datë 22.07.2022 për vërejtje.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.
Bashkia Prrenjas është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Prrenjas.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik: Bashkia Prrenjas i përket Qarkut Elbasan, kufizohet në veri me Bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë,

në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është Qyteti i Prrenjasit është krijuar si njësi administrative në vitin 1958. Përbëhet nga 4 Njësi Administrative: Nj.A. Prrenjas mbulon Qyteti Prrenjas, Fshatrat; Prrenjas-Fshat, Rrashtan; Nj. A. Qukës, mbulon Fshatrat; Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash, Pishkash Veri; Nj. A. Rrajcë, mbulon Fshatrat; Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urak; Nj. A. Stravaj, mbulon Fshatrat; Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Sopot. Mbulon një territor afërsisht 323 km^2 dhe me popullsi sipas regjistrit të gjendjes civile 33,031 banorë.

Bashkia Prrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re.
Zonat e Rrajcës, Qukësit dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmtuar pyjet në një masë të gjerë.
Bashkia e re e Përrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Por ky avantazh nuk është shfrytëzuar deri më sot për nxitjen e sipërmarrjes dhe shtimin e vendeve të punës.
Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Përrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.
Bashkia e Përrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.
Etnografia e pasur me këngët dhe vallet karakteristike të zonës do të ndihmonin për këtë qëllim, por mungesa e infrastrukturës rrugore i bën këto resurse të paarritshme nga turistët.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit.

Pika 2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Titulli gjetjes 1: *Mbi mangësitë e konstatuara në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

Situata:
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm sipas komponentëve u konstatua se në lidhje me:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit":
Bashkia Prrenjas nuk ka Kod të Etikës, por në nenet 13 dhe 14 të Rregullores së Brendshme me vendim nr. 38 date 04.03.2019 me nr. prot 697, ku ne nenin 13 është përfshirë disiplina formale dhe administrative me 8 rregullat e saj dhe ne nenin 14 është përfshirë etika per punonjësit e bashkisë Prrenjas dhe kodi i veshjes me 10 rregullat e saj. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste. Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, nuk janë hartuar rregullore. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për përformancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga UK sha Librazhd ,Bashkia Prrenjas e cila është aksionere me 49 % te aksioneve mungojnë raportimet periodike për përformancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat . Mungon një program strategjik institucional me prioritetet dhe objektivat dhe plan-veprimet e realizimit të tyre. Në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës. Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune, por nuk janë rishikuar për çdo vit dhe nuk janë miratuar në DAP. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme

Komponenti "Menaxhimi i Riskut"
Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.
- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Është përcaktuar koordinatori i riskut Kryetari i bashkisë N.B., por nuk është përcaktuar grupi i punës së riskut. Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku te bëhet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve dhe nuk janë përcaktuar veprime për të të adresuar mangësitë në disa fusha kryesore si: në fushën e taksave dhe tarifave vendore, në fushën financiare për ndjekje e debi-kredive dhe akumulimi i borxhit dhe në fushën e prokurimeve publike, *duke mos* identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit

Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"
Bashkia Prrenjas nuk disponon nje regjistër te aktiveve afatgjata materiale. Bashkia Prrenjas nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.
Nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT si dhe mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari.

Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
Komponenti: "Monitorimi"
Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
Në Bashkinë Prrenjas mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Prrenjas mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. Në Bashkinë Prrenjas aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.
Kriteri:
Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitullin III, pika 3.1. ligjit nr. 119/2014 'Për të drejtën e informimit' nenet 4,8
Ndikimi/Efekti:
Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Shkaku:
Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.
Rëndësia: I mesëm
Për këtë rekomandojmë:

Bashkia Prrenjas, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së risqeve, për miratimin dhe përmirësimin e rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike, të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara dhe ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu të kryejnë programe zhvillim të trajnimeve nga punonjës brenda Bashkisë si dhe të punohet për plotësimin e kërkesave të komponentëve të MFK.

Nënpika 1.2. ***Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;***
Nënpika 1.3. ***Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.***

Titulli gjetjes 1: *Mbi mangësitë e konstatuara në organizimin, funksionimin dhe aktivitetin e Auditit të Brendshëm.*

Situata:
Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 100%. NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit

mungojnë: projektdrafti i programit te auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim "vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Në disa raste formulimi i gjetjeve ka mangësi, pasi situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, në ndonjë rast nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si apo nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra "në zbatim të akteve ligjore", duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagesave sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj. (*hollësisht trajtuar në aneksin 2.2 bashkëlidhur Raport Auditimit).*

Kriteri:

Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 11,neni 12, shkronja "d", neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016", Kapitulli II 2.4.1 "Auditimi i përputhshmërisë" dhe 2.4.2 "Auditimi financiar"; Kapitulli III, pika 3.5;Kapitulli IV pika 4.1.1 "planifikimi i një angazhimi auditimi", pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" pika 6.1 "Niveli i dokumentimit";

Ndikimi/Efekti:

Mosrealizim dhe sigurim të cilësisë së veprimtarisë audituese të Auditit të Brendshëm.

Shkaku:

Realizimi i auditimeve jo në shkallën dhe nivelin e duhur në mospërputhje me kriteret e pranuara, veprime të cilat mban përgjegjësi Përgj/ Sektorit të Auditit të Brendshëm B.K.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Auditit të Brendshëm të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB, si dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Pika 2.2 e programit. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

- Programimi i PBA 2020-2022 dhe programimi i buxhetit vjetor 2020 dhe 2021

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2020-2022, u konstatua se janë

realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.
- Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si menaxhimi i mbetjeve dhe shërbimeve publike, pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, mirëmbajtja e segmenteve rrugore, programi i administrimit të pyjeve dhe bujqësisë, mirëmbajtja e kushteve për infrastrukturën arsimore, konvikteve, promovimi i politikave kulturore dhe sociale, zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe ekspozitave. Është bërë analiza për pagat dhe janë llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimit me totalin.

Programe buxhetore afatmesme janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore", *nga ku konstatohet se*:

Nuk janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative, sektorët e Bashkisë, sektori i shërbimeve etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

PBA dhe buxhetet janë miratuar në Këshillin Bashkiak, *konkretisht*:

PBA 2020-2022, bashkë me buxhetin vjetor 2021, janë miratuar me VKB nr. 66, datë 13.9.2019

Për vitin 2020, miratuar me VKB nr. 14, datë 26.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 27/1 datë 14.01.2020.

Për vitin 2021, miratuar me VKB nr.107, datë 8.01.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.31/1, datë 15.01.2021.

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2020		Plani i Viti 2021	
		Të ardhurat	Shpenzime	Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	25,561,402		12,147,466	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	101,489,203		92,630,505	
3	Trashëguar nga transferta specifike	5,005,365		25,960,652	
4	Të trashëguara nga FZHR	0		0	
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	60,000,000		80,070,000	
6	Granti	180,645,399		184,058,307	
7	Transferta specifike	91,751,523		93,871,278	
8	Mbrojtje Civile	0		2,411,715	
9	Te trashësuar nga ŵorld vizion	37,880		1,307,144	
10	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)	0	189,766,603	0	211,869,681
11	Shpenzime operative (602)	0	61,782,551	0	81,793,030
12	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar	0	199,705,938	0	186,575,497
13	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë	0	9,897,800	0	6,000,000
14	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit	0	0	0	0
15	Shpenzime (603+604+606)	0	3,300,000	0	2,500,000
16	Shpenzime nga ŵorld vizion (600,601,602,231)	0	37,880	0	1,307,144
17	Shpenzim per mbrojtjen civile	0	0		2,411,715
Totali i buxhetit		**464,490,772**	**464,490,772**	**492,457,067**	**492,457,067**

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2020-2022 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2020-2022	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	211,870	192,969	18,901
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	87,305	75,291	12,014
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	61,236	61,870	-634
4	Investime nga FZHSH	0	0	0
	Total i planit fillestar	**360,411**	**330,130**	**30,281**
	Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit			
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	0	0	
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	3,605	0	
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	1,660	0	
8	Investime nga FZHSH	0	0	
9	Pagesa 5 % garanci	3,618	0	
	Totali shtesa + ndryshime	**8,883**	**0**	
	Plani përfundimtar			
	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	215,475	192,969	
	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	87,305	75,291	
	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	62,896	61,870	
	Investime nga FZHSH	0	0	
	Pagesa 5 % garanci	3,618	**0**	
Shuma e planit vjetor		**369,294**	**330,130**	

- *Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura*

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Qeverisja Qendrore të granteve nëpërmjet transfertës të pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

Nga të dhënat konstatohet se gjendja e kreditorëve në fund të vitit 2021 (fatura të palikujduara), paraqiten në vlerën 35,554 mijë lekë, nga e cila janë planifikuar në buxhetin e vitit vijuar vlera prej 38,395 mijë lekë ose 44.5% e totalit, ku vlera 12,735 mijë lekë janë të llog.602 dhe vlera 22,819 lekë janë të llog. 230-231.

Detyrimet kreditore në fund të periudhës 31.12.2021 janë të njëjta me ato të paraqitura në llog 486 të pasqyrave financiare viti 2021.

-Në hartimi e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.
-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Prrenjas dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Titulli gjetjes 1: *"Ndryshimet buxhetore gjatë periudhave ushtrimore"*

Situata:
Buxheti i Bashkisë Prrenjas gjatë vitit 2021 kanë ndodhur **3** ndryshime me vlerë 17,803 mijë lekë, duke marrë angazhime buxhetore të vitit ushtrimorë, por të paparashikuara në PBA 2000-2022, *konkretisht*:
-Ndërtim i një këndi të ri lojërash me fond 1,500 mijë lekë.
- Rikonstruksion i rrugës lagj Gega Rrajve – Sutaj (NJA Rrajcë) me fond 600 mijë lekë.
- Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në Bashkinë Prrenjas me fond 560 mijë lekë.
- Rikonstruksion i rrugëve të brendshme, rruga 1 Qershori/rruga 5 maj me fond 8,262 mijë lekë .
Këto veprime tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.
Mosrealizimet dhe ndryshimet e shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme
Kriteri:
Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit*" i ndryshuar, pikat 253 dhe 354.
Ndikimi/Efekti:
Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe

duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Shkaku:

Mos planifikim i saktë i shpenzimeve buxhetore nga strukturat përgjegjëse

Rëndësia: i *lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financë/Buxhetit, në bashkëpunim Sektorët e tjerë në Bashkinë Prrenjas, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

- *Auditimi mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.*

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuara nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha 2021 referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021		
		Plan	***Fakt***	***%***
1	600 – Paga	168,845	138,416	82
2	601 – Sigurime shoqërore	33,850	27,750	82
3	602 – Shpenzime operative	87,110	72,289	83
4	Totali shpenzime të tjera – (606, 604, 609)	7,812	4,305	55
5	Ndihma ekonomike	277,337	269,586	97
6	Investimet (230 + 231)	107,029	80,165	75
7	Shpërblime lindje – 606	700	700	100
8	466 – Garancitë	44,737	3,618	8
Totali		**727,420**	**596,829**	**82**

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit rezulton në nivelin e 82 %, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit nuk planifikohen sipas nevojat që Bashkia Prrenjas.

Peshën specifike më të madhe në buxhet në raport me totalin e zënë shpenzimet për paga, ndjekur nga shpenzimet operative.

Nr.	Përshkrimi	Përqindja në raport me totalin , viti 2021
1	Shpenzimet operative	11.9
2	Investime	14.7

Nr.	Përshkrimi	Përqindja në raport me totalin , viti 2021
3	Shpenzime për pagat	23.2

Titulli gjetjes 2: *"Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre".*

Situata:
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara për vitin **2021** paraqitet në masën **82 %**, ku nga vlera planifikuar prej **727,420 mijë lekë** është realizuar vlera prej **496,829 mijë lekë**.
Sipas Grupit të KLSH, kjo vjen nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve dhe parashikimit të investimeve pa dokumentacion të rregullt (mungesë projektesh), veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave dhe pa dokumentacionin përkatës ligjorë.
Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), të cilat janë mbajtur pjesërisht konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin **2021** ato janë në shumën **35,554 mijë lekë.**
Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Sipas të dhënave të buxhetit të vitit 2021, konstatohet se nga bashkia nuk është planifikuar për likujdim e gjithë vlera e faturave të palikujduara e cila është në shumën 35,554 mijë lekë, **por është planifikuar në masën 44.5% ose në vlerë 38,395 mijë lekë,** *nga e cila:* për llog. 602 në shumën 11,757 mijë lekë dhe për llog 230+231 në shumën 22,819 mijë.

Situata financiare e bashkisë Prrenjas, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 10%, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

Kriteri:
Në kundërshtim me nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" me ndryshime; ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar. pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" pikat 82-91.
Ndikimi/Efekti:
Si rezultat i planifikimit të procedurave pa siguruar burimin e tyre, i cili vjen ngatë ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhura kur ky plan nuk realizohet dhe mos

parashikimi i faturave të palikujduara, çojnë në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Shkaku:

Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin, ku sipas ë dhënave të Drejtorisë së Taksave realizmi i të ardhurave për asnjërën nga periudhat nuk paraqitet me realizim.

Rëndësia: i *lartë*

Për këtë rekomandojmë:

-Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Prrenjas, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Prrenjas.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- *Miratimi i buxhetit faktik*

Në fund të periudhave ushtrimore nga Bashkia Prrenjas janë miratuar buxhetet faktik. Në relacionet përfundimtare të zbatimit të buxhetit janë hartuar vetëm realizimin e treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk shoqërohen me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmisimin e situatës.

- *Fondi rezervë/dhe kontigjencës*

Për vitin **2021**, është miratuar fond rezervë në vlerën 2.900 mijë lekë, fond social per familjet ne nevojë ne vlerën 500 mijë lekë, emergjencat civile ne vlerën 2.600 mijë lekë. Me Vendim të KB nr. 95, datë 01.12.2020 është përdorur fondi nga emergjencat civile per familjet:

- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga tërmeti i datës 21/09/2019 per banesën e XH.H. me vlerë 800 mijë lekë.*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga tërmeti i datës 21/09/2019 per banesën e A.A. me vlerë 200 mijë lekë.*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga zjarri ne banese e R.O me vlerë 690 mijë lekë.*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga zjarri ne banese e L.O. për vlerën 30 mijë lekë.*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga tërmeti ne date 21.09.2019 ne banese e N.K. me vlerë 600 mijë lekë.*

Totali i përdorur është 2,320 mijë lekë, duke mbetur pa përdorur vlera 280 mijë lekë.

Gjatë vitit 2021 kemi shtesë me grand në vlerën 2,412 mijë lekë, e cila është përdorur për familjet si vijon:

- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga tërmeti i datës 21/09/2019 per banesën e A.A. me vlerë 600 mijë lekë.*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga tërmeti ne date 21.09.2019 ne banese per N.K. 200 mijë lekë*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga zjarri ne banese per S.P. 420 mijë lekë.*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga zjarri ne banese per K.H. 104 mijë lekë*
- *Ndihme financiare per familjet te dëmtuar nga tërmeti ne date 21.09.2019 ne banese per S.B. 800 mijë lekë*

Totali i përdorur 2.124 mijë lekë mbeten pa përdorur 288 mijë lekë
Nga fondi rezerve është përdorur fondi prej 1.585 mijë lekë Per ndihme financiare per familjet ne nevojë. Shuma e pa përdorur është 1.315 mijë lekë.

- *Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likujduara, vendimeve gjyqësore dhe detyrimet kontraktore***.**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre, u konstatua se nuk ka fatura të cilat të kenë kaluar afatin e 30 ditëve nga momenti i paraqitjes në bashki. Ndërsa në lidhje me mos likujdimin e plotë të vlerës së faturave të paraqitur, konstatohet se është vetëm një faturë, *konkretisht* fatura nr. 100, datë 30.12.2021 në shumën 753,201 lekë, *nga e cila* likujduar shuma 26,883 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 726,318 lekë.

Konkluzion: Nga sa trajtuar më sipër, nga Bashkia Prrenjas (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2021 – 31/12/2021, paraqiten gjithsej **1 (një)** faturë me vlerë **753,201** lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "Detyrimet e prapambetura", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr.1 – *Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2021*

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2020	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021-31.12.2021	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021
Investime					
Investime nga FZHSH	22,808	0	22,808	0	22,808
Mallra dhe shërbime	12,912	0	12,912	1,155	11,757
Vendime gjyqësore	3,191	0	3,191	2,213	978
Të tjera					
Totali	**39,012**	**0**	**39,012**	**3,469**	**35,544**

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se janë të njëjta.

- *Mbi vendimet gjyqësore*

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2020 paraqitet vlera prej 3,191 mijë lekë, *nga e cila:* likujduar vlera 2,213 mijë lekë, duke mbetur për likujdim vlera 978 mijë lekë.

- *Raportet e Monitorimit*

Për vitet 2020 dhe 2021, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

Për vitin 2020:

- Janë dërguar raportet 4-mujore ne Ministrinë e Financave
- Raporti vjetor janar dhjetor 2020 është dërguar me shkresa nr.188 dt. 21.01.2021 ne Ministrinë e financave dhe per dijeni te Këshillit Bashkiak, Prrenjas

Për vitin 2021:

- Janë dërguar raportet 4-mujore ne Ministrinë e financave

Raporti vjetor janar dhjetor 2021 është dërguar me shkresa nr.493 . dt. 11.02.2022 ne Ministrinë e financave dhe per dijeni te Këshillit Bashkiak, Prrenjas.

- *Për financimet nga Ministritë e linjës dhe donatorë të tjerë*.

Sipas të dhënave të paraqitura, konstatohet se me fonde të deleguara janë gjithsej 4 kontrata me vlerë 308,368 mijë lekë, *nga e cila:* për vitin 2021 është vetëm një kontratë me objekt "*Përmisim i banesave me lote, Bashkia Prrenjas"* për vlerën 20,323 mijë lekë. Nga totali i kontratave të lidhura (308,368 mijë lekë), janë likujduar gjatë vitit 2021 vlera prej 226,816 mijë lekë, duke mbetur për likujdim vlera 81,552 mijë lekë, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve në vlerën e tyre të plotë nga Ministria e linjës (AKUM, MIN Bujqësisë dhe MFE), pavarësisht faktit që punimet kanë përfunduar në objekt.

- *Për financimet nga të ardhurat e veta dhe grande*.

Sipas të dhënave të paraqitura, konstatohet se me të ardhurat e veta dhe grande janë prokuruar gjithsej 27 procedura me vlerë kontrate 239,886 mijë lekë, nga e cila likujduar gjatë vitit ushtrimorë vlera 163,620 mijë lekë, duke mbetur për likujdim vlera prej 76,266 mije lekë.

Nisur nga fakti se kontratat kanë përfunduar sipas afateve, mos kryerja e pagesave vjen si rezultat i mos realizimit të të ardhurave ose planifikim jo i saktë dhe detajuar i fondeve në momentin e hartimit të buxhetit, duke planifikuar mbi nevojat që kjo bashki ka me fonde.

Konkluzion: Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se fondet e akorduara nga Ministritë e Linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha, ku për vitin e *parë është respektuar kufiri 20%* i vlerës së fondit limit. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Prrenjas për vitin 2021 dhe grandeve të qeverisë, nisur nga fakti se kontratat kanë përfunduar sipas afateve, mos kryerja e pagesave vjen si rezultat i mos realizimit të të ardhurave ose planifikim jo i saktë dhe detajuar i fondeve në momentin e hartimit të buxhetit, duke planifikuar mbi nevojat që kjo bashki ka me fonde.

Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese Bashkia Prrenjas (Sektori i buxhetit), *nuk merret në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat/tarifat vendore dhe*

planifikimi i plotë i faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore, të cilat për janë në vlera të larta që zënë 9 % të buxhetit të bashkisë.
Veprime këto në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;* pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime;* neni 47 të ligjit nr. 68/2017 *"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"*; nenet 79 -80-81, të udhëzimit të MFE nr.9,datë 20.03.2018 *"Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit"* me ndryshime.

- *Realizmi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre*.

Referuar të dhënave nga Drejtoria e Financës/ Buxhetit, të ardhurat totale të Bashkisë Prrenjas, ku përfshihen edhe të ardhurat e trashëguara nga vitet e kaluara *(transferta e pakushtëzuar dhe specifike)*, janë paraqitur në **Tabela 1,** sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit;

Tabela 1. *Pasqyra e të ardhurave të grumbulluara, viti 2021*

Përshkrimi	Plan 2021	Fakt 2021
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2020	27,620	27,620
Të trashëguara nga transf. Specifike 2020	26,013	26,013
Të trashëguara nga transf. Pakushtëzuara 2020	66,618	66,618
Të ardhurat e veta të vitit 2021	78,047	39,118
Grante të pakushtëzuara viti 2021	184,058	156,403
Shuma	***382,356***	***315,772***
Grante specifike të vitit 2021, të detajuara:	***641,329***	***699,705***
-Nga FZHSH	-	-
-Nga Ministritë e Linjës + tran sektoriale	246,170	221,680
-Donatorë të ndryshëm	3,503	3,263
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	489,131	474,762
-Nga huatë	-	-
Totali	**1,025,708**	**997,240**

Tabela 2. *Pasqyra e shpërndarjes se te ardhurave sipas natyrës shpenzimit, viti 2021*

Emërtimi	Fakt 2021			
	Gjithsej	Tr.Pakushtezuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike
230-Projekte	7,100	7,100	0	0
231-Investime	230,805	72,148	36,471	122,186
600-Paga	171,150	69,663	22,515	78,972
601-Sigurime shoqërore	28,305	11,639	3,849	12,817
602-Shpenzime operative	82,938	71,731	3,903	7,304
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	476,346	1,584	0	474,762
Kuotë qarku	596	596	0	0
SHUMA	**997,240**	**234,461**	**66,738**	**696,041**

Burimi: Drejtoria e Financës

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se peshën kryesore të shpenzimeve vjetore e zënë transferta specifike/kushtëzuara në masën 69.8% ose me vlerë 696,041 mijë lekë. Me të ardhurat e vatë bashkia mbulon 6.6% të totalit të shpenzimeve, ndërsa me grande të pakushtëzuara mbulon 23.4% të totalit të shpenzimeve.

a- Transferta e kushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën **696,041** mijë lekë, ose **69.8%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021. Në totalin e fondeve kushtëzuara/specifike, fondet për investime zënë 17.5%.

b- Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën **234,461 mijë** lekë, ose **23.4%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për investime në masën 30.7%, të ndjekur nga shpenzimet për paga (funksionet e deleguara nga qeveria qendrore në atë vendore) në masën 29.4%.

c- Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën **66,738 mijë** lekë, ose **6.6%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021 ku peshën kryesore e zënë fondet e shpenzuara për investime në masën 54%, të ndjekur nga shpenzimet për paga (funksionet e deleguara nga qeveria qendrore në atë vendore) në masën 33.3%.

Nga auditimi konstatohet se per vitin 2021 nga Bashkia Prrenjas janë ndërmarrë 5 angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale **46,756,526 lekë**, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike dhe shërbimeve të ndryshme, konkretisht:

1. *"Rikonstruksion rrugëve të brendshme në Bashkinë Prrenjas: Rruga 1 Qershori/Rruga 5 maji" , datë 06.10.2021*
2. *Ndërtimi i një kënd lojërash për fëmijë dhe vendosje dere e brendshme shkolla Katjel Njësia Adm. Rrajcë, Bashkia Prrenjas ,vendosje ulluqe ,veshje shkallësh me mermer, Hidroizolim tarrace, ndërtim mur betoni dhe rrethim me rrjete teli shkolla mesme Karkavec ,Njësia Adm. Qukës, Bashkia Prrenjas, datë 26.10.2021.*
3. *Rikonstruksion i rrugës Qukës Skënderbe, Bashkia Prrenjas datë 15.10.2021.*
4. *Sigurim punonjësish, datë 10.12.2021*
5. *Supervizimi punimesh per objektin :Përmirësim i kushteve te banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara, datë 15.10.2021.*

Gjithashtu referuar regjistrit të procedurave, konstatohet se nga Bashkia Prrenjas janë ndërmarrë angazhime buxhetore për kryerjen e procedurave pa pasur ne dispozicion projektin përkatës, procedura të cilat megjithëse janë parashikuar në buxhet nuk janë realizuar duke çuar në mos realizimin e zërave të buxhetit, konkretisht procedurat:

Nr.	Emërtimi i objektit	Arsyet e mosrealizimit
1	Rikonstruksion i rrugëve rurale Lagja Benos, Sules,Vaskut dhe Kryeziut Nj. Adm Qukës Bashkia Prrenjas	Nuk është realizuar per shkak te mosparaqitjes se projektit
2	Permiresimi i sinjalistikës se Qytetit Prrenjas	Nuk është realizuar per shkak te mosparaqitjes se projektit
3	Ndertim i ujësjellësit Stravaj Fshat (Faza e 1)	Nuk është realizuar per shkak te mosparaqitjes se projektit

Nr.	Emërtimi i objektit	Arsyet e mosrealizimit
4	Rikonstruksion unaza e qytetit Prrenjas	Projekti është dërguar per financim ne FZSH
5	Blerje instrument per projektet e urbanistikes	Nuk është dorëzuar preventiv
6	Blerje kondicioner per zyrat e bashkisë	Fondi i parashikuar nuk mjaftonte per realizimin e objektit per këtë arsye u planifikua per vitin 2022
7	Sistemim qendre Karkavec Njësia Qukës	Nuk është paraqitur projekt

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- *Struktura organizative e Bashkisë Prrenjas*

Miratimi i Strukturave për vitin 2021 janë kryer me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 30.12.2020 , konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresën nr. 32/1, datë 15.01.2021, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

Ndarja e strukturës

Organika për vitin 2021 është **332 punonjës**, si më poshtë vijon:

Emërtimi	Viti 2021	
	Plan	Fakt
Aparati i Bashkisë dhe Njësive Administrative	194	193
Punonjës në pozicionet e deleguara(arsimi parashkollor)	57	57
Punonjës në pozicionet e deleguara(Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi)	14	14
Punonjës në pozicionet e deleguara(Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Transporti)	35	35
Punonjës në pozicionet e deleguara(Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave)	7	7
Punonjës në pozicionet e deleguara(Ujitja dhe Kullimi)	2	2
Punonjës në pozicionet e deleguara(Gjendja civile)	4	4
Punonjës me kontratë(me afat sezonal)	10	
Punonjës me kontratë të Fondacionit "Tungjatjeta jetë, Shërbim lëvizës për fëmijëri me aftësi të kufizuar" (Projekt)	3	3
Punonjës me kontratë "Shtëpia e të moshuarve Prrenjas" (Projekt)	6	6
Shuma	**332**	**321**

Nga verifikimi për raportin e punonjësve me status dhe me kontratë pune rezulton se:

a. Për vitin 2021:

Nga të punësuarit 14 janë me statusin e nëpunësit civil, marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil", ndërsa 307 punonjës janë me kontratë pune marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodit te Punës te Republikës se Shqipërisë" i ndryshuar.
Sipas strukturës së miratuar me VKB,

a. Sa pozicione pune ka të vlerësuara me status të Nëpunësit Civil, gjithsej pozicione, nga të cilat:
   1 pozicion i kategorisë së lartë,
   7 pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
   12 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
   57 pozicione të kategorive ekzekutive

b. Sa nga këto pozicione janë të lira (të paplotësuara)?
   1 pozicion i kategorisë së lartë,
   5 pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
   9 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
   48 pozicione të kategorive ekzekutive

Titulli gjetjes 3: *"Angazhimi pa fonde në dispozicion i ndërmarrë nga Bashkia Prrenjas për kontratat e lidhura për investime kryesisht me burim financimi të ardhurat e veta".*

Situata:
Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Prrenjas, financuar nga Ministritë e linjës, konstatohet se, në 4 kontrata me vlerë 308,368 mijë lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore duke lidhur kontratë me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës.
Peshën kryesore të shpenzimeve vjetore e zënë transferta specifike/kushtëzuara në masën 69.8% ose me vlerë 696,041 mijë lekë, ku me të ardhurat e vetë bashkia mbulon 6.6% të totalit të shpenzimeve, ndërsa me grande të pakushtëzuara mbulon 23.4% të totalit të shpenzimeve. Mos realizimi i shpenzimeve për investime/dhe shërbime vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave ose planifikimit të procedurave mbi nevojat e fondeve që kjo bashki ka, që do të thotë se, nga Bashkia Prrenjas në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore.
Përgjatë periudhës 2021 është konstatuar se nga Bashkia Prrenjas janë ndërmarrë 5 angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor, me vlerë totale **46,756,526 lekë**, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike dhe shërbimeve të ndryshme.
Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrenjas, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se për vlerën **16,271,913 lekë**, *nga e cila vlera përmbarimore 1,422,359 lekë dhe vlera e detyrimit prej 14,829,554 lekë (aneksi bashkëlidhur Raport Auditimit),* si dhe pagesën për të njëjtën vend pune të dy punonjësve, nuk është respektuar radhën e likujdimet të tyre, sipas parimit "hyrje e parë-dalje e parë", pavarësisht faktit se Bashkia Prrenjas në fund të viteve 2021 ka patur disponibilitete në thesar. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe në urdhrin e likujdimet nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime të Bashkisë Prrenjas ndaj palëve të treta.
Nga auditimi i strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas, konstatohet se nga 77 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, janë të lira 63 porcione, vendet e të cilave janë zënë nga punonjës me kontratë për një periudhë të gjatë kohore që varjon nga 1 deri në 3 vite. Pozicionet e punës të përcaktuar me status nuk kanë funksione të ngjashme me pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat duhet të rishihen.
Evidentohet një numër i konsiderueshëm të emërimit të punonjësve në pozicione jo të përshtatshme ku duhet të jenë punonjës me status dhe vijojnë pagesën e marrëdhënieve financiare.
Kriteri:
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me;

Nenin 108, pika (i) dhe (ii) e shkronjës (a) dhe shkronjës (ç), të ligjit nr. 44/2015 "Kodi Procedurës Administrative i RSH"; Ligjit nr. 152/2013, datë 30/05/2013 "Për Statusin e Nëpunësit Civil" i ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 18.3.2015.
Pikat 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
Pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore", i ndryshuar;
Nenin 70 dhe nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;
Pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
Shkronja "a" në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
Nenin 47 dhe 51 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku:
Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga strukturat përgjegjëse në menaxhimin e buxhetit dhe strukturën organizative.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social, të marrin masa për:

- Planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.
- Eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore përtej afatit ligjor.
- Lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.
- Gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likujdimet të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.
- Kryetari i Bashkisë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likujdimet të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.
- Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin e strukturës organizative me punonjës me status të Nëpunësit Civil, duke eliminuar praktikat e zëvendësimit të tyre me punonjës me kontratë mbi periudhën e provës.
- Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për rishikimin e strukturës së punonjësve dhe rritjes së numrit të organikës së pa nevojshme, si dhe të rishikojë

kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Prrenjas.
Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi të ardhurat e bashkisë të mos kryejë copëzimin e fondeve për të shmangur detyrimet e prapambetura që çojnë në një situatë të vështirë financiare.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:
N.B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Prrenjas.
S.K. në detyrë e Drejtore Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social.
A.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhet/Financës.

Nënpika 2.2.6 e programit. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 30.12.2020 , konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresën nr. 32/1, datë 15.01.2021, ku është miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore. Në këtë strukturë përfshihet edhe struktura e Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave. Aktualisht, kjo drejtori ka në përbërje 8 punonjës, të ndarë konkretisht: 1 (një) drejtor, 1 (një) përgjegjës i zyrës së taksave dhe 6 specialist, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Për vitin 2021, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Prrenjas është miratuar me VKB nr. 97, datë 01.12.2020 "*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*", konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1628, datë 4.12.2020.
Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, *sipas Aneks 2.6.1 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.*
Të ardhurat totale të Bashkisë Prrenjas janë me realizim në masën 101%, ku nga vlera e planifikuar prej 80,070 mijë lekë është arkëtuar vlera 80,506 mijë lekë.
Në fakt nëse nga totali i të ardhurave do heqim zërat për të cilat nuk është përgjegjës në mbledhje e tyre ose janë shërbime jashtë sistemit të taksave e tarifave vendore, realizmi i të ardhura është në shumën 94%, ku nga vlera e planifikuar prej 77,340 mijë lekë është arkëtuar vlera 72,896 mijë lekë ose më pak për vlerën 4,443 mijë lekë, **pra me mosrealizim,** sipas tabelës nr. 2.

Tabela nr. 2. ***Realizimi fakti i të ardhurave nga taksa e tarifa vendore***

Lloji i taksës, tarifës	Plani 2021	Fakti 2021	Diferencë vitit 2020 me vitin 2021	Realizimi ne % viti 2021
Tatim i thjesht. Mbi biz e vogël + t. Biznesi i vogël	0	414,564	-414,564	

Lloji i taksës, tarifës	Plani 2021	Fakti 2021	Diferencë vitit 2020 me vitin 2021	Realizimi ne % viti 2021
Taksa e regj.pervitsh automjet.	6,500,000	8,345,096	-1,845,096	128.39
Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale(2%)	120,000	6,573,714	-6,453,714	5,478.10
Taksa mbi ndërtesat	6,300,000	4,961,781	1,338,219	78.76
Taksa e ndikimit ne infrastruktura.	7,000,000	9,367,714	-2,367,714	133.82
Takse tregu + Ambulante	1,500,000	1,345,050	154,950	89.67
Taksa e kalim te drejt. Pronës.	100,000	467,446	-367,446	467.45
Takse toke bujq.	4,000,000	2,939,484	1,060,516	73.49
Takse tabele /reklame / banderole	1,000,000	1,476,065	-476,065	147.61
Takse mbi truallin shesh funksional	1,600,000	1,116,012	483,988	69.75
Takse e përkohshme arsim	0	0	0	
Takse Hoteli	20,000	3,255	16,745	16.28
Totali taksave vendore	**28,140,000**	**37,010,181**	**-8,870,181**	**131.52**
Te ardhura jo tatimore				
Te ardhura nga Tarife Uji Pijshëm	20,000,000	14,343,956	5,656,044	71.72
Tarife pastrimi	9,000,000	6,546,179	2,453,821	72.74
Tarifa te tjera nga Urbanistika	400,000	407,500	-7,500	101.88
Leje transporti+ tarif parkim	450,000	245,600	204,400	54.58
Tarife vaditje	500,000	487,620	12,380	97.52
Tarife per leje zhvillimi + sistemeve jashtme	0	141550	-141,550	
Tarife ndriçimi	2,600,000	2,461,459	138,541	94.67
Tarife Gjelberimi	1,000,000	885,586	114,414	88.56
Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave	3,500,000	1,652,435	1,847,565	47.21
Totali tarifave vendore	**37,450,000**	**27,171,885**	**10,278,115**	**72.56**
QERA +Trualli	6,200,000	5,533,081	666,919	89.24
Te ardhura nga gjobat	50,000	511,306	-461,306	1,022.61
Te ardhura nga RENTA	1,500,000	161,554	1,338,446	10.77
Tarife e ndikimit ne mjedis	4,000,000	2,508,147	1,491,853	62.70
Shuma	**11,750,000**	**8,714,088**	**3,035,912**	**74.16**
Totali te Ardhurave 2021	**77,340,000**	**72,896,154**	**4,443,846**	**94.25**

Për sa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.

- **Të dhënat mbi detyrimet e paarkëtueshëm (debitorë)**

Titulli gjetjes 1: *Mos zbatimi i akteve ligjore për arkëtimin e debitorëve me vlerë 62,185,903 lekë.*

Situata:
Në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas dhe nga auditimi u konstatua se ka një sasi të konsiderueshme debitorësh me vlerë **62,185,903 lekë**, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD. Konstatohet se kjo vlerë vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 14,287,806 lekë, pasi nga vlera 47,898,097
lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera 62,185,903 lekë, *konkretisht tabela nr. 3*.

Tabela nr. 3. Detyrimet.

Detyrimet sipas zërave nga taksa/tarifa vendore	Debitor viti 2020	Pakësime viti 2021	Shtesa viti 2021	Kamat 2021	Gjendje 31.12.2021
Biznesi vogël Prrenjas	4,010,409	4,360,308	4,087,652	503,033	4,240,786
Biznesi vogël Qukës	478,843	215,372	411,594		675,065

Detyrimet sipas zërave nga taksa/tarifa vendore	Debitor viti 2020	Pakësime viti 2021	Shtesa viti 2021	Kamat 2021	Gjendje 31.12.2021
Biznesi vogël Rrjacë	754,623	756,562	900,767		898,828
Biznesi i Madh	5,975,822	11,159,809	18,903,134	256,881	9,976,028
Debitorë karburanti	5,091,850	-	-		5,091,850
Debitorë nga ALUZNI	4,283,575	2,686,379			1,597,190
Debitorë familjarë	-	-	-	-	39,706,156
TOTALI	**20,595,122**	**19,178,430**	**24,303,147**	**759,914**	**62,185,903**

Referuar të dhënave të tabelës konstatohet se niveli i borxhit është 77.5% e planit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore dhe 16.2% e shpenzimeve buxhetore, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie në menaxhimin e borxhit fiskal.
Nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas janë llogaritur kamatëvonesa në vlerën 759,914 lekë, vlerë kjo shumë herë më e vogël se vlera reale e llogaritjes së tyre, pasi sipas dispozitave ligjore (0.06%), detyrimi për kamatëvonesën duhej të ishte në vlerën **4,562,475 lekë** (24,303,147 * 0.06% x 365 – 759,914).
Vlera totale e debisë (borxhit tatimor) prej **65,748,378 lekë** ***(62,185,903 lekë*** *detyrime të papaguara dhe* ***4,562,475 lekë*** *kamatëvonesa)*, duhet të kontabilizohet dhe t'u njoftohet subjekteve përkatëse nga ana e administratës të Bashkisë Prrenjas dhe përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.
Nga auditimi konstatohet se një pjesë e subjekteve të cilat janë debitorë në vite, nuk janë zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre sipas ligjit, duke bërë që këto subjekte të kthen në debitorë pa shpresë arkëtimi, gjithsej **55 subjekte** me vlerë **10,729,869 lekë 16% e totalit të detyrimeve.**
Në lidhje me masat e marra, konstatohet se nga bashkia është zbatuar vetëm bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe bllokimi në ASHK, ku është kërkuar arkëtimi i vlerës 11,254,342 lekë, nga e cila arkëtua vlera 3,480,2756 lekë.
Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngese nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është batuar. Mungon bashkëpunimi me Policinë bashkiake për arkëtimin e tyre. Gjithashtu dhe në rastet kur është zbatuar, evidentohet se vlera e zbatuar në krahasim me nivelin e tyre është në masën 17.7%, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie.
Nga të dhënat evidentohet se një numër subjektesh me status pasiv/mbyllur paraqiten me situatë debitorë, gjithsej 38 subjekte ku 5 prej tyre janë me detyrime me vlerë 566,397 lekë, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Librazhd, po ashtu dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh **të paarkëtueshëm ose të keq**.
Në këto kushte Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas duhet të ketë një bashkëpunim me të madh me Administratën e QKB dhe mos lejoje fenomene të tilla, si dhe për subjektet të cilat janë me status pasiv/mbyllur .

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995,"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda

2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 - *Mospagimi i taksave dhe tatimeve,* me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – *"Çregjistrimi i subjekteve tatimore",* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", me ndryshime**.**

duke ngarkuar me përgjegjësi: J.B. *me detyrë Drejtoresh e të Ardhurave Vendore,* ***A.A.*** *me detyrë Përgjegjës i Drejtorisë të Ardhurave Vendore,* ***L.K.*** *me detyrë Inspektor NJA Qukës,* ***E.D.*** *me detyrë Inspektor NJA Rrjacë dhe* ***O.M.*** *me detyrë Inspektor NJA Stravaj***.**

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë, çon në rritjen e nivelit të detyrimeve të paarkëtuar nga njëra periudhë në tjetër, me vlerë 62 milionë lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë dhe që zë 16.2% të buxhetit vjetor të kësaj bashkie.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në zbatimin e dispozitave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuar:

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **26,042,222 lekë**, *si më poshtë vijon*:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave <u>të bëhet *kallëzim penal*</u>.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Dega Librazhd për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

g- Të bëhet llogaritja e saktë e kamatëvonesave për të gjithë subjektet të cilat nuk likuidojnë në afat detyrimet sipas njoftim detyrimit nga momenti i lindjes deri në datën e pagesës së detyrimit.

- Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas të bashkëpunojë me QKB Dega Librazhd dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan për evidentimin e subjekteve me status pasiv/mbyllur nëse ushtrojnë ose jo aktivitet dhe të mos lejohen të kryejnë veprime pa bërë likujdimin e detyrimeve të prapambetura, për të shmangur fenomenin e krijimit të borxhit të keq dhe pamundësinë e gjetjes së tyre për arkëtim.

<u>Titulli gjetjes 2:</u> *Mangësitë e konstatuara në vjeljen e detyrimeve nga abonentët familjarë.*

Situata:

Në totali e detyrimeve, konstatohet se peshën kryesore e zëne detyrimet nga abonentët

familjarë, të cilat janë 64% e totalit të detyrimit ose me vlerë **39,706,156 lekë**.
Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Prrenjas nuk kishte aktmarrëveshje me ND. Ujësjellës Kanalizime dhe menaxhimi bëhej nga vetë bashkia nëpërmjet postës (shpërndarjen e njoftim detyrimit) dhe për njësitë e largëta nga punonjësit e taksave. Një menaxhim i tille është jo frytdhënës për bashkinë, pasi niveli i detyrimeve debitore vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku për vitin 2021 kemi një rritje për vlerën 22,260,537 lekë, pasi nga vlera 17,445,619 lekë në vitin 2020 në vitin 2021 paraqitet në vlerën 39,706,156 lekë.
Gjithashtu evidentohet fakti se nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas për abonentët familjare nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre.

Kriteri:
Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05. i ndryshuar kreu IX pagesa dhe rimbursimit i tatimit, Neni 74 "*Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor*", ku përcaktohet se: "*1. Tatimpaguesi shlyen detyrimet tatimore brenda afateve të parashikuara në ligjin tatimor përkatës. 2. Kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor, në përputhje me kreun VIII të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose vlerësohet të ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë. Në rastet kur një person i tatueshëm nuk e paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, ai detyrohet të paguajë kamatëvonesa 0,06% mbi shumën e detyrimit tatimor të papaguar duke filluar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme për tu paguar, deri në datën në të cilën pagesa kryhet.*".

Ndikimi/Efekti:
Mos ndjekja e procedurave të saktë në menaxhimin e detyrimeve nga abonentët familjarë, çon në të ardhura të munguara në buxhet me vlerë 39 milionë lekë.
Shkaku: Përgjegjësi e personave në menaxhimin e këtyre detyrimeve dhe mos zbatimin e kuadrit ligjore.
Rëndësia: i lartë.
Për këtë rekomandojmë:
- Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve të marri masa për lidhjen e aktmarrëveshjes si agjent tatimorë më Ndërmarrjet e Ujësjellësit Librazhd dhe Prrenjas, për një mirëmënaxhim më të mirë detyrimeve nga abonentët familjarë dhe jo vetëm.
- Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **39,706,156 lekë** nga abonentët familjarë.

Titulli i gjetjes 3: *Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe ALIZNI.*

Situata:
Nga auditim mbi menaxhimin e TNI dhe të ndërtimeve pa leje, rezulton se sipas të dhënave të ardhurat nga ky zë *për vitin 2021* janë realizuar në masën 134% ose nga vlera 7,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 9,367 mijë lekë.

Ky tejkalim vjen nga mungesa e bashkëpunimit midis drejtorive mbi mundësinë e lejeve të ndërtimit që Drejtoria e PZHT ka parashikuar për vitin ushtrimorë 2021 dhe mos marrja e informacionit si rezultat i mungesës së bashkëpunimit.
Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja *(nga legalizimet*), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën **1,597,190 lekë,** e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve**.**
Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Prrenjas ti jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalimizt dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Kriteri:
Veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar,* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet.

Ndikimi/Efekti:
Veprime në mungesë të ardhurash në buxhet me vlerë 1,597,190 lekë.

Shkaku:
Mungesa e bashkëpunimit institucional midis Drejtorive/Sektorëve, si dhe mos zbatimin e masave ligjore për arkëtim nga personat përgjegjës.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **1,597,190 lekë** nga abonentët familjarë.
- Kryetari i Bashkisë Prrenjas nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Elbasan, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Titulli i gjetjes 4: *Mbi miratimin e Lejes Zhvillimore nr.57 datë 09.11.2018 dhe Lejes të Ndërtimit 56 datë 13.07.2021 në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" si dhe VKM-në nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit".*

Situata:
Leja e zhvillimit nr.57, datë 09.11.2018 dhe leja e ndërtimit nr. 56 datë 13.07.2021 për Fazën II të ndërtimit me objekt "Qendër Tregtare multifunksionale, 3 kate mbi toke dhe 1 kat nëntokë ne Prrenjas - Faza e dyte ndërtimore".
Llogaritja e TNI-së sipas çmimit të shitjes për metër katror;
Nga Leja e ndërtimit nr.56 datë 13.07.2021 e miratuar elektronikisht po në këtë datë, nga Kryetari i Bashkisë N.B., bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e

ndërtimore mbi tokë të fazës II arrin 1989 m^2, ndërsa nën tokë , gjelbërime dhe sistemime arrin 550 m^2

Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur:

TNI= Çmimi shitje/m2 sipas UKM nr.3 date 28.12.2016 x m2 x 6%=1,989 x 41,780 x 6%= 4,986,025 lekë.

Sipas autorizimit për pagesë të firmosur nga ish Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit N.D., Kryetari i Bashkisë N.B. si dhe A.B. , vlera e përllogaritur dhe e paguar nga subjekti "E." SHPK me njoftim debitimin e bankës BKT datë 29.06.2021, është **1,560,170 lekë.**

Nisur nga fakti që llogaritja e kësaj takse, i përket vetëm fazës së dytë të ndërtimit, por objekti i ndërtimit është vetëm një, pra Qendra Tregtare Multifunksionale, atëherë është kontrolluar dhe llogaritja e TNI-së sipas fazës së parë

Faza e parë e dhënies së lejes lidhet me lejen zhvillimore nr.57, datë 09.11.2018 si dhe lejen e ndërtimit nr. 61 (nr. prot 1206) datë 26.06.2019.

Në llogaritjen e TNI-së, është përdorur metoda e llogaritjes mbi bazë preventivi. Kjo metodë është tërësisht e gabuar pasi, siç cituam më lartë, në bazë të nenit 9 pika 2 e ligjit nr.95/2018 datë 03.12.2018, llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes. Duke qenë se në paketën fiskale të vitit 2019, nuk është përcaktuar përqindja mbi objektet e shërbimit (Qendër Tregtare), si llogaritje po marrim si referencë normën minimale të përcaktuar në ligj, pra 4 %. Nga rillogaritja e TNI-së, ka rezultuar si më poshtë;

Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur:

TNI= Çmimi shitje/m2 sipas UKM nr.3 date 28.12.2016 x m2 x 6%=3,606m2 x 41,780 x 4%= 6,026,347 lekë.

Sipas autorizimit për pagesë të firmosur nga ish Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit A.A. dhe M.P., si dhe A.B. , vlera e përllogaritur dhe e paguar nga subjekti "E." SHPK me njoftim debitimin e bankës B... datë 21.06.2019, është **2,336,846 lekë.** Pra konstatohet një diferencë prej 3,689,501 lekësh e papaguar nga subjekti zhvillues "E." SHPK, për shkak të keqllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë. **Pra në total diferenca e papaguar për dy fazat është 7,115,356 lekë.**

Auditimi i procedurës së dhënies së lejes së zhvillimit dhe ndërtimit

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejeve të sipërcituara rezulton se:

- *Gjurma e ndërtimit për të dy fazat*, Faza I me një sipërfaqe 930 m^2 dhe Faza II me një sipërfaqe prej 700 m^2, tejkalojnë gjurmën e ndërtimit të përcaktuar në lejen zhvillimore totale nr. 57, datë 09/11/2018 (1575 m^2), duke bërë kështu shkeljen e parametrit të KSHT-së së përcaktuar në lejen zhvillimore. Pra KSHT-ja e rillogaritur = (930 + 700)m^2/ 3150m^2= **51.75%,** > 50%. Shkelja e KSHT-së bien në kundërshtim me Rregulloren e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Prrenjas miratuar me Vendim KKT-je nr. 3 datë 14.04.2017, neni 39 pika 2 si dhe në kundërshtim me VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, neni 14 i tij, ku përcaktohen kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit.
- *Sipërfaqja ndërtimore mbi tokë për të dy fazat*, Faza I arrin një sipërfaqe totale mbi tokë 2,731.8 m^2 dhe Faza II me një sipërfaqe totale mbi tokë prej 1,989 m^2. Këto sipërfaqe në total mbi tokë, tejkalojnë kushtin e sipërfaqes totale mbi tokë të përcaktuar në lejen e zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018 (4,680 m^2). Shkak për këtë gjë përbën leja e ndërtimit nr. 61 datë 26.06.2019 për fazën e parë, pasi në këtë leje sipërfaqja totale mbi tokë është miratuar për 2,731.8 m^2 (875 m^2 kati përdhe, 928,4 m^2 kati i parë, 928,4 m^2 kati i dytë), kurse në planvendosjen përkatëse, ishte miratuar për 2,690 m^2. Kjo ka bërë të mundur

ndryshimin e Intensitetit të Ndërtimit, por gjithsesi qëndron brenda intensitetit 2 të përcaktuar në Rregulloren e PPV. Më poshtë po paraqesim intensitetin sipas lejes zhvillimore nr. 57, datë 09/11/2018 dhe Intensitetit sipas lejeve të ndërtimit

I *leje zhvillimore*= *4,680* m^2/3,150 m^2= 1,485

I *leje ndërtimi faza I+II*= *4,720.8* m^2/3,150 m^2= 1,498

Si konkluzion dhënia e lejes së ndërtimit të fazës I, është bërë në kundërshtim me VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, neni 14 i tij, ku përcaktohen kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit.

Për sa i përket aspektit të lartësisë në metër, leja e zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018 është dhënë në kundërshtim me Rregulloren e PPV të Bashkisë Prrenjas, pasi në njësinë strukturore 1/100, në të cilën është zhvilluar ndërtimi, kjo njësi sipas rregullores, **lartësinë maksimale në kate e ka 3 kate dhe në metra e ka 9 m**. Në lejen e zhvillimit lartësia maksimale është përcaktuar 13,4 m (4,9 m lartësi kati përdhe, nga 4,25 m lartësi kati parë dhe kati i dytë) duke dalë kështu jashtë Rregullores së PPV.

Miratimi i lejes së zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018 është bërë në kundërshtim me Rregulloren e PPV, neni 39 pika 2.

Distancat nga kufijtë e pronës, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit si dhe të referuara në lejen e zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018, janë në shkelje të nenit 35 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", ku përcaktohen distancat minimale. Sipas këtij neni distanca ndërmjet vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

Në rastin tonë, distanca minimale referuar VKM-së duhet të jetë; **d= 3+1= 4 m**. Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin jugor (0,7 m), në kufirin perëndimor (0,2 m).

Distanca nga strukturat e tjera, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit si dhe të referuara në lejet e ndërtimit Faza I me nr.61 datë 26.06.2019, Faza II me nr.56 datë 13.07.2021, janë në kundërshtim me nenin 34, pika 2 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", pasi distanca e strukturës nga objekti 5 kate në veri të saj, sipas VKM-së duhet të ishte; **d= 3+5+2= 10 m.**

Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin verior (9,2 m) të saj.

Nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është proceduar për pajisjen e subjektit "E." shpk me ***Vërtetim Risku***, kjo në kundërshtim me ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile" si dhe VKM-në nr.1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me Vërtetim Risku të subjekteve, të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi".

Nga ana e Bashkisë Prrenjas është dhënë leja e ndërtimit në mungesë të ***Certifikatës së performancës së energjisë***" nga një auditues i licencuar i energjisë, në kundërshtim me ligji 116/2016 datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" neni 10 si dhe në kundërshtim me VKM-së nr. 537 datë 08.07.2020 "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementëve të ndërtesave" pika 4 e tij.

Kriteri:

VKM 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", neni 14, 34 dhe 35; Rregulloren e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Prrenjas miratuar me Vendim KKT-je nr. 3 datë 14.04.2017, neni 39; Ligjin nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile" si dhe VKM-në nr.1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me Vërtetim Risku të subjekteve, të cilat kërkojnë pajisje me leje

zhvillimi/ndërtimi"; Ligji 116/2016 datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" neni 10 si dhe VKM-së nr. 537 datë 08.07.2020 "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementëve të ndërtesave" pika 4.

Ndikimi/Efekti:

Cënimi i standardeve higjeno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave me qëllim përfitimin e padrejtë të zhvilluesit "E." shpk.

Shkaku:

Mos njohja e ligjeve të planifikimit të territorit si dhe ligjit të sistemit të taksave vendore

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës. Gjithashtu të merren masa të menjëhershme në rishikimin e paketës fiskale, seksioni Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, duke e përshtatur me bazën ligjore të përditësuar.

Për këto veprime ngarkohet me përgjegjësi;

a) *Për miratimin e lejes së ndërtimit Faza I me nr.61 datë 26.06.2019 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara,* ***G.R.*** *dhe* ***M.P.****, specialistë të DPZHT dhe* ***A.A.*** *me pozicion Drejtor i DPZHT për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas.*
   Në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas, përgjegjës është ish-Kryetari i Bashkisë Prrenjas ***M.R.***
b) *Për miratimin e lejes së ndërtimit Faza II me nr.56 datë 13.07.2021 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, H.K. dhe* ***M.P. dhe N.D.*** *me pozicion Drejtor i DPZHT për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas.*
   Në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas, përgjegjës është ish-Kryetari i Bashkisë Prrenjas ***N.B.***

Për hartimin e projektit për lejet e ndërtimit dhe zhvillimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi arkitekti ***R.P.*** *me Licencë A.....*

Titulli gjetjes 5: *Mbi miratimin e Lejes Zhvillimore nr. .46, datë 17.07.2020 dhe Lejes së Ndërtimit 56 datë 13.07.2021 në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" si dhe VKM-në nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit".*

Situata:
Leja e zhvillimit nr.46, datë 17.07.2020 dhe leja e ndërtimit nr. 58 datë 13.07.2021 me objekt "Objekt shërbimesh dhe banimi 5 kat me 1 kat nëntokë".
Llogaritja sipas çmimit të shitjes për metër katror;
Nga Leja e ndërtimit nr.58 datë 13.07.2021 e miratuar elektronikisht po në këtë datë, nga Kryetari i Bashkisë N.B., bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e ndërtimore mbi tokë arrin 2060 $m^{2,}$, ndërsa sipërfaqja nën tokë (1 kat) arrin 412 $m^{2,}$, pra në total
Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur:
TNI= Çmimi shitje/m2 sipas UKM nr.3 date 28.12.2016 x m2 x 4%=2,472 x 41,780 x 4%= 4,131,206 lekë.
Sipas autorizimit për pagesë të firmosur nga ish Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit N.D., Kryetari i Bashkisë N.B. si dhe A.B., vlera e përllogaritur dhe e paguar nga zhvilluesi S.B., me mandat pagesën e bankës OTP datë 01.07.2021, është 1,384,549 lekë.
Pra konstatohet një diferencë e dukshme prej 2,746,657 lekë e papaguar nga subjekti zhvillues S.B., për shkak të keqllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejeve të sipërcituara rezulton se:
Distancat nga kufijtë e pronës, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit, janë në shkelje të nenit 35 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", ku përcaktohen distancat minimale. Sipas këtij neni distanca ndërmjet vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.
Në rastin tonë, distanca minimale referuar VKM-së duhet të jetë; **d= 5+1= 6 m**. Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin jugor (4 m), në kufirin verior (2,5 m).
Distanca nga strukturat e tjera, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit, janë në kundërshtim me nenin 34, pika 2 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", pasi distanca e strukturës nga objekti 1 kate në veri të saj, sipas VKM-së duhet të ishte; **d= 5+1+2= 8 m.**
Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin lindor (7,5 m) të saj.
Nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është proceduar për pajisjen e zhvilluesit S.B. shpk me ***Vërtetim Risku***, kjo në kundërshtim me ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile" si dhe VKM-në nr.1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me Vërtetim Risku të subjekteve, të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi".
Kriteri:
VKM 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", neni 14, 34 dhe 35.
- Rregulloren e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Prrenjas miratuar me Vendim KKT-je nr. 3 datë 14.04.2017, neni 39.
- Ligjin nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile" si dhe VKM-në nr.1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me Vërtetim Risku të subjekteve, të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi".
- Ligji 116/2016 datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" neni 10 si dhe VKM-së nr. 537 datë 08.07.2020 "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementëve të ndërtesave" pika 4.
Ndikimi/Efekti:

Cënimi i standardeve higjeno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave me qëllim përfitimin e padrejtë të zhvilluesit S.B.

Shkaku:
Mos njohja e ligjeve të planifikimit të territorit si dhe ligjit të sistemit të taksave vendore

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:
Titullari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës. Gjithashtu të merren masa të menjëhershme në rishikimin e paketës fiskale, seksioni Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, duke e përshtatur me bazën ligjore të përditësuar.

Pretendim subjekti*:*
Me shkresën nr. 1192/5, datë 06.06.2022 dërguar nga Drejtoria e Planifikim Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e personave përgjegjës kanë kundërshtuar gjetjen e KLSH-së duke deklaruar se janë bazuar në paketën fiskale. Në lidhje me distancat, pretendohet vija e ndërtimit, ndërkohë në lejen zhvillimore janë cituar VKM 408 si dhe ligji 107.

Sqarim i grupit të KLSH:
Në lidhje me pretendimet e subjektit, nuk merren në konsideratë pasi janë shprehur opinione, dhe nuk ka fakte ligjore mbi të cilat do mbështeteshim për ti marrë parasysh.

Për miratimin e lejes së ndërtimit nr. 58 datë 13.07.2021në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, mbajnë përgjegjësi ***H.K. dhe M.P. dhe N.D.*** *me pozicion Drejtor i DPZHT për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas.*
Në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas, përgjegjës është ish-Kryetari i Bashkisë Prrenjas ***N.B.***
Për hartimin e projektit për lejet e ndërtimit dhe zhvillimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi arkitekti ***F.B. me Licencë A.....1.***

Titulli gjetes 6: *Menaxhimi i taksës së ndërtesës (pasurisë).*

Statusi:
Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të vitit 2021, rezulton se është realizuar në masën 79%, ose nga 6,300 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 4,961 mijë lekë. Ndikim në mosrealizimin e kësaj taksa vjen nga abonentët familjarë.
Dokumentacioni në dosje është i paplotë. Megjithëse nga Drejtoria e të Ardhurave është vijuar me grup pune për evidentimin në terren të sipërfaqeve të banimit për efekt taks

pasurie (taks ndërtese), ky dokumentacion është i paplotë, pasi nuk evidentohet genplani për sipërfaqen e matur dhe ne grupin e punës nuk ka asnjë specialist me profil inxhinier për kryerjen e matjeve faktike, ku te evidentohet sipërfaqja gjithsej, numëri i kateve, lloj i aktivitet ose destinacioni sipas kateve, etj.
Taksa e ndërtesës për subjektet/familjarët aplikohej në mungesë të dokumentacionit ligjorë *(genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK)*, duke përdorur tarifë fikse 100 m^2, mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m^2 (me 2 dhe 3 kate), dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.
Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria i PZHT për lejet e ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, megjithëse gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Elbasan mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Kriteri:
Veprime në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat vendore" i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Ndikimi/Efekti:
Mungesa e dokumentacionit në llogaritjen e saktë të taksës së ndërtesë, çon më mungesë të ardhurash për bashkinë.

Shkaku: Mos njohja e legjislacionit nga personat përgjegjës

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë:
Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Prrenjas dhe ASHK Dega Rajonale Elbasan, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës).

Titulli i gjetjes 7: *Mos aplikim i tarifës për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit.*

Situata:
Nga auditimi i regjistrave të subjekteve mbi aplikimin e detyrimeve vjetore për taksat e tarifat vendore në vitin 2021, rezulton se për një pjesë të subjekteve me aktivitet HEC, përpunimi i peshkut/mishit, karriere guri(gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, shfrytëzim minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjesh dhe industri te tjera te cilat ndikojnë ne mjedis, nuk është bërë i munduar aplikimi dhe arkëtimi i tarifës *për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit, kjo për 7 subjekte me vlerë 1,850,000 lekë, tabela:*

Nr	Subjekti	ADMINISTRATORI	Lloji i Aktivitetit (Kodi1-10) Sipas paketës fiskale 2021	Tarifa
1	G.I	SH.K.	HEC	350,000
2	F.A	A.G.	Grumbullim, pasurim i kromit te	250,000

Nr	Subjekti	ADMINISTRATORI	Lloji i Aktivitetit (Kodi1-10) Sipas paketës fiskale 2021	Tarifa
			varfer	
3	A.A	H.H.	Nder. dhe admin. shfrytëzim te shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh,	250,000
4	D.E	L.K	Energjia e turbinave me ere	250,000
5	J.O	F.P	Punime gërmime ne toke	250,000
6	E.T		Shfrytëzim karrierash	250,000
7	N.	V.C.	kontrat Qiraje ,fondi pyjor 19.04.2019-18.04.2029	250,000
			Shuma	**1,850,000**

Kriteri: Në kundërshtim me kapitullin B pika 16 *Tarifa per mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit*, të Vendimit të KB nr. 97, datë 01.12.2020 "*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*".

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatim të vendimit të KB nr. 97, datë 01.12.2020 "*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*", çon në mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkinë në shumën 1,850,000 lekë

Shkaku: mos zbatim i kuadrit ligjore nga personat përgjegjës**.**

Rëndësia: i mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e mjedisit nga 7 subjektet me vlerë 1,850,000 lekë.

Titulli i gjetjes 8: *Probleme me vjeljen e të ardhurave të cilat realizohen nëpërmjet agjentëve tatimorë.*

Situata:

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave...., rezulton se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, por që janë të paplota, pasi në to nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK *(nga shitja e pasurisë)*, Drejtoria e Transportit *(për mjetet qarkullues)*, Drejtoria Rajonale Tatimore Prrenjas *(tatim fitim thjeshtuar).*

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Prrenjas janë paraqitur në *Tabelën nr. 5.*

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2021
D.....	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	414
D....	Tatim mbi të ardhurat personale	6,573
D.....	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	8,345
V.....	Taksa e kalimit të pronësisë	467
D....	Renta Minerare	162
TOTALI		**15,961**

Bashkia Prrenjas nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Prrenjas nuk ka bërë asnjë lloj analize për

mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Prrenjas, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.
Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Konstatojmë se sipas Drejtorisë së të Ardhurave.... Bashkia Prrenjas , mos arkëtimet nga ana e ASHK-së janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Prrenjas është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Prrenjas duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Kriteri:
Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", me ndryshime, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*", etj.

Ndikimi/Efekti:
Mungesa e një informacioni të saktë dhe të plotë për gjendjen financiare, për pritshmërinë nga të ardhurat që duhet të sigurohen nga agjentët tatimorë.

Shkaku:
Mos krijimi i bazave të të dhënave, mosfunksionimi i strukturave të bashkisë dhe paqartësia e personelit në lidhje me bazën ligjore të posaçme për këto kategori të ardhurash.

Rëndësia: ***E lartë***

Për këtë rekomandojmë:
Bashkia Prrenjas, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Për këtë rekomandojmë:
Kryetari i Bashkisë Prrenjas, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

-**Taksa e tokës bujqësore.** Nga të dhënat e pasqyrës, kjo taksë është realizuar në masën 73% ose nga vlera e planifikuar prej 4,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 2,939 mijë lekë.
Sipas të dhënave të marrë nga Drejtoria e Bujqësisë, Bashkia Prrenjas disponon gjithsej 5439 ha tokë, nga e cila tokë bujqësore e ndarë me 7501 prej 3646 ha dhe tokë bujqësore e pandarë 1793 ha. Familje që kanë përfituar tokë bujqësore janë 4919 familje.

Titulli gjetjes 9: *Mos arkëtim të taksës së karburanteve për autorizimet.*

Situata:
Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se në këtë njësi vendore ushtrojnë aktivitet 6 subjekte me destinacion tregtim karburanti.
Në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk aplikimi i taksës nuk është i saktë, po kështu dhe mënyra e arkëtimit nuk është zbatuar sipas ligjit.
Sipas bazës ligjore të mësipërme, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e liçencës duhet të paguajnë si më sipër.
Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifat vendore janë paraqitur në **Tabelën nr. 6, si vijon:**

Nr	Subjekti	NIPTI	ADMINISTRATORI	Lloji i Aktivitetit (Kodi1-10) Sipas paketës fiskale 2021	AUTORIZIMET 2021
1	L.L SHPK	J.....M	B.L.	Tregtim Nafte	Nr.03. date 05.10.2020
2	K.I SHPK	L.....J	E.J.	Tregtim Nafte	Nr.01 date 26.04.2018
3	R.Z	K....C	B.I.	TREGTIM GAZI	Nr.03 date 17.08.2017
4	K. SHPK	J.....P	SH.K.	Tregtim Nafte	Nr.378prot 06.02.2019
5	B.G SHPK	L....H	V.B.	Tregtim Nafte	Nr.2 date 28.12.2016
6	G.R	K....T	S.A.	Tregtim Nafte	Nr.01 date 18.06.2021

Nr	Subjekti	Detyrimi per karburante	Detyrimi për lëndë djegëse	Total detyrimi	Pagesë vetëm T.Autorizimi	Detyrimi i Mbetur pa Paguar
1	L.L SHPK	1,000,000	100,000	1,100,000	100,000	1,000,000
2	K.I SHPK	1,000,000	100,000	1,100,000	200,000	900,000
3	K. SHPK	1,000,000	100,000	1,100,000	867,051	232,949
4	G.R	1,000,000	100,000	1,100,000	778,917	321,083
TOTALI		**4,150,000**	**400,000**	**4,550,000**	**2,095,968**	**2,454,032**

Nga sa mësipërm vlera 2,454,032 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas.
Kriteri:
VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015[5], të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"
Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhet në vlerën 2,400,000 lekë.
Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.
Rëndësia: i *lartë*
Për këtë rekomandojmë:

[5] *"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."... "10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera".*

Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve bashkia Prrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrat9ive e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,454,032 lekë** nga **6 subjektet**, respektivisht;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti "L.LL" ShPK
- **vlera 900,000 lekë** nga subjekti "K.I" ShPK
- **vlera 232,949 lekë** nga subjekti "K." ShPK
- **vlera 321,083 lekë** nga subjekti "G.R" ShPK

- **<u>Të ardhura nga tarifa e ujët të pishëm</u>:** Sipas të dhënave të evidencës së realizmit, kjo tarifë është realizuar në masën 72%, ku nga vlera e planifikuar prej 20,000,000 lekë është arkëtuar vlera 14,343,956 lekë.

Sipas vetë analizës së bërë nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Prrenjas, konstatohet se kjo tarifë nuk është planifikuar saktë, duke evidentuar një të ardhura të paplanifikuar dhe ngarkuar abonentëve për vlerën **1,753,600 lekë**, konkretisht:
Tarifa e ujit të pishëm është vendosur me VKB në masën 400 lekë.

a- Abonentë me kontratë me ujësjellësit në NJA Qyteti Prrenjas është 440 abonentë.
b- Abonentë me kontratë me ujësjellësit në NJA Rrajcë është 2655 abonentë.
c- *Abonentë me kontratë me ujësjellësit në NJA Qukës është 1437 abonentë.*

Gjithsej familje me kontratë 4532 x 400 lekë/familje x 12 muaj = 21,753,600 lekë, duke planifikuar më pak vlerën **1,753,600 lekë, si ardhur munguar në buxhetin e bashkisë.**

<u>Titulli gjetjes 10:</u> *Menaxhimi i të ardhurave nga qiratë.*

<u>Situata</u>:
Sipas evidencës së të ardhurave për vitin 2021, rezulton se të ardhurat nga qiratë janë realizuar në masën 89%, ku nga vlera e planifikuar prej 6,200,00 lekë është arkëtuar vlera 5,533,081 lekë**.**
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se në Bashkinë Prrenjas operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontratë qiraje për HEC, Gurore, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, duke përllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 8,792,005 lekë, nga e cila likujduar vlera 6,001,818 lekë, duke mbetur pa likujduar vlera 3,816,519 lekë (*sipas aneksit 2.6.4 bashkëlidhur Projektraport auditimit*).
Në Bashkinë Prrenjas kanë lidhur kontratë qiraje 22 subjekte, si vijon:

f- 8 subjekte për HEC me vlerë kontrate vjetore 5,881,823 lekë.
g- 2 subjekte shfrytëzim karrierë me vlerë kontrate 74,000 lekë.
h- 2 subjekte veprimtarie ekonomie me vlerë kontrate 41,202 lekë.
i- 4 subjekte me veprimtari telefonisë celulare me vlerë kontrate vjetore 906,510 lekë.
j- 6 subjekte për kullota me vlerë kontrate 80,300 lekë.

Për subjektet të cilat kanë lidhur kontratë dhe nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale, nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), referuar nenit 5 pika 5.5 e kontratave, nuk janë llogaritur penalitet në masën 0.1% jo më shumën se 10%, **duke evidentuar një kamatëvonesë në vlerën 289,239 lekë** *(sipas aneksit 2.6.5 bashkëlidhur Projektraport Auditimit)***, si e ardhur munguar në buxhet**.
Nga përpunimi i të dhënave, konstatohet se sipas kërkesës së bere nga Bashkia Prrenjas në adresë të AKBN në lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore (karriera), nga kjo e fundit është konfirmuar me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 se në këtë njësi vendore ushtrojnë këtë lloje aktiviteti 19 subjekte, ku dy prej të

cilave janë me pezullim, dy kanë kontratë me bashkinë dhe 15 subjekte ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore **pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës**.
Me shkresën nr. 569, datë 18.2.2022 Bashkia Prrenjas ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që për 4 subjekte është kërkuar heqje nga fondi pyjore i sipërfaqeve sipas lejes minerale.
Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2050/1, datë 28.2.2022 është kthyer përgjigje se mungon një pjesë e dokumentacionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës dhe nga bashkia nuk është vijuar me tej.
Detyrimi i munguar në buxhetin e bashkisë Prrenjas vetëm për një vit ushtrimorë nga mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi përllogaritet në **shumën 20,488,050 lekë, e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raport Auditimit*).

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor", me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.

Ndikimi/Efekti:

Mos kryerja e kontrolleve në territorin e Bashkisë Prrenjas nga subjekte që shfrytëzojnë sipërfaqe pyjore/kullosore, çojnë në mos rigjenerim të ardhurash në buxhet dhe dëmtim të këtyre sipërfaqeve.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Prrenjas (L.L. me detyrë Drejtor Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave).

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për:

- Për subjektet të cilat nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale sipas afateve të përcaktuara në kontratë të llogaritet, kontabilizohet dhe arkëtohen **kamatëvonesat në vlerën 289,239 lekë** *(sipas aneksit 2.6.5 bashkëlidhur Raport Auditimit)***,** si e ardhur munguar në buxhet.
- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga **15 subjekte** që ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore *pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës* pa kontratë qiraje deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në vlerën **20,488,050 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raport Auditimit*), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.
- Për sipërfaqen rrugë kalimi dhe venddepozitimit që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Prrenjas.

- 15 shoqëritë që shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore/kullosore pa kontratë me Bashkinë Prrenjas, duke vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Prrenjas, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ne kundërshtim me dispozitat e akteve ligjore të ligjit të taksave, të menaxhimit të pronave dhe VKB ngarkohen me përgjegjësi:
J.B., me detyrë Drejtoresh e të Ardhurave Vendore**.**
A.A., me detyrë Përgjegjës i Drejtorisë të Ardhurave Vendore**.**
L.K., me detyrë Inspektor NJA Qukës**.**
E.D., me detyrë Inspektor NJA Rrjacë**.**
L.L., me detyrë Drejtor drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

<u>Pika 2.3 e programit</u>. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021.

Mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *"Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël"* pjesa e parë *"Rregulla të përgjithshme"* kapitulli i parë *"Mbajtja e kontabilitetit"* dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, *"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre*", ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007*"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj" dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".*

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar më datën 26.02.2021 në Degën e Thesarit Librazhd, brenda afatit ligjor.

<u>Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare</u>

Në fund të periudhës ushtrimore 2020 janë plotësuar 8 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

Formati 1 – Pasqyra e Pozicionit Financiar
Formati 2 – Pasqyra e Performancës Financiare
Formati 3 – Pasqyra e Flukseve Monetare (*Cash Flow)*
Formati 4 – Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/ Fondet Neto
Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese
Formati 6 – Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit

Formati 7/a – Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike
Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto
Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

- *Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike*.

Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 0 lekë.**
- Aktivet 2.223.536.136 lekë
- Pasivet 169.535.281 lekë
- Aktivet neto 2.054.000.855 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **388.907.121 lekë** dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 "*Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre*" në shumën 146.832.820 lekë;
Llogaritë e Klasës 3 "*Gjendje inventari qarkullues*" në shumën 42.242.721 lekë;
Llogaritë e Klasës 4 "*Llogari të arkëtueshme*" në shumën 164.277.576 lekë dhe "Të tjera aktive afatshkurtra" në shumën 35.554.004 lekë.

- **Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre" përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti i 2020	Diferenca 2021-2020
531	Mjete monetare ne arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	146,349,300	133,705,354	12,643,946
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera			
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi	-	-	-
Totali		**146,349,300**	**133,705,354**	**12.643,946**

Vlera e llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" në shumën 146,349,300 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "*Rezultati i vitit ushtrimor*" në shumën 101,612,424lekë; gjendja e llogarisë 466 "*Mjete në ruajtje*" në shumën 44,736,876 lekë. Mjetet ne ruajtje përbehen nga:
Mjete në ruajtje (pulla) në vlerën 1.538.000 lekë si dhe vlera e shpenzimeve të kaluara në Thesar, por të palikujduara nga sistemi bankar, në shumën 43,198,876 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

- **Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	18,623,749	17,081,798	1,541,951
32	Objekte inventari	23,400,012	23,197,339	202,673
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0

35	Mallra	218960	374697	-155,737
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje te pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	Totali	**42,242,721**	**40,653,834**	**1,588,887**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Prrenjas në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 42,242,721 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "*Materiale*" në vlerën 18,623,749 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "*Objekte inventari*" në vlerën 23,400,012 lekë.
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,588,887 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën 1,588,887 lekë.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021
Gjatë vitit 2021, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.211 datë 08.09.2021 për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve materiale për vitin 2021 të Bashkisë Prrenjas, përfshirë këtu dhe 3 njësitë administrative në territorin e Bashkisë Prrenjas. Nuk na është vënë në dispozicion relacioni I komisionit të inventarizimit, bazuar në urdhrin nr.211 datë 08.09.2021. Në përgjigje të urdhrit të inventarizimit, është hartuar urdhri për nxjerrjen jashtë përdorimit nr. 09 datë 24.01.2022, dhe relacioni në funksion të këtij urdhri, në datën 15.02.2022.

Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet
Procedura e Inventarizimit të aktiveve nuk është ndjekur për vitin 2019 dhe 2020, dhe nuk evidentohet asnjë dokumentacion mbi urdhrin e kryetarit për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për këto dy vite.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 5 ,74, 96-101, 102, 103 e tij.

Në të gjitha rastet gjatë vitit 2021, këto urdhra janë përpiluar vetëm për materialet, inventarët e imët, inventarin ekonomik duke përjashtuar inventarizimin e përkatësisht; llog 210 *Toka, troje, terrene;* llog 211 *Pyje Plantacione;* llog 212 *Ndërtesa e Konstruksione;* llog 213 *Rruge, rrjete, vepra ujore;* llog 214 *Iinstalime teknike, makineri e paisje;* llog 215 *Mjete transporti.*

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 1,623,749 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2021	17,081,798
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2021	43,634,032
Dalje nga magazina gjatë vitit 2020	42,092,081
Gjendja në 31.12.2020	**18,623,749**

Llogaria 35 "Mallra", ka vlerën 218,960 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2021	374,697
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2021	3,907,753
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	4,063,490
Gjendja në 31.12.2021	**218,960**

Llogaria 327 "Objekte inventari", ka vlerën 23,400,012 dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	23,197,339
Hyrje gjatë vitit 2021	4,946,458
Dalje gjatë vitit 2021	4,743,785
Gjendja në 31.12.202	23,400,012

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Prrenjas ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit 211, datë 08.09.2021, ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme"&"Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 200	Diferenca 2021-2020
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			
44	Institucione te tjera publike			
466	Kreditore per mjete ne ruajtje			
468	Debitorë te ndryshëm	78,851,921	47,898,097	30,953,824
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	85,425,655	80,758,369	4,667,286
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)	0	0	0
	Totali	**164,277,576**	**128,656,466**	**35,621,110**
	Të tjera aktive afatshkurtra	**0**	**0**	
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	35,554,004	39,012,416	-3,458,412

	Totali	35,554,004	39,012,416	-3,458,412

Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", në fund të vitit 2021 është 78,851,921 lekë e cila përbehet nga shuma prej 1,000,000 lekë, të debitorëve e zënë debitorët e gjobave te IVMT, Bashkise dhe debitorët e tatim taksave te krijuara nder vite ne shumen 77,851,921 leke

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	47,898,097
Shtesa gjatë vitit 2021 debitorët e taksave (D)	30,953,824
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	
Gjendja në 31.12.2021	**78,851,921**

Llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*", në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 85,425,655 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 85,425,655 lekë. Vlera prej 85,425,655 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	80,758,369
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	4,667,286
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2020	**85,425,655**

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-409	68,872,078
Paga personeli llog 42	11,930,507
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	617,801
Sigurime shoqërore llog.435	3,522,665
Sigurime shëndetësore llog.436	482,604
Totali	**85,425,655**

Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 35,554,004 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	39,012,416
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	3,458,412
Gjendja në 31.12.2021	**35,554,004**

Vlera e kësaj llogarie në shumën **35,554,004** lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2021 ka patur një pakësim të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Shpenzime gjyqësore	977,650
Shpenzime operative	11,756,834
Shpenzime për investime+FSHZH	22,819,520
Totali	**35,554,004**

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, pika 42 .

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "*Aktivet Afatgjata Jo materiale*", përbëhen nga llog.202 "Studime dhe kërkime", në vlerën 13,137,127 lekë. Sipas llogarisë analitike (Tabela anekse nr.1) vlera e kësaj llogarie është lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	6,037,127
Shtesa gjatë vitit 202 (D)	7,100,000
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
Gjendja në 31.12.2020 (D)	**13,137,127**

Llogaria 202 *"Studime dhe Kërkime"* paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto 13,137,127 lekë, dhe në fund të vitit 2020 në vlerën neto 6,037,127 lekë, shifër kjo e mbartur që nuk i dihet origjina. Diferenca në rritje vjen për shkak të 2 projekteve infrastrukturore me vlerë 7,100,000 lekë. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Pikërisht kjo vlerë konsiston në 5 projekte, disa prej tyre të trashëguara dhe nga ish komunat sot njësi administrative, me vlerë kontabël neto prej 1,173,980 lekë. Në mënyrë të detajuar po i paraqesim si më poshtë;

Projekte, studime dhe kërkime me vlerat përkatëse gjendje më 31.12.2021

Nr	*Emertimi i projektit*	VLERA FILLESTARE E A.A JO MATERIALE	VITI
1	STUDIME PROJEKTIME	117,980	**2007**
2	PROJEKT OBJEKTI UJSJELLSI LIRAS STRANIK	238,200	**2009**
3	STRAVAJ	191,000	**2009**
4	PROJEKT OBJEKTI UJSJELLSI LIRAS STRANIK	158,800	2010
5	Hartim Projekti, Asfaltim unaza e madhe e qytetit Prrenj	468,000	2012
6	zeza te Qytetit Prrenjas	3,500,000	2021
7	Urak, Kotodesh,Katjel nj.Adm. Rrajce	3,600,000	2021
	Shuma	8,273,980	

Gjithashtu kemi një diferencë prej 4,863,147 lekësh , e cila është pjesë e bilancit, por nuk i dihet origjina dhe në mënyrë analitike se çfarë projekti është, dhe është vepruar duke e regjistruar vetëm me mbartjen e viteve të kaluara.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël.

***Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si**: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet*

në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM"
Kreu II. "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" **Pika 16/b.d** .

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)
Llogaritë e Klasës 21 "*Aktivet Afatgjata Materiale*", AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 1,678,957,253 lekë. Në vitin paraardhës 2020, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,495,272,766 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 183,684,487 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore, ne Bashkinë Prrenjas dhe NJ.A.

Llogaria	Emertimi	Gjendja me 31.12.2020	Shtesa viti 2021	Paksime viti 2021	Gjendja 31.12.2021
202	Studime dhe kerkime	6,037,127	7,100,000		13,137,127
210	Toka,troje,Terene	4,918,360			4,918,360
211	Pyje,Kullota Plantacione	17,417,275	5,510,830		22,928,105
212	Ndertime e Konstruksione	657,360,547	26,312,707		683,673,254
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	970,033,140	194,155,798		1,164,188,938
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	17,508,834	1,540,872	558,552	18,491,154
215	Mjete transporti	51,396,396	2,800,000		54,196,396
216	Rezerva shtetrore				-
217	Kafshe pune e prodhimi				-
218	Inventar ekonomik	45,341,675	10,383,719	3,292,254	52,433,140

Këto llogari janë mbajtur në bilancin kontabël pa pasur një analitik ku të përcaktohet origjina e vlerës së llogarisë, pra nga ka ardhur kjo shifër, por nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës zotërohet informacion vetëm për shtesat e vitit për llogaritë 201, 2011, 212, 213, 214 dhe 215. Gjithashtu fakti që nuk ka një regjistër kontabël për asetet, e vështirëson më tej njohjen dhe verifikimin e saktësisë së vlerave kontabël të llogarive AAGJ Materiale.
Mosnjohja e origjinës së aktiveve është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: *"Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm"*
Nga auditimi ka rezultuar se, nga këto AAGJ Materiale, vetëm 30 prej tyre janë pajisur me titull pronësie dhe pjesa tjetër nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.
Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme".

Llogaria 215 "*Mjete transporti*". Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Prrenjas më datë 31.12.2021 në shumën 51,396,396 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm është shtuar në vlerën 54,196,396 lekë dhe është pakësuar me shumen e amortizimit ne shumen (15,767,078) lekë .

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	51,396,396
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	2,800,000

Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	15,767,078
Gjendja në 31.12.2021 (D)	**38,429,318**

Tabela nr. 2- Llogaria analitike 215

	Makinat e Bashkise			
Nr	**Emërtimi**	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Kamioni AA ...PU	1	2460000	2460000
2	Eskavator	1	9055196.4	9055196.4
3	Fadrome	1	3540000	3540000
4	Rimorkiator	1	1320000	1320000
5	Mitsubishi Pajero	1	2000000	2000000
6	Eskavator me zinxhir	1	3480000	3480000
7	Fadrome Benati Trans	1	2100000	2100000
8	ML AA 542 EC	1	1490000	1490000
9	Landrover zjarrfikësja	1	1290000	1290000
10	Automjet Mitsubishi L....4SA	1	1680000	1680000
11	Fadrome	1	4380000	4380000
12	Mitsubishi AA... RZ	1	1800000	1800000
13	Kamionçina LB ... A	1	590400	590400
14	Makine gjelberimi AA...ZD	1	1980000	1980000
15	Autoveturë Suzuki AA ...	1	694800	694800
16	Autoveturë Daisler 8..	1	1800000	1800000
17	Fadrome	1	2592000	2592000
18	Treaks AA ...ZS	1	3744000	3744000
19	Rul Ngjeshes	1	1740000	1740000
20	Zjarrfikës AA...RM	1	1980000	1980000
21	Automjet Mitsubishi AA...R	1	1680000	1680000
22	Ford Ranger vp 2009 A.K.	1	1360000	1360000
23	Mercedes Benz ML 2... F.K.	1	1440000	1440000
	Shuma			54196396.4

Llogaria kontabël 218 "*Inventar ekonomik*". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Prrenjas. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Prrenjas gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 52,433,140 lekë. Krahasuar me vitin 2020 llogaria 218 "Inventari ekonomik" është shtuar në vlerën 10,383,719 lekë, si dhe nxjerrje jashtë përdorimi per shumen 3,292,254 leke. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i blerjeve të kryera gjatë vitit 2021 për:
Blerje me pagesë:853,128 lekë, shtesa pa pagese 9,530,591 leke.

Lëvizjet Llog. 218 "Inventar ekonomik" për vitin 2021, vlera në lekë	
Çelje me 01.01.2021	**45,341,675**
Blerje me pagesë (D)	10,383,719
Dalje (K)	4,391,515
Gjendja me 31.12.2020 (D)	**8,311,071**

Shtesa në vlerën 1,342,035 lekë midis shtesës së pasqyruar në llog 218 në shumën, përfaqëson shtesën ne blerje te inventarit ekonomik.

Llogaria 219 "*Amortizimi i AAGJM & AAJM*":

Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 36.

Llogaria 230 dhe 231"*Investime*" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në

vlerën 142,534,635 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 142,534,635 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0
2	Aktive Afatgjata materiale	142,534,635
3	**Totali**	**142,534,635**

Aktivet Afatgjata Financiare

Testet substanciale

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2020 dhe 2021 në vlerën 0 lekë.

Ky seksion i bilancit kontabël 2020 dhe 2021 është paraqitur në vlerën zero siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 42,08% të aksioneve të "U.....E" sh.a. me *NUIS "J....V"* e cila është shoqëri aksionere me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve*". Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 415,720 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **415,720,000** lekë

Kjo vlerë e kapitalit me 42,08 % aksione në Pjesmarrje të Bashkisë Prrenjas në "U.....E " Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021 ,më konkretisht në llogarinë ***26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta"*** në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 *"Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesmarrje*" .

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **174,935,046** lekë dhe investitor është Bashkia Prrenjas.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesmarrje me vlerë kontabël **174,935,046** lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar dhe për këtë procedurë.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Prrenjas më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	68,872,078	87,197,038	-18,324,960
42	Detyrime ndaj personelit	11,930,507	11,502,091	428,416
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	617,801	549,802	67,999
435	Sigurime shoqërore	3,522,665	3,347,689	174,976
436	Sigurime shëndetësore	482,604	464,638	17,966
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	44,736,876	37,854,010	6,882,866
467	Kreditorë të ndryshëm	39,372,750	46,681,418	-7,308,668

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	0	0	0
	Gjendja më fund të periudhës	**169,535,281**	**187,596,686**	**-18,061,405**

Llogaria 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*", në fund të vitit 2021 është në vlerën 68,872,078 lekë, paraqet gjendjen e kontratave të pa likuiduara nga Bashkia Prrenjas më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"	
Çelje e vitit 2021	87,197,038
Shtesa (K)	
Pakësime (D)	18,324,960
Gjendja në 31.12.2021 (K)	**68,872,078**

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 68,872,078 lekë përbëhet nga fatura, kontrata te lidhura të palikujduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në muajin janar të vitit pasardhës në shumën 68,872,078 lekë.

Llogaria 42, "*Detyrime ndaj personelit*", sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Prrenjas, paraqitet në vlerën **11,930,507** lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2021 ne shumen **11,930,507** leke.

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2021, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	**Datë**	
11	10.01.2022	6,119,653
12	10.01.2022	323,161
13	10.01.2022	458,881
14	10.01.2022	310,897
15	10.01.2022	188,940
16	10.01.2022	83,313
17	10.01.2022	959,322
18	10.01.2022	36,123
19	10.01.2022	659,949
20	10.01.2022	135,562
21	10.01.2022	134,186
22	10.01.2022	202,112
23	10.01.2022	2,114,739
24	10.01.2022	140,677
26	19.01.2022	12,000
27	19.01.2022	10,000
28	19.01.2022	7,992
37	19.01.2022	33,000
Totali		**11,930,507**

Llogaria 431, "*Detyrime ndaj shteti për tatim taksa*", paraqitet në vlerën 617,801 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne Janar 2021.

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	**Datë**	
1	10.01.2022	286,227
2	10.01.2022	19,305
3	10.01.2022	21,338

Urdhër shpenzimi		Vlera
4	10.01.2022	14,128
5	10.01.2022	5,151
6	10.01.2022	22,010
7	10.01.2022	56,551
8	10.01.2022	9,027
9	10.01.2022	4,738
10	10.01.2022	179,326
Totali	**10.01.2022**	**617,801**

Llogaria 435, "*Sigurime shoqërore*" dhe llogaria **436 "*Sigurime shëndetësore*"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 3,522,665 lekë dhe 482,604 lekë.

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
1	10.01.2022	2,137,703
2	10.01.2022	150,243
3	10.01.2022	**104,384**
4	10.01.2022	**63,803**
5	10.01.2022	**27,795**
6	10.01.2022	**323,447**
7	10.01.2022	**281,293**
8	10.01.2022	**44,481**
9	10.01.2022	**43,649**
10	10.01.2022	**828,471**
Totali		**4,005,269**

Llogaria 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Prrenjas, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 44,736,876 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Prrenjas.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2021	**37,854,010**
Shtesa	10,626,949
Pakësime	-3,744,083
Gjendja në 31.12.2020	**44,736,876**

Llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqesore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 39,372,750 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2021	46,681,418
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	7,308,668
Gjendja në 31.12.2021	**39,372,750**

Siç shihet edhe nga tabela llogaria 467 paraqitet në vlerën **39,372,750** lekë e përbërë nga:

- *shpenzime të kryera por të pafinacuara per mallra dhe shërbime ne masën 11,756,834 dhe që janë pasqyruar në llogarinë 486 në shumën 35,554,004 lekë;*
- *shpenzimet për vendime gjyqesore në shumën 977,650 lekë;*
- *shpenzime per investime por të pa likuiduara në shumën 22,819,520 lekë.*

- *Detyrime per muajin Dhjetor 2021 ne mallra, shërbime, investime ne shumen 3.818.746 leke (fatura te dhjetorit 2021).*

Ky zë i bilancit përfaqëson detyrimet e vitit si dhe detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Prrenjas nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2022 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021, kjo për subjektin SH. me vlerë 447,084 lekë.
Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021, ka nënvlerësuar llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" me 8,941,675 lekë.
Ky veprim është bërë në kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare" ku përcaktohet qartë së detyrimet njihen në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve.
Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" të detyrimeve për faturat e likujduara në 2022 por me kompetencë vitin 2021, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 8,941,675 lekë.

Llogaria 85 "*Rezultati i ushtrimit*", paraqitet me tepricë kreditore në vlerën **101,612,424** lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Prrenjas trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"	
Çelje e vitit 2021	**133,705,354**
Shtesa	0
Pakësime	32,092,930
Gjendja në 31.12.2021	**101,612,424**

<u>Pasqyra e Performancës financiare (F2)</u>
Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Prrenjas më datë 31.12.2021 janë të kuadruar me Degën e Thesarit Librazhd , konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera
-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	71,553,200	Aktrakordimin me Degën e Thesarit	71,553,200
-Të ardhurat jo tatimore te krijuara gjatë vitit	21,127,654	Aktrakordimin me Degën e Thesarit	21,127,654
-Granti nga buxheti	675,057,344	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	675,057,344
-Financim i pritshëm nga buxheti	92,630,505	Sipas llogarisë 7206	92,630,505
Totali të ardhura	**860,368,703**	**Totali të ardhura**	**860,368,703**

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2019	Detyrime të vitit 2020	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	170,758,156			
601	28,454,158			
602	77,805,288			
604	0			
606	483,327,564			
63	-1,588,887			
Totali	**758,756,279**			

Diferenca në shumën 900,849 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca midis detyrimeve të muajit Dhjetor 2019 të paguara në Janar 2020 dhe detyrimeve të Dhjetorit 2020 të paguara në Janar 2020 në shumën 874,552 si dhe vlerës prej 26,297 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".
Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 “shpenzimet” dhe klasës 7 “të ardhurat”, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	**860,368,703**	860,368,703	0
II	Shpenzime	**758,756,279**	758,756,279	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	101,612,424		
IV	**Rezultati i vitit ushtrimor**	**101,612,424**		

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën 101,612,424 lekë, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	250,380,837	240942077
II	Veprimtaritë e investimeve	-237,905,691	-239015701
III	Transferta e te tjera	0	0
IV	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	134,357,674	132431298
V	**Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor**	**146,832,820**	**134357674**

Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 146,832,820 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 146,832,820 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare”.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Numër llogarie	Emërtimi	Fonde bazë dhe grante kapitale	Rezultatet e mbartura	Rezultatet e ushtrimit	Gjithsej aktive neto/fonde neto
101	Aktivet neto	1,895,409,298			1,895,409,298
	Ndryshimet në aktivet neto		-133,705,354	292,296,911	158,591,557
	Nga burime të brendshme		-133,705,354	292,296,911	158,591,557
105	Grante të brendshme kapitale				0
	Transferta të brendshme (grante në natyre)			10,414,663	10,414,663
1013	Nga konsumi i AAGJ			-53,168,633	-53,168,633
1015	Dalje jashtë përdorimi			- 3,850,806	- 3,850,806
115	Fonde te veta te investimeve			237,289,263	237,289,263
12	Nga Rezultatet e mbartura		-133,705,354	0	-133,705,354
85	Nga rezultati i vitit ushtrimor			101,612,424	101,612,424
Totali		1,895,409,298	-133,705,354	**292,296,911**	**2,054,000,855**

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 2,054,000,855 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

- *Vlera prej 237,289,263 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".*
- *Vlera prej 53,168,633 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor.*
- *Vlera prej 101,612,424 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85 dhe llog. 12.*
- *Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën 2,054,000,855 lekë kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".*

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Titulli gjetjes 1: *Mbi kontabilizimin e Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.*

Situata:

Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 627,348,792 lekë, përveç 30 objekteve, pjesa tjetër nuk është pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive si më poshtë:

- llog 210 "Toka troje terrene", elementë në vlerën neto 4,918,360 lekë.
-llog. 211 "Pyje plantacione", elementë në vlerën neto 22,928,105 lekë.
-llog. 212 "Ndërtesa e konstruksione", objekte me vlerën neto 599,502,327 lekë .

-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Kriteri:

VKM nr. 500, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", ku cilësohet:
"1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.
2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen".

Ndikimi/Efekti:
Mungesa e titullit të pronësisë:
- është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;
- është pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.
- ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Titull i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme.

Shkaku:
-Nga ballafaqimi i problematikës, gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje edhe pas 5 vitesh nga kryerja e këtij procesi janë:
-dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat;
-vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;
-kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:
Bashkia Prrenjas duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Rajonale Librazhd dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Titulli i gjetjes 2: *Mbi kontabilizimin e llogarisë AAGJJM 202 "Studime e kërkime".*

Situata:
Llogaria 202 "*Studime dhe Kërkime*" paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto 13,137,127 lekë, dhe në fund të vitit 2020 në vlerën neto 6,037,127 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të 2 projekteve infrastrukturore me vlerë 7,100,000 lekë. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Pikërisht kjo vlerë konsiston në 5 projekte, disa prej tyre të trashëguara dhe nga ish komunat sot njësi administrative, me vlerë kontabël neto prej 1,173,980 lekë.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr. 5 datë 21.2.2022 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".* Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 202 "Studime e kërkime".

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rishihet dhe vet llog. 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 1,173,980 lekë.

Titulli gjetjes 3: *Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 "Aktivet Afatgjata Financiare".*

Situata:

Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 42,08% të aksioneve të "U.....E" sh.a. me *NUIS "J....V"* e cila është shoqëri aksionere me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtje e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve*". Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 415,720 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **415,720,000** lekë

Kjo vlerë e kapitalit me 42,08 % aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Prrenjas në "U.....E " Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021 ,më konkretisht në llogarinë 26 "*Pjesmarrje në kapitalet e veta*", në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 *"Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*" .

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **174,935,046** lekë dhe investori është Bashkia Prrenjas.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **174,935,046** lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".
Ndikimi/Efekti:
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet", gjendje kjo e nën vlerësuar me 174,935,046 lekë.
Shkaku:
Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara", Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale" dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 "Investime në Pjesëmarrje".
Rëndësia: I lartë
Për këtë rekomandojmë:
Nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 42,08% në kapitalin aksionar të "U.....E " sh.a me vlerë kontabël **174,935,046** lekë në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Buxhetit A.B. dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik S.K.

Pika 2.4 e programit. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Titulli gjetjes 1. *Statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1117/17, datë 17.01.2022.*

Situata: *Nga auditimi rezulton se*:
- KLSH-ja me shkresën e saj nr. 1117/17 prot, datë 17.01.2022 ka dërguar në Bashkinë Prrenjas rekomandimet e auditimit. Bashkia Prrenjas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje, **duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor**.
- Bashkia Prrenjas duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 17.6.2022, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA me shkresën nr. 1117/17, datë 17.01.2022. Nga Bashkia Prrenjas nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit.
- Bashkia Prrenjas ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve, **por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak). Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i

njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.
- *Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar* **11 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa.
- ***Për masa mungesë të ardhurash*** janë rekomanduar **6 masa** me vlerë **58,782,491 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 58,190,294, nga e cila likujduar vlera 12,840,136 lekë dhe mbetur per likujdim vlera 45,350,158 lekë, si dhe nuk është zbatuar një masë në vlerën 592,197 lekë.
- ***Për masa disiplinore***, janë rekomanduar gjithsej **15 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

Kriteri:
Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenet 15 dhe 30, si dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50-Auditimi i jashtëm.
Ndikimi/Efekti:
Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **45,942,355 lekë**.
Shkaku: Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e strukturave drejtuese.
Rëndësia: i ***mesëm***
Për këtë rekomandojmë:
Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1117/17, datë 17.01.2022 "*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Prrenjas*", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për*:
- **6 masa** organizative.
- **6 masa** mungesë të ardhurash në vlerën **45,942,355 lekë.**
- Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Shërbimit Civil, për masat e marra nga Komisioni Disiplinorë për 15 punonjësit e Bashkisë Prrenjas, referuar shkeljeve të evidentuara nga raportin përfundimtar të auditimit dhe përcjellë subjektit për zbatim me shkresën nr. 114/17, datë 17.01.2022.

Për këtë rekomandojmë:
Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH.
Më hollësisht për çdo rekomandim dhe statusi përkatës është paraqitur në Aneks 2.4, bashkëlidhur Raport Auditimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në buxhetin e Bashkisë Prrenjas gjatë vitit 2021 kanë ndodhur **3** ndryshime me vlerë 17,803 mijë lekë, duke marrë angazhime buxhetore të vitit ushtrimor, por të paparashikuara në PBA 2000-2022, *konkretisht*:
-Ndërtim i një këndi të ri lojërash me fond 1,500 mijë lekë.
- Rikonstruksion i rrugës lagjja Gega Rrajve – Sutaj (NJA Rrajcë) me fond 600 mijë lekë.
- Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në Bashkinë Prrenjas me fond 560 mijë lekë.

- Rikonstruksion i rrugëve të brendshme, rruga 1 Qershori/rruga 5 Maji me fond 8,262 mijë lekë .

Këto veprime tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Mos realizimet dhe ndryshimet në buxhet tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit*" i ndryshuar, pikat 253 dhe 354. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social, në bashkëpunim sektorët e tjerë në Bashkinë Prrenjas, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara për vitin 2021 paraqitet në masën 82 %, ku nga vlera planifikuar prej 727,420 mijë lekë është realizuar vlera prej 496,829 mijë lekë, kjo nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve dhe parashikimit të investimeve dhe pa dokumentacion të rregullt (mungesë projektesh), veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave dhe pa dokumentacionin përkatës ligjorë.

Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), të cilat janë mbajtur pjesërisht konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin **2021** ato janë në shumën **35,554 mijë lekë.**

Sipas të dhënave të buxhetit të vitit 2021, konstatohet se nga bashkia nuk është planifikuar për likujdim e gjithë vlera e faturave të palikujduara e cila është në shumën 35,554 mijë lekë, por është planifikuar në masën 44.5% ose në vlerë 38,395 mijë lekë, *nga e cila:* për llog. 602 në shumën 11,757 mijë lekë dhe për llog 230+231 në shumën 22,819 mijë.

Situata financiare e bashkisë Prrenjas, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 10% të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

Mos planifikimi i plotë e vlerës së faturave të palikujduara me miratimin e buxhetit, si dhe mos zbatimi i radhës së pagesës, janë veprime në kundërshtim me nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" me ndryshime; ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48, me UMF

nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar. pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social Bashkia Prrenjas, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

2.2. Rekomandimi: Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Prrenjas.

2.3. Rekomandimi: Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Prrenjas, financuar nga Ministritë e linjës, konstatohet se në 4 kontrata me vlerë 308,368 mijë lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore duke lidhur kontratë me operatorë ekonomik pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës.

Peshën kryesore të shpenzimeve vjetore e zënë transferta specifike/kushtëzuara në masën 69.8% ose me vlerë 696,041 mijë lekë, ku me të ardhurat e veta bashkia mbulon 6.6% të totalit të shpenzimeve, ndërsa me grande të pakushtëzuara mbulon 23.4% të totalit të shpenzimeve. Mos realizimi i shpenzimeve për investime dhe shërbime vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave ose planifikimit të procedurave mbi nevojat e fondeve që kjo bashki ka, pra nga Bashkia Prrenjas në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore.

Për periudhën 2021 nga Bashkia Prrenjas janë ndërmarrë 5 angazhime të reja buxhetore përtej datës 15 tetor me vlerë totale 46,756,526 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike dhe shërbimeve të ndryshme.

Nga zbatimi i buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrenjas, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore për vlerën **16,271,913 lekë**, *nga e cila vlera përmbarimore 1,422,359 lekë dhe vlera e detyrimit prej 14,829,554 lekë (aneksi bashkëlidhur aktit),* si dhe pagesën për të njëjtën vend pune të dy punonjësve, duke mos respektuar radhën e likujdimet të tyre, sipas parimit "hyrje e parë-dalje e parë", pavarësisht faktit se bashkia në fund të vitit 2021 ka patur disponibilitete në thesar.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime, në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në

kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.
Në strukturën organizative të Bashkisë Prrenjas, konstatohet se nga 77 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, janë të lira 63 porcione, vendet e të cilave janë zënë nga punonjës me kontratë për një periudhë të gjatë kohore që varjon nga 1 deri në 3 vite. Pozicionet e punës të përcaktuar me status nuk kanë funksione të ngjashme me pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat duhet të rishihen.
Evidentohet një numër i konsiderueshëm të emërimit të punonjësve në pozicione jo të përshtatshme ku duhet të jenë punonjës me status dhe vijojnë pagesën e marrëdhënieve financiare.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ;
Nenin 108, pika (i) dhe (ii) e shkronjës (a) dhe shkronjës (ç), të ligjit nr. 44/2015 "Kodi Procedurës Administrative i RSH"; Ligjit nr. 152/2013, datë 30/05/2013 "Për Statusin e Nëpunësit Civil" i ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 18.3.2015.
Pikat 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
Pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore", i ndryshuar;
Nenin 70 dhe nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar;
Pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
Shkronja "a" në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
Nenin 47 dhe 51 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar/ Shërbimi Social dhe Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Publike, të marrin masat për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve të reja buxhetore përtej afatit ligjor.

Në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. Gjithashtu për çdo rast të likujdimet të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, në urdhrin e autorizimit të shpenzimit, të evidentohet dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësisë administrative, të punonjësit përgjegjës.
3.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për:
- Plotësimin e strukturës organizative me punonjës me status të Nëpunësit Civil, duke eliminuar praktikat e zëvendësimit të tyre me punonjës me kontratë mbi periudhën e provës.
- Rishikimin e strukturës së punonjësve dhe rritjes së numrit të organikës së pa nevojshme, si dhe të rishikojë kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Prrenjas.

Brenda datës 31.12.2022

4. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave...., rezulton se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, por që janë të paplota, pasi në to nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK *(nga shitja e pasurisë)*, Drejtoria e Transportit *(për mjetet qarkullues)*, Drejtoria Rajonale Tatimore Prrenjas *(tatim fitim thjeshtuar).*
Bashkia Prrenjas nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Prrenjas nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Prrenjas, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.
Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Konstatojmë se sipas Drejtorisë së të Ardhurave.... Bashkia Prrenjas, mos arkëtimet nga ana e ASHK-së janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Prrenjas është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Prrenjas duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme, në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", me ndryshime, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*", etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë masa për të krijuar bazën e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.
4.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Brenda datës 31.12.2022

5. Gjetje nga auditimi: KLSH-ja me shkresën e saj nr. 1117/17 prot, datë 17.01.2022 ka dërguar në Bashkinë Prrenjas rekomandimet e auditimit. Bashkia Prrenjas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH **nuk ka kthyer përgjigje**, duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor.
Bashkia Prrenjas duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 17.6.2022, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA me shkresën nr. 1117/17, datë 17.01.2022. Nga Bashkia Prrenjas nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit. Bashkia Prrenjas ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve, por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak).
- *Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar* **11 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa.
- *Për masa mungesë të ardhurash* janë rekomanduar **6 masa** me vlerë **58,782,491 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 58,190,294, nga e cila likujduar vlera 12,840,136 lekë dhe mbetur per likujdim vlera 45,350,158 lekë, si dhe nuk është zbatuar një masë në vlerën 592,197 lekë.
- *Për masa disiplinore*, janë rekomanduar gjithsej **15 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.
Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" nenet 15 dhe 30, si dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50-Auditimi i jashtëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 71-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 117/17, datë 17.01.2022 "*Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Prrenjas*", duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për*:
- **6 masa** organizative.
- **6 masa** mungesë të ardhurash në vlerën **45,942,355 lekë.**
- Njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Shërbimit Civil, për masat e marra nga Komisioni Disiplinorë për 15 punonjësit e Bashkisë Prrenjas, referuar shkeljeve të evidentuara nga raportin përfundimtar të auditimit dhe përcjellë subjektit për zbatim me shkresën nr. 114/17, datë 17.01.2022.

Brenda datës 31.12.2022

5.2. Rekomandimi:
Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm sipas komponentëve u konstatua se në lidhje me:
Komponenti "Mjedisi i kontrollit":
Bashkia Prrenjas nuk ka Kod të Etikës, por në nenet 13 dhe 14 të Rregullores së Brendshme me vendim nr. 38 date 04.03.2019 me nr. prot 697, ku ne nenin 13 është përfshirë disiplina formale dhe administrative me 8 rregullat e saj dhe ne nenin 14 është përfshirë etika per punonjësit e bashkisë Prrenjas dhe kodi i veshjes me 10 rregullat e saj. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste. Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, nuk janë hartuar rregullore. Nuk ka programe të

trajnimit për integritetin dhe sjelljen. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për përformancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga UK sha Librazhd ,Bashkia Prrenjas e cila është aksionere me 49 % te aksioneve mungojnë raportimet periodike për përformancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat . Mungon një program strategjik institucional me prioritetet dhe objektivat dhe plan-veprimet e realizimit të tyre. Në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës. Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune, por nuk janë rishikuar për çdo vit dhe nuk janë miratuar në DAP. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme

Komponenti "Menaxhimi i Riskut":

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Është përcaktuar koordinatori i riskut Kryetari i bashkisë N.B., por nuk është përcaktuar grupi i punës së riskut. Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku te bëhet identifikimi dhe vlerësimi i risqeve dhe nuk janë përcaktuar veprime për të të adresuar mangësitë në disa fusha kryesore si: në fushën e taksave dhe tarifave vendore, në fushën financiare për ndjekje e debi-kredive dhe akumulimi i borxhit dhe në fushën e prokurimeve publike, *duke mos* identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit

Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit":

Bashkia Prrenjas nuk disponon nje regjistër te aktiveve afatgjata materiale. Bashkia Prrenjas nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT si dhe mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari.

Komponenti: "Informimi dhe komunikimi":

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Komponenti: "Monitorimi":

Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Në Bashkinë Prrenjas mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Prrenjas mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. Në Bashkinë Prrenjas aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 në faqen 20-21, të Raport Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë risqeve; për miratimin dhe përmirësimin e rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike; të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara dhe ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara; gjithashtu zhvillimin e programeve të trajnimeve nga punonjës brenda Bashkisë si dhe të punohet për plotësimin e kërkesave të komponentëve të MFK.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 100%. NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit te auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim "vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Në disa raste formulimi i gjetjeve ka mangësi, pasi situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, në ndonjë rast nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si apo nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra "në zbatim të akteve ligjore", duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagesave sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikan 2.1.2 faqen 21-22, të Raport Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim i auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 627,348,792 lekë, përveç 30 objekteve, pjesa tjetër nuk është pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:
- llog 210 "*Toka troje terrene*", elementë në vlerën neto 4,918,360 lekë,
-llog. 211 "*Pyje plantacione*", elementë në vlerën neto 22,928,105 lekë,
-llog. 212 *"Ndërtesa e konstruksione*", objekte me vlerën neto 599,502,327 lekë,
-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-71, të Raport Auditimit)*
8.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik, të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Brenda datës 31.12.2022

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 "*Studime dhe Kërkime*" paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto 13,137,127 lekë, dhe në fund të vitit 2020 në vlerën neto 6,037,127 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të 2 projekteve infrastrukturore me vlerë 7,100,000 lekë. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Pikërisht kjo vlerë konsiston në 5 projekte, disa prej tyre të trashëguara dhe nga ish komunat sot njësi administrative, me vlerë kontabël neto prej 1,173,980 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-71, të Raport Auditimit)*
9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rishihet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 1,173,980 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Prrenjas, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 42,08% të aksioneve të "U.....E" sh.a. me *NUIS "J....V"* e cila është shoqëri aksionere me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtje e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve*". Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 415,720 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **415,720,000** lekë
Kjo vlerë e kapitalit me 42,08 % aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Prrenjas në "U.....E " Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021 ,më konkretisht në llogarinë 26 *"Pjesmarrje në kapitalet e veta"*, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me

Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 *"Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*"
Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **174,935,046** lekë dhe investori është Bashkia Prrenjas.
Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **174,935,046** lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-71, të Raport Auditimit)*
10.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 42,08% në kapitalin aksionar të "U.....E " sh.a me vlerë kontabël **174,935,046** lekë në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës të lejes së zhvillimit nr. 57, datë 09.11.2018, Lejet e ndërtimit Faza I me nr.61 datë 26.06.2019, si dhe leja e ndërtimit nr. 56 datë 13.07.2021 për Fazën II të ndërtimit me objekt "Qendër Tregtare multifunksionale, 3 kate mbi toke dhe 1 kat nëntoke në Prrenjas" , *rezulton se*:
Gjurma e ndërtimit për të dy fazat, Faza I me një sipërfaqe 930 m^2 dhe Faza II me një sipërfaqe prej 700 m^2, tejkalojnë gjurmën e ndërtimit të përcaktuar në lejen zhvillimore totale nr. 57, datë 09/11/2018 (1575 m^2), duke bërë kështu shkeljen e parametrit të KSHT-së së përcaktuar në lejen zhvillimore. Pra KSHT-ja e rillogaritur = (930 + 700)m^2/ 3150m^2= **51.75%,** > 50%, në kundërshtim me Rregulloren e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Prrenjas miratuar me Vendim KKT-je nr. 3 datë 14.04.2017, neni 39 pika 2, si dhe nenin 14 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.
Sipërfaqja ndërtimore mbi tokë për të dy fazat paraqitet prej 4,720.8 m^2, ku në fazën e parë arrin një sipërfaqe totale mbi tokë 2,731.8 m^2 dhe në fazën e dytë me një sipërfaqe totale mbi tokë prej 1,989 m^2. Këto sipërfaqe në total mbi tokë, tejkalojnë kushtin e sipërfaqes totale mbi tokë të përcaktuar në lejen e zhvillimit nr. 57, datë 9.11.2008 (4,680 m^2). Shkak për këtë gjë përbën leja e ndërtimit nr. 61 datë 26.06.2019 për fazën e parë, pasi në këtë leje sipërfaqja totale mbi tokë është miratuar për 2,731.8 m^2 *(875 m^2 kati për dhe, 928,4 m^2 kati i parë, 928,4 m^2 kati i dytë)*, kurse në planvendosjen përkatëse, ishte miratuar për 2,690 m^2. Kjo ka bërë të mundur ndryshimin e Intensitetit të Ndërtimit, por gjithsesi qëndron brenda intensitetit 2 të përcaktuar në Rregulloren e PPV.
Intensiteti sipas lejes zhvillimore nr. 57, datë 09/11/2018 dhe Intensitetit sipas lejeve të ndërtimit
$I_{leje\ zhvillimore}$= *4,680* m^2/3,150 m^2 = 1,485
$I_{leje\ ndërtimi\ faza\ I+II}$ = *4,720.8* m^2/3,150 m^2= 1,498
Si konkluzion dhënia e lejes së ndërtimit të fazës I, është bërë në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.
Për sa i përket aspektit të lartësisë në metër, leja e zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018 është dhënë në kundërshtim me Rregulloren e PPV të Bashkisë Prrenjas, pasi në njësinë strukturore 1/100, në të cilën është zhvilluar ndërtimi, kjo njësi sipas rregullores, **lartësinë maksimale në kate e ka 3 kate dhe në metra e ka 9 m**. Në lejen e zhvillimit lartësia maksimale është përcaktuar 13,4 m (4,9 m lartësi kati përdhe, nga 4,25 m lartësi kati parë dhe kati i dytë) duke dalë kështu jashtë Rregullores së PPV.

Miratimi i lejes së zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018 është bërë në kundërshtim me Rregulloren e PPV, neni 39 pika 2.
Distancat nga kufijtë e pronës, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit si dhe të referuara në lejen e zhvillimit nr. 57, datë 09/11/2018, janë në shkelje të nenit 35 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit". Sipas këtij neni distanca ndërmjet vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.
Në rastin tonë, distanca minimale referuar VKM-së duhet të jetë; **d= 3+1= 4 m**. Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin jugor (0,7 m), në kufirin perëndimor (0,2 m).
Distanca nga strukturat e tjera, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit si dhe të referuara në lejet e ndërtimit Faza I me nr.61 datë 26.06.2019, Faza II me nr.56 datë 13.07.2021, janë në kundërshtim me nenin 34, pika 2 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", pasi distanca e strukturës nga objekti 5 kate në veri të saj, sipas VKM-së duhet të ishte; **d= 3+5+2= 10 m.**
Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin verior (9,2 m) të saj.
Nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është proceduar për pajisjen e subjektit "E." shpk me ***Vërtetim Risku***, në kundërshtim me ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile", si dhe VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me Vërtetim Risku të subjekteve, të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi".
Nga ana e Bashkisë Prrenjas është dhënë leja e ndërtimit në mungesë të ***Certifikatës së performancës së energjisë***" nga një auditues i licencuar i energjisë, në kundërshtim me ligji 116/2016 datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave" neni 10 si dhe në kundërshtim me VKM-së nr. 537 datë 08.07.2020 "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementëve të ndërtesave" pika 4 e tij.

Nga auditimi i procedurës për dhënien e lejes zhvillimore nr.46, datë 17.07.2020 dhe leja e ndërtimit nr. 58 datë 13.07.2021 me objekt "Objekt shërbimesh dhe banimi 5 kat me 1 kat nëntokë", rezulton se:
Distancat nga kufijtë e pronës, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit, janë në shkelje të nenit 35 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", ku përcaktohen distancat minimale. Sipas këtij neni distanca ndërmjet vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.
Në rastin tonë, distanca minimale referuar VKM-së duhet të jetë; **d= 5+1= 6 m**. Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin jugor (4 m), në kufirin verior (2,5 m).
Distanca nga strukturat e tjera, të përcaktuara në planvendosjen e ndërtimit, janë në kundërshtim me nenin 34, pika 2 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", pasi distanca e strukturës nga objekti 1 kate në veri të saj, sipas VKM-së duhet të ishte; **d= 5+1+2= 8 m.**
Ndërkohë kjo distancë minimale nuk respektohet në kufirin lindor (7,5 m) të saj.
Nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është proceduar për pajisjen e zhvilluesit S.B. shpk me ***Vërtetim Risku***, kjo në kundërshtim me ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile" si dhe VKM-në nr.1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe

afateve për pajisjen me Vërtetim Risku të subjekteve, të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raport Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të vitit 2021, rezulton se *taksa mbi pasurinë (ndërtesat)* është realizuar në masën 79%, ose nga vlera 6,300 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 4,961 mijë lekë. Ndikim në mosrealizimin e kësaj takse vjen nga abonentët familjarë.

Dokumentacioni në dosje është i paplotë. Megjithëse nga Drejtoria e të Ardhurave është vijuar me grup pune për evidentimin në terren të sipërfaqeve të banimit për efekt taks pasurie (ndërtese), ky dokumentacion është i paplotë, pasi nuk evidentohet gentplan për sipërfaqen e matur dhe ne grupin e punës nuk ka asnjë specialist me profil inxhinier për kryerjen e matjeve faktike, ku te evidentohet sipërfaqja gjithsej, numri i kateve, lloj i aktivitet ose destinacioni sipas kateve, etj.

Taksa e ndërtesës për subjektet/familjarët aplikohej në mungesë të dokumentacionit ligjorë *(genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK)*, duke përdorur tarifë fikse 70 dhe 100 m^2, mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m^2 (me 2 dhe 3 kate), dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria i PZHT për lejet e ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, megjithëse gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Elbasan mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Veprime në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat vendore" i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Prrenjas dhe ASHK Dega Rajonale Elbasan, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës).

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE

TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, rezulton se gjendja e debitorëve nga taksat/ tarifat vendore më 31.12.2021 paraqitet në shumën **62,185,903 lekë**, të cilët nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.
Kjo vlerë vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 14,287,806 lekë, pasi nga vlera 47,898,097 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera 62,185,903 lekë.
Referuar të dhënave të tabelës konstatohet se niveli i borxhit është 77.5% e planit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore dhe 16.2% e shpenzimeve buxhetore, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie në menaxhimin e borxhit fiskal.
Nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas janë llogaritur kamatëvonesa në vlerën 759,914 lekë, vlerë kjo shumë herë më e vogël se vlera reale e llogaritjes së tyre, pasi sipas dispozitave ligjore (0.06%), detyrimi për kamatëvonesën duhej të ishte në vlerën **4,562,475 lekë** (24,303,147 * 0.06% x 365 – 759,914), më 31.12.2021.
Vlera totale e debisë (borxhit tatimor) prej **65,748,378 lekë** ***(62,185,903 lekë*** *detyrime të papaguara dhe* ***4,562,475 lekë*** *kamatëvonesa)*, duhet të kontabilizohet dhe t'u njoftohet subjekteve përkatëse nga ana e administratës së Bashkisë Prrenjas **dhe përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.**
Për një pjesë të subjekteve të cilat janë debitorë në vite, nuk janë zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre sipas ligjit, duke bërë që këto subjekte të kthen në debitorë pa shpresë arkëtimi, **gjithsej 55 subjekte me vlerë 10,729,869 lekë 16% e totalit të detyrimeve.**
Në lidhje me masat e marra, konstatohet se nga bashkia është zbatuar vetëm bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe bllokimi në Drejtorinë Rajonale ASHK Elbasan, duke kërkuar arkëtimin e vlerës 11,254,342 lekë, *nga e cila arkëtua vlera 3,480,2756 lekë.*
Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngese nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është zbatuar. Mungon bashkëpunimi me Policinë Bashkiake për arkëtimin e tyre. Gjithashtu dhe në rastet kur është zbatuar, evidentohet se vlera e zbatuar në krahasim me nivelin e tyre është në masën 17.7%, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të kësaj drejtorie.
Nga të dhënat evidentohet se një numër subjektesh me status pasiv/mbyllur paraqiten me situatë debitorë, gjithsej **5** me vlerë **566,397 lekë**, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Librazhd, po ashtu dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh **të paarkëtueshëm ose të keq**.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-*Mbledhja me force e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995,"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 - *Mospagimi i taksave dhe tatimeve*, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – "*Çregjistrimi i*

subjekteve tatimore", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **26,042,222 lekë**, *si më poshtë vijon*:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave <u>të bëhet *kallëzim penal*</u>.

e- Të bashkërendojë punën me QKB Dega Librazhd për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

g- Të bëhet llogaritja e saktë e kamatëvonesave për të gjithë subjektet të cilat nuk likuidojnë në afat detyrimet sipas njoftim detyrimit nga momenti i lindjes deri në datën e pagesës së detyrimit.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas të bashkëpunojë me QKB Dega Librazhd dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan për evidentimin e subjekteve me status pasiv/mbyllur nëse ushtrojnë ose jo aktivitet dhe të mos lejohen të mbyllin veprime pa bërë likujdimin e detyrimeve të prapambetura, për të shmangur fenomenin e krijimit të borxhit të keq dhe pamundësinë e gjetjes së tyre për arkëtim.

Brenda datës 31.12.2022

2. Gjetje nga auditimi: Në totalin e detyrimeve të prapambetura *(62,185,903 lekë)*, konstatohet se peshën kryesore e zëne detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 64% e totalit të detyrimit ose me vlerë **39,706,156 lekë**.

Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Prrenjas nuk kishte aktmarrëveshje me Nd/ Ujësjellës Kanalizime dhe menaxhimi bëhej nga vetë bashkia nëpërmjet postës *(shpërndarjen e njoftim detyrimit)* dhe për njësitë e largëta nga punonjësit e taksave. Një menaxhim i tillë është jo frytdhënës për bashkinë, pasi niveli i detyrimeve debitore vjen në rritje nga njëra periudhë në tjetrën, ku për vitin 2021 kemi një rritje për vlerën 22,260,537 lekë, *pasi nga vlera 17,445,619 lekë në vitin 2020 në vitin 2021 paraqitet në vlerën 39,706,156 lekë*.

Gjithashtu evidentohet fakti se nga Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas për abonentët familjare nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05. i ndryshuar kreu IX pagesa dhe rimbursimit i tatimit, Neni 74 "*Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor*", ku përcaktohet se: "1. Tatimpaguesi shlyen detyrimet tatimore brenda afateve të parashikuara

në ligjin tatimor përkatës. 2. Kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor, në përputhje me kreun VIII të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose vlerësohet të ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë. Në rastet kur një person i tatueshëm nuk e paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, ai detyrohet të paguajë kamatëvonesa 0,06% mbi shumën e detyrimit tatimor të papaguar duke filluar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme për tu paguar, deri në datën në të cilën pagesa kryhet.". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve të marri masa për lidhjen e aktmarrëveshjes si agjent tatimorë më Ndërmarrjet e Ujësjellësit Librazhd/Prrenjas, për një mirëmënaxhim më të mirë detyrimeve nga abonentët familjarë dhe jo vetëm.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **39,706,156 lekë** nga abonentët familjarë.

Brenda datës 31.12.2022

3. Gjetje nga auditimit: Nga auditim mbi menaxhimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) dhe të ndërtimeve pa leje (ALUIZNI-t), rezulton se *për vitin 2021* është realizuar në masën 134% ose nga vlera 7,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 9,367 mijë lekë.

Ky tejkalim vjen nga mungesa e bashkëpunimit midis drejtorive mbi mundësinë e lejeve të ndërtimit që Drejtoria e PZHT ka parashikuar për vitin ushtrimorë 2021.

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet pa leje *(ALUZNI-t)*), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën **1,597,190 lekë,** e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas**.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Prrenjas ti jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalimizt dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Veprime në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar,* të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Njësitë Administrative, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **1,597,190 lekë** nga abonentët familjarë.

Brenda datës 31.12.2022

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Elbasan, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së

legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrave të subjekteve fizik/juridik mbi ngarkesën fiskale të detyrimeve vjetore për taksat e tarifat vendore në vitin 2021 (sipas ligjit dhe VKB), rezulton se për një pjesë të subjekteve me aktivitet *HEC, përpunimi i peshkut/mishit, karriere guri(gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, shfrytëzim minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjor dhe industri te tjera te cilat ndikojnë ne mjedis*, nuk është bërë i munduar aplikimi dhe arkëtimi i tarifës për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit, kjo për 7 subjekte me vlerë **1,850,000 lekë**, si mungesë të ardhurash ne buxhet, në kundërshtim me kapitullin B pika 16 *Tarifa per mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit*, të Vendimit të KB nr. 97, datë 01.12.2020 "*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi:

Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e mjedisit për **7** subjektet në vlerë **1,850,000 lekë**, respektivisht:

- **vlera 350,000 lekë,** *nga shoqëria **"G.I**" shpk, me administrator SH.K.*
- **vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"F.A**" shpk, me administrator A.G.*
- **vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"A.A**" shpk, me administrator H.H.*
- **vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"D.E**" shpk, me administrator L.K.*
- **vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"J.O**" shpk, me administrator F.P.*
- **vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"E.T**"* shpk
- **vlera 250,000 lekë,** *nga shoqëria **"V.C.**" shpk, me administrator V.C.*

Brenda datës 31.12.2022

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se në këtë njësi vendore ushtrojnë aktivitet 6 subjekte me destinacion tregtim karburanti.

Në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk aplikimi i taksës nuk është i saktë, po kështu dhe mënyra e arkëtimit nuk është zbatuar sipas ligjit.

Sipas bazës ligjore të mësipërme, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e liçencës duhet të paguajnë si më sipër.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifat vendore deri në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën 2,454,032 lekë, si e ardhur e munguar në buxhet e bashkisë Prrenjas, kjo për **4 subjekte**, *respektivisht*: shoqëria "L.L" shpk në vlerën 1,000,00 lekë, subjekti "L.I" shpk ,e vlerë 900,000 lekë, subjekti "K." shpk me vlerë 232,949 lekë dhe subjekti "G.R" shpk me vlerë 321.083 lekë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve bashkia Prrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrat9ive e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **2,454,032 lekë nga 6 subjektet**, respektivisht;
- **vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti "L.LL" ShPK
- **vlera 900,000 lekë** nga subjekti "K.I" ShPK
- **vlera 232,949 lekë** nga subjekti "K." ShPK
- **vlera 321,083 lekë** nga subjekti "G.R" ShPK

Brenda datës 31.12.2022

6. Gjetje nga auditimi: Sipas evidencës së të ardhurave për vitin 2021, rezulton se të ardhurat nga qiratë janë realizuar në masën 89%, ku nga vlera e planifikuar prej 6,200,00 lekë është arkëtuar vlera 5,533,081 lekë.
Nga auditimi i dokumentacionit mbi kontratat e qirave të lidhura nga Bashkia Prrenjas, konstatohet se operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontratë qiraje me aktivitet HEC, Gurore, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, etj, duke përllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 8,792,005 lekë, nga e cila likujduar vlera 6,001,818 lekë dhe mbetur pa likujduar vlera **3,816,519 lekë** (*sipas aneksit 2.6.4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), respektivisht:
k- 8 subjekte për HEC me vlerë kontrate vjetore 5,881,823 lekë.
l- 2 subjekte shfrytëzim karrierë me vlerë kontrate 74,000 lekë.
m- 2 subjekte veprimtarie ekonomie me vlerë kontrate 41,202 lekë.
n- 4 subjekte me veprimtari telefonisë celulare me vlerë kontrate vjetore 906,510 lekë.
o- 6 subjekte për kullota me vlerë kontrate 80,300 lekë.
Për subjektet të cilat kanë lidhur kontratë dhe nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale, nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), referuar pikës 5.5 të nenit 5 të kontratës, nuk janë llogaritur penalitet në masën 0.1% jo më shumën se 10%, **duke evidentuar një kamatëvonesa në vlerën 289,239 lekë** *(sipas aneksit 2.6.5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)***, si e ardhur munguar në buxhet**.
Sipas kërkesës së bërë nga Bashkia Prrenjas në adresë të AKBN në lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore (karriera), nga kjo e fundit është konfirmuar me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 se në këtë njësi vendore ushtrojnë këtë lloje aktiviteti **19 subjekte**, ku dy prej të cilave janë me pezullim, dy kanë kontratë me bashkinë dhe **15 subjekte** ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës.
Me shkresën nr. 569, datë 18.2.2022, Bashkia Prrenjas i ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që për 4 subjekte është kërkuar heqje nga fondi pyjore i sipërfaqeve sipas lejes minerale.
Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2050/1, datë 28.2.2022 është kthyer përgjigje se mungon një pjesë e dokumentacionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës dhe nga bashkia nuk është vijuar me tej.
Detyrimi i munguar në buxhetin e bashkisë Prrenjas vetëm për një vit ushtrimorë nga mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi përllogaritet në **shumën 20,488,050 lekë, e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas aneksit 2.3.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor", me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr.

1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për:

- Subjektet të cilat nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale sipas afateve të përcaktuara në kontratë të llogaritet, kontabilizohet dhe arkëtohen **kamatëvonesat në vlerën 289,239 lek*),*** si e ardhur munguar në buxhet.
- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga **15 subjekte** që ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në vlerën **20,488,050 lekë, për periudhën e shfrytëzimit të sipërfaqeve, si një e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.
- Sipërfaqen rrugë kalimi dhe vend depozitimit që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Prrenjas.
- 15 shoqëritë që shfrytëzojnë sipërfaqet pyjore/kullosore pa kontratë me Bashkinë Prrenjas, duke vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Prrenjas, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

Brenda datës 31.12.2022

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, leja e ndërtimit nr.56 datë 13.07.2021 e miratuar elektronikisht po në këtë datë, nga Kryetari i Bashkisë N.B., bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e ndërtimore mbi tokë të fazës II arrin 1989 m^2, ndërsa nën tokë , gjelbërime dhe sistemime arrin 550 m^2.

Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit:

TNI= Çmimi shitje/m2 sipas UKM nr. 3 datë 28.12.2016 x m^2 x 6% = 1,989 x 41,780 x 6%= 4,986,025 lekë.

Sipas autorizimit për pagesë të firmosur, vlera e përllogaritur dhe e paguar nga subjekti "E." SHPK me njoftim debitimin e bankës BKT datë 29.06.2021, është **1,560,170 lekë.**

Nisur nga fakti që llogaritja e kësaj takse, i përket vetëm fazës së dytë të ndërtimit, por objekti i ndërtimit është vetëm një, pra Qendra Tregtare Multifunksionale, atëherë është kontrolluar dhe llogaritja e TNI-së sipas fazës së parë.

Faza e parë e dhënies së lejes lidhet me lejen zhvillimore nr.57, datë 09.11.2018 si dhe lejen e ndërtimit nr. 61 (nr. prot 1206) datë 26.06.2019.

Në llogaritjen e TNI-së, është përdorur metoda e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me nenin 9 pika 2 e ligjit nr.95/2018 datë 03.12.2018, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes.

Duke qenë se në paketën fiskale të vitit 2019, nuk është përcaktuar përqindja mbi objektet e shërbimit (Qendër Tregtare), si llogaritje po marrim si referencë normën minimale të përcaktuar në ligj, pra 4 %. Nga rillogaritja e TNI-së, ka rezultuar si më poshtë;
TNI= Çmimi shitje/m2 sipas UKM nr. 3 date 28.12.2016 x m² x 6% = 3,606 m² x 41,780 x 4%= 6,026,347 lekë.
Nga subjekti "E." SHPK me njoftim debitimin e bankës BKT datë 21.06.2019, është **2,336,846 lekë,** me një diferencë prej **3,689,501 lekë** e papaguar nga subjekti zhvillues "E." SHPK, për shkak të keqllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
Pra në total diferenca e papaguar për dy fazat është 7,115,356 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
7.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të bëhet rillogaritje e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi të jetë rishikuar paketa fiskale, seksioni Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, ku mbi këtë të fundit të jenë bërë përditësimet me legjislacionin e taksave vendore në fuqi.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejes së ndërtimit nr.58 datë 13.07.2021 e miratuar elektronikisht po në këtë datë, nga Kryetari i Bashkisë N.B., bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e ndërtimore mbi tokë arrin 2060 m²,, ndërsa sipërfaqja nën tokë (1 kat) arrin 412 m²,, pra në total 2,472 m².
Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit:
TNI= Çmimi shitje/m² sipas UKM nr.3 date 28.12.2016 x m² x 4% = 2,472 x 41,780 x 4% = 4,131,206 lekë.
Sipas autorizimit për pagesë të firmosur, vlera e përllogaritur dhe e paguar nga subjekti S.B. me njoftim debitimin e bankës OTP datë 01.07.2021, është **1,384,549 lekë.**
Në llogaritjen e TNI-së, është përdorur metoda e llogaritjes mbi bazë preventivi, në kundërshtim me nenin 9 pika 2 e ligjit nr.95/2018 datë 03.12.2018, pasi llogaritja bëhet mbi bazën e çmimit të shitjes.
Duke qenë se në paketën fiskale të vitit 2019, nuk është përcaktuar përqindja mbi objektet e shërbimit (Qendër Tregtare), si llogaritje po marrim si referencë normën minimale të përcaktuar në ligj, pra 4 %.
Pra konstatohet një diferencë e dukshme prej 2,746,657 lekë, e papaguar nga subjekti zhvillues **S.B.**, për shkak të keqllogaritjes nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 36-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
8.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të bëhet rillogaritje e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi të jetë rishikuar paketa fiskale, seksioni Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, ku mbi këtë të fundit të jenë bërë përditësimet me legjislacionin e taksave vendore në fuqi.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C/1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germat (b, c, ç) e nenit 58-"*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e

vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Prrenjas** që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga "**Vërejtje**" deri në "**Largim nga shërbimi civil**", për **3 (tre)** punonjës, si më poshtë:

1- S.K. *me detyrë e Drejtore Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimi Social*.
2. A.B. *me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhet/Financës*.
<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>
- Në lidhje me vlerësimin e raporti financiarë të vitit 2021, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre" (me ndryshime) me Vendimin e KM nr. 25, datë 20.01.2001; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"; Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
- Mos planifikimi i plotë e vlerës së faturave të palikujduara me miratimin e buxhetit si dhe mos zbatimi i radhës së pagesës, janë veprime në kundërshtim me nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" me ndryshime; ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 40, 48, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar. pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" pikat 82-91,
- Nga zbatimi i buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Prrenjas, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore për vlerën **16,271,913 lekë**, *nga e cila vlera përmbarimore 1,422,359 lekë dhe vlera e detyrimit prej 14,829,554 lekë (aneksi bashkëlidhur aktit),* si dhe pagesën për të njëjtën vend pune të dy punonjësve, duke mos respektuar radhën e likujdimet të tyre, sipas parimit "hyrje e parë-dalje e parë", pavarësisht faktit se bashkia në fund të vitit 2021 ka patur disponibilitete në thesar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3. M.P., *me detyrë Specialiste në Sektorin e Planifikim Zhvillim Territorit.*
<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>
Miratimin e lejes së ndërtimit nr. 58 datë 13.07.2021në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas, *në kundërshtim me nenin 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 70-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

C/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.
Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, shkronja "e" dhe "ç" të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Prrenjas,** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga "**Vërejtje**" deri në "**Zgjidhjen e kontratës së punës**" për **9 (nëntë)** punonjës, si më poshtë:

1. **J.B.,** *me detyrë Drejtoresh e të Ardhurave Vendore***.**
2. **A.A.,** *me detyrë Përgjegjës i Drejtorisë të Ardhurave Vendore***.**
3. **L.K.,** *me detyrë Inspektor NJA Qukës***.**
4. **E.D.,** *me detyrë Inspektor NJA Rrjacë***.**

Për shkeljet e mëposhtme:
- Planifikimi i të ardhurave jo i argumentuar, veprime të cilat çojnë në planifikimin e shpenzimeve të pambuluar me fonde nga mos realizmi i tyre dhe rritjen e vlerës së faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.
- Mos zbatimin e procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara dhe mos llogaritje kamatëvonesave në masën 0.06%, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhet për vlerën **65,748,378 lekë** ***(62,185,903 lekë*** *detyrime të papaguara dhe* ***4,562,475 lekë*** *kamatëvonesa)*, në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 **"**Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë**"**, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995,"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 - *Mospagimi i taksave dhe tatimeve*, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – "*Çregjistrimi i subjekteve tatimore*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", me ndryshime.
- Nga auditimi i regjistrave të subjekteve fizik/juridik mbi ngarkesën fiskale të detyrimeve vjetore për taksat e tarifat vendore në vitin 2021 (sipas ligjit dhe VKB), rezulton se për një pjesë të subjekteve me aktivitet *HEC, përpunimi i peshkut/mishit, karriere guri(gurore) Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, shfrytëzim minierash, hekur nikeli, shfrytëzim pyjor dhe industri te tjera te cilat ndikojnë ne mjedis*, nuk është bërë i munduar aplikimi dhe arkëtimi i tarifës për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit, kjo për 7 subjekte me vlerë **1,850,000 lekë**, si mungesë të ardhurash ne buxhet, në kundërshtim me kapitullin B pika 16 *Tarifa per mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit*, të Vendimit të KB nr. 97, datë 01.12.2020 "*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*"
- Mos bashkëpunimi midis sektorëve të brendshëm të Bashkisë Prrenjas dhe jo vetëm, veprime të cilat kanë çuar në mos taksimin e saktë të subjekteve fizikë/juridikë dhe abonentëve familjarë.
- Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore në raport me tokën e ndarë dhe taksimi sipas boniteteve.
- Bashkia Prrenjas nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real

dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Prrenjas nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Prrenjas, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5. L.L., *me detyrë Drejtor Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.*

<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>

Nga auditimi i dokumentacionit mbi kontratat e qirave të lidhura nga Bashkia Prrenjas, konstatohet se operojnë gjithsej 22 subjekte të cilat kanë lidhur kontratë qiraje me aktivitet HEC, Gurore, objekte, veprimtari ekonomike, telefoni, etj, duke përllogaritur një detyrim vjetor në vlerën 8,792,005 lekë, nga e cila likujduar vlera 6,001,818 lekë dhe mbetur pa likujduar vlera **3,816,519 lekë** (*sipas aneksit 2.6.4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*), respektivisht:

p- 8 subjekte për HEC me vlerë kontrate vjetore 5,881,823 lekë.
q- 2 subjekte shfrytëzim karrierë me vlerë kontrate 74,000 lekë.
r- 2 subjekte veprimtarie ekonomie me vlerë kontrate 41,202 lekë.
s- 4 subjekte me veprimtari telefonisë celulare me vlerë kontrate vjetore 906,510 lekë.
t- 6 subjekte për kullota me vlerë kontrate 80,300 lekë.

Për subjektet të cilat kanë lidhur kontratë dhe nuk kanë likujduar detyrimet kontraktuale, nga Bashkia Prrenjas (personat përgjegjës), referuar pikës 5.5 të nenit 5 të kontratës, nuk janë llogaritur penalitet në masën 0.1% jo më shumën se 10%, **duke evidentuar një kamatëvonesë në vlerën 289,239 lekë** *(sipas aneksit 2.6.5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)***, si e ardhur munguar në buxhet**.

Sipas kërkesës së bere nga Bashkia Prrenjas në adresë të AKBN në lidhje me subjektet që operojnë në shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore (karriera), nga kjo e fundit është konfirmuar me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 se në këtë njësi vendore ushtrojnë këtë lloje aktiviteti **19 subjekte**, ku dy prej të cilave janë me pezullim, dy kanë kontratë me bashkinë dhe **15 subjekte** ushtrojnë aktivitet duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kullosore <u>pa lidhur kontratë qiraje me bashkinë ose ministrinë e linjës</u>.

Me shkresën nr. 569, datë 18.2.2022, Bashkia Prrenjas i ka kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që për 4 subjekte është kërkuar heqje nga fondi pyjore i sipërfaqeve sipas lejes minerale.

Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2050/1, datë 28.2.2022 është kthyer përgjigje se mungon një pjesë e dokumentacionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës dhe nga bashkia nuk është vijuar me tej.

Detyrimi i munguar në buxhetin e bashkisë Prrenjas vetëm për një vit ushtrimorë nga mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi përllogaritet në **shumën 20,488,050 lekë, e ardhur e munguar në buxhet,** *sipas Aneks 2.3.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor", me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor",

ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6. N.D. *me pozicion Drejtor i DPZHT*
7. H.K., *me detyrë punonjës në Drejtorinë e PZHT*
Për shkeljet e mëposhtme:
- Miratimin e lejes së ndërtimit Faza II me nr.56 datë 13.07.2021 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas.
- Miratimin e lejes së ndërtimit nr. 58 datë 13.07.2021në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas, në kundërshtim me nenin 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8. G.R., *me detyrë Specialist në Drejtorinë e PZHT*
***9.* A.A.**, *me detyrë Inspektor në IMT Bashkia Prrenjas*
Për shkeljet e mëposhtme:
Miratimin e lejes së ndërtimit Faza I me nr.61 datë 26.06.2019 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, për vlerësimin tekniko-ligjor pozitiv të praktikës me pasojë vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas, në kundërshtim me nenin 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 52-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

C/3. Për të gjithë punonjësit tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masë disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit (*6,431 mijë lekë*), duke e lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas dhe Komisionit Disiplinor, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", VKM nr. 115, datë 05.3.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil" dhe shkronja "e" dhe "ç" të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

VI. ANEKSE

Anekset e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të caktuara.

Aneksi nr. 1

Materialiteti dhe faktorët e riskut për subjektin Bashkia Prrenjas
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër transfertave).
Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht ne pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogaritë u vlerësua nga 0.7 deri 2; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Bashkia Prrenjas Viti 2021 NE 000/LEKE			
Emërtimi i Shpenzimeve	**Vlera**	**Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)**	**Çështje për tu shqyrtuar**
Paga (600)	167,363	*0.70*	*18*
Sigurime Shoqërore (601)	27,916	*0.70*	*3*
Mallra e Shërbime (602)	74,799	*0.70*	*8*
Subvencione (603)		*0.60*	*0*
Princila + Interesa		*0.60*	*0*

Investime të brend. (230-231)	120,255	*2.00*	*37*
Te tjera transfer. korren (604)	6,629	*0.70*	*1*
Total	**396,962**		
Materialiteti në %	*2%*		
Materialiteti në vlerë	**7,939**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**7,939**		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	*794*		
Nëntotali	**7,145**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	*90%*		
Vlera e precizionit	**6,431**		
Bashkia Prrenjas Viti 2021 NE 000/LEKE			
Emërtimi i të ardhurave	**Vlera**	**Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)**	**Çështje për tu shqyrtuar**
Të ardhurat nga buxheti	296,450	*0.70*	*29*
Të ardhura te tresheguara	62,264	*0.70*	*6*
Të ardhurat e veta	80,496	*0.70*	*8*
Total	**439,210**		
Materialiteti në %	*2%*		
Materialiteti	**8,784**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**8,784**		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	*878*		
Nëntotali	**7,906**		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	*90%*		
Vlera e precizionit	**7,115**		

Shenim: Te dhenat janë marra nga pasqyrat e subjektit sipas faktit dhe rakorduara me Degën e Thesarit

Aneksi nr. 2:

MBI VLERËSIMIN E RISKUT BASHKIA PRRENJAS.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza)*, me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve.
- U krye planifikimi dhe identifikimi i riskut të auditimit. Njohja me subjektin që auditohet për të kuptuar të gjithë elementët e mjedisit të kontrollit. U identifikuan dhe vlerësuan zonat kryesore të llogarisë dhe shënimeve shpjeguese për të përcaktuar pohimet kryesore të auditimit në bazë të materialitetit të përcaktuar.
-U përcaktua strategjia dhe vlerësimi i riskut duke identifikuar klasat e transaksioneve dhe kontrolleve kyçe. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara. U përcaktuan kontrollet kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar i riskut (*i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese*). U përcaktuan testet e kontrolleve dhe testet thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.

- U ekzekutuan procedurat e testimit si testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

ANEKSE

Aneksi 2.1

Nr	Objekti i kontratës	Fond Planifikimi	Kontrata me subjektin (nr./dt)	Afati	Vlera me TVSH	Paguar gjate periudhave			Mbetet pa likujduar
						Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	
I.Me fonde nga Ministritë e Linjës dhe donacione									
1	Rikonstruksion Rrjeti Shpërndarës I Ujësjellësit Prrenjas	218,380	1075/14.02.2020	18 muaj	213,999	95,548	70,000		48,451
2	"Supervizim (Mbikqyrje) punimesh për objektin "Rrjeti shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas"	3,303	1110/ 27.03.2020	18muaj	2,925	500	1,000		1,425
3	"Rehabilitim Skemës Ujitëse Radigoz- Stranik-Berzeshte", Bashkia Prrenjas	73,565	3623/03.11.2020	8 muaj	71,121	18,000	31,003		22,118
4	"Permiresim I Banesave Ekzistues Per Komunitete Te Varfera Dhe Te Pafavorizuar"	32,780	2829/21.10.2021	12muaj	20,323	0	10,765		9,558
I	**Me fonde nga Ministritë e Linjës dhe donacione**	**328,028**	**0**	**0**	**308,368**	**114,048**	**112,768**	**0**	**81,552**
II.Me fonde nga të ardhurat e veta									
1	Plan Mbarështimi I Pyjeve Me Lote: Loti 1-Hartimi I Planit Te Mbarështimit Per Ekonomin Pyjore "Turje" Bashkia Prrenjas	1,938	154/14.01.2020	12muaj	1,932		1,932		0
2	Plan Mbarështimi I Pyjeve (Stravaj) Bashkia Prrenjas	3,060	3411/19.10.2020	12muaj	2,976		1786		
3	Rikon. Dhe Riveshje Me Asfaltim I Pjeseve Te Demtuara Te Rruges Lapidari Qukes Shkumbin, Mulliri I Belbes, Asfaltim I Rruges Ne Lagjen E Kryeziut,Asfaltim Rruges Ne Lagjen E Shytit Dhe Rikonceptimi I Qendres Se Fshatit Qukes Nj. Adm. Qukes,B. Prrenjas	97,792	3954 dt 24.11.2020	4 muaj	95,540	53,000	20,540		
4	Rikonstruksion I Rrugeve Rurale , Bashkia Prrenjas	10,000	Nr ,4085 dat 07.12.2020	45 dite	7007	-	5917		1,090
5	Rikonstruksion I Rruges Lagja E Alles - Sutaj (Segmenti Ii)	0	Nr 4278 dt 21.12.2020	75 dite	2,631	-	2,631		0
6	Blerje Karburanti Loti 1	5,704	Nr 243 dt.26.01.2021	12 muaj	5,704		5651	53	0
7	Me Lote Loti 2. Blerje Benzin, Loti 3 Blerje Gaz	296	Nr 419 dt 19.02.2021	12 muaj	296		219	-	77
8	Blerje Ushqime Per Kopshtin Dhe Cerdhen Per Vitin 2021 Me Lote Loti 2. Blerje Mish Dhe Produkte Bulmeti Loti 3 Fruta Perime	3,998	Nr 268 dt 28.01.2021	10muaj	3,688		2,517	992	179
9	Ndertim Rrjeti Te Kanalizimeve Te Ujerave Te Zeza Lagja E Ish Zyrat E Ndermarrjes Se Kromit, Qyteti Prrenjas, Bashia Prrenjas	21,452	457 dt 24.02.2021	75 dite	18,188		0	18,184	4
10	"Rikonstruksion I Kanaleve Ujitëse, Bashkia Prrenjas"	5,644	470/25.02.2021	2 muaj	5,381		3,248	2,133	0
11	"Sistemim I Qendres , Fshati Prrenjas, Bashkia Prrenjas"	1,999	500/01.03.2021	15 dite	1,964		1,964		0
12	"Rikonstruksion Shkolle Katjel", Bashkia Prrenjas	13,742	679/26.03.2021	4 muaj	11,480		11,480		0
13	Blerje Materiale, Për Mirëmbajtjen E Trotuareve, Lulishteve Etj Me Lote":Loti 1 "Blerje Materialesh Per Mirembajtjen E Trotuareve , Lulishteve, Riparime Dyer Dritare Brava),Etj"	5,449	1011/10.05.2021	7 muaj	4,123		4,123		0
14	Loti 2"Blerje materiale, për mirëmbajtjen e trotuareve, lulishteve etj me lote":Loti 2 Shpenzime për sektorin e gjelbërimit,	0	1012/10.05.2021	7 muaj	778		778		0
15	"Blerje Materiale Hidraulike Per Mirembajtjen E Ujesjellesave Dhe Blerje Klor Per Ujljellsat , Me Lote":Loti 1 Blerje Materiale Hidraulike"	3,000	1027/11.05.2021 "	20 dite	2,226		2,226		0
16	Loti 2"Blerje materiale hidraulike per mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe blerje klor per	0	1028/11.05.2021	20dite	467		467		0

Nr	Objekti i kontratës	Fond	Kontrata me	Afati	Vlera me	Paguar gjate periudhave			Mbetet pa
	ujljellsat , me lote":Loti 2 Blerje Klori per ujësjellësit"								
17	Ndertim Kendi I Ri Lojërash Qyteti Prrenjas, Bashkia Prrenjas"	1,500	1971/17.06.2021	25 dite	1,345		0		1,345
18	Blerje Detergjente"	1,760	1997/22.06.2021	15 dite	1,164		1,164		0
19	"Blerje Materiale Per Lyerje Meremetime, Dezinfektim Ambientesh Vartese, Bashkia Prrenjas"	3,000	2231/28.07.2021	15 dite	1,980		1,980		0
20	"Mirembajtje Dhe Pjese Këmbimi Per Mjetet E Bashkise ,Goma, Vaj,Filtra,Antifrize,Uje Alkool Frenash,Graso,Bateri,Gjenerator",Bashkia Prrenjas	2,300	2281/09.08.2021	15 dite	2,069		2.069		0
21	Blerje Kancelari Dhe Shtypshkrime Per Aparatin Dhe Mzsh	1,423	2453/ 09.09.2021	7 dite	1,240		1,240		0
22	"Blerje Mjeti Per Administraten , Bashkia Prrenjas"	2,900	2452/ 09.09.2021	14 dite	2,800		2,800		0
23	"Hartim Projekti" Me Lote, Loti 1 - Hartim Projekti, Për Objektin: "Ndërtimin E Ujësjellësit Në Fshatrat Urakë - Kotodesh-Katjel, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas"	5,523	2786/19.10.2021	60 dite	4,419		3,600	819	0
24	"Hartim Projekti" Me Lote, Loti 2 - Hartim Projekti, Për Objektin: "Ndërtim I Rrjetit Të Kanalizimeve Të Ujerave Të Zeza Te Qytetit Prrenjas, Bashkia Prrenjas"	5,353	2787/19.10.2021	60 dite	5,158		3,500	1,658	0
25	"Rikonstruksion I Rrugeve Te Brendshme Ne Bashkine Prrenjas : Rruga 1 Qershori/ Rruga 5 Maj "	12,664	3093/15.11.2021	30 dite	9,609		4,038	0	5,571
26	"Rikonstruksion I Rruges Qukes Skenderbe,Bashkia Prrenjas	82,785	3274/07.12.2021	4 muaj	43,200		24,764	8,941	9,495
27	"Ndërtimi I Një Këndi Lojërash Për Fëmijë Dhe Vendosje Dere E Brendshme Shkolla Katjel Nj Adm Rrajcë Bashkia Prrenjas ,Vendosje Ulluqe ,Veshje Shkallësh Me Mermer ,Hidroizolim Tarrace,Ndertimur Betoni Dhe Rrethim Me Rrjete Teli Shkolla Mesme Karkavec Njësia Adm Qukës Bashkia Prrenjas"	3,297	3337/14.12.2021	45 dite	2,521		2,053	0	468
II	**II.Me fonde nga të ardhurat e veta**	**296,579**	**0**	**0**	**239,886**	**53,000**	**110,620**	**32,780**	**19,419**
TOTALI I + II		**624,607**	**0**	**0**	**548,254**	**167,048**	**223,388**	**32,780**	**100,971**

Aneksi 2.2

Likujdimet e vendimeve Gjyqesore

NR.VENDIME GJYQESORE	Shuma e detyrimit sipas V. Gjyqësor Lekë.	Shërbim përmbarimor leke	Totali detyrimit sipas V. Gjyqësor Lekë.	Likujduar deri ne vitin 2018	Likujduar deri ne vitin 2019	Likujduar ne vitin 2020	Likujduar ne vitin 2021
Nr.(82-2016-1726)1099 date15.12.2016	690,560.00	82,867.00	773,427.00	773,427.00			
Nr682 DATE 11.7.2017	353,500.00	15,600.00	369,100.00	369,100.00			
Nr.(82-2017-242)173 DATE28.02.2017	542,380.00	65,086.00	607,466.00	607,466.00			
Nr. 4280 DATE 17.10.2017	355,345.00	36,000.00	391,345.00	391,345.00			
Nr.(82-2016-932)611 DATE28.06.2016	374,000.00	36,000.00	410,000.00	410,000.00			
Nr (1692 date 4.12.2014 urdhër sekuestro nr. 33-17 dt 10.05.2017	802,636.00	52,284.00	854,920.00	854,920.00			
Nr.254 DATE 30.01.2018	453,658.00	36,000.00	489,658.00	489,658.00			
VENDIM GJYQI NR.3203 (86-2018-3571)date 20.09.2018 TE GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT	573,768.00	73,216.00	646,984.00		646,984.00		
VENDIM GJYQI NR.16283/10732/6175 DATE.18.09.2017 TE	480,000.00	0.00	480,000.00		480,000.00		

NR.VENDIME GJYQESORE	Shuma e detyrimit sipas V. Gjyqësor Lekë.	Shërbim përmbarimor leke	Totali detyrimit sipas V. Gjyqësor Lekë.	Likujduar deri ne vitin 2018	Likujduar deri ne vitin 2019	Likujduar ne vitin 2020	Likujduar ne vitin 2021
GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT TIRANE							
VENDIM GJYQI NR.475 (13-2019-2111) GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR ELBASAN	608,000.00	76,656.00	684,656.00		684,656.00		
VENDIM GJYQI NR.1156 (31107-03709-86-2017)date18.04.2019 TE GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT DURRES	628,840.00	-	628,840.00		628,840.00		
VENDIM GJYQI NR.10-2019-755/273 date23.04.2019 TE GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT DURRES	498,675.00	66,424.00	565,099.00		565,099.00		
VENDIM GJYQI NR.1212 (86-2019-1374)date19.04.2019 TE GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT TIRANE	264,000.00	-	264,000.00		264,000.00		
VENDIM GJYQI NR.1788 date 11.07.2019 TE GJYKATES ADMINISTRATIVE TE APELIT TIRANE	360,000.00	41,000.00	401,000.00		401,000.00		
VENDIM GJYQI NR.770(82-2016-1209) DATE 15.09.2016 TE GJYKATES ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE DURRES	323,620.00	45,600.00	369,220.00		369,220.00		
VENDIMI NR. 10-2019-2238/753 DATE 18.12.2019 TE GJYKATES SE APELIT DURRES	411,200.00	39,000.00	450,200.00			450,200.00	
Nr.1430(13 -2017-6224 Gjykata Elbasan me Vendimin nr. 10-2020-136(45) dt 28.01.2020	629,700.00	75,564.00	705,264.00			705,264.00	
Nr.10-2020-751(226) dt 17.06.2020	702,116.00	87,254.00	789,370.00			789,370.00	
Nr.10-2020-753(224) dt 17.06.2020	437,300.00	39,000.00	476,300.00			476,300.00	
Nr.10-2020-1106(303) dt 28.09.2020 totali 390.000 leke	156,000.00	-	156,000.00			156,000.00	
	234,000.00	-	234,000.00				234,000.00
Nr. 1023(4356) -10-2020-752(225) dt 17.06.2020	530,000.00	63,240.00	593,240.00				593,240.00
Nr.10-2020(280) dt 14.09.2020	527,200.00	63,264.00	590,464.00				590,464.00
Nr.297 dt 23.09.2020	1,228,986.00	218,334.00	1,447,320.00				1,447,320.00
Nr.10-2021-189(57) dt 09.02.2021	499,500.00	58,500.00	558,000.00				558,000.00
Nr. 10-2021-579(201) dt 30.03.2021	419,870.00	39,000.00	458,870.00				458,870.00
Nr. 10-2021-1606(466) dt 21.09.2021, Nr.10-2020-1846(399) dt 21.10.2021	500,000.00	-	500,000.00				500,000.00
Nr.10-2021-1032(377)dt 09.06.2021	657,200.00	68,720.00	725,920.00				725,920.00
Nr.373 dt 24.06.2021	587,500.00	63,750.00	651,250.00				651,250.00
Totali	**14,829,554.00**	**1,442,359.00**	**16,271,913.00**	**3,895,916.00**	**4,039,799.00**	**2,577,134.00**	**5,759,064.00**

ANEKSI 2.6.1

ANEKSI TE ARDHURA

Regjistri I realizimit të të ardhurave viti 2020 dhe 2021

Lloji I taksës, tarifës	Plani Janar- Dhjetor 2020	Fakti Janar-Dhjetor 2020	%	Plani Janar-Dhjetor 2021	Fakti Janar-Dhjetor 2021	Diferencave vitit 2020 me vitin 2021	Realizimi ne % viti 2021
Tatim I thjesht. Mbi biz e vogël + t.Biznesi I vogël	500,000	280,556	56	0	414,564	134,008	0%
Taksa e regj.pervitsh automj.	6,000,000	6,792,064	113	6,500,000	8,345,096	1,553,032	128%
Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale(2%)	120,000	1,659,588	1,383	120,000	6,573,714	4,914,126	5478%
Taksa mbi ndertesat	6,150,000	4,917,863	80	6,300,000	4,961,781	43,918	79%
Taksa e ndikimit ne infrastrukt.	7,000,000	6,782,711	97	7,000,000	9,367,714	2,585,003	134%
Takse tregu + Ambulante	2,000,000	1,230,040	62	1,500,000	1,345,050	115,010	90%
Taksa e kalim te drejt.prones.	200,000	489,916	245	100,000	467,446	-22,470	467%
Takse toke bujq.	4,000,000	2,801,025	70	4,000,000	2,939,484	138,459	73%
Takse tabele /reklame / banderole	1,000,000	1,335,163	134	1,000,000	1,476,065	140,902	148%
Takse mbi truallin shesh funksional	1,500,000	1,020,923	68	1,600,000	1,116,012	95,089	70%
Takse e perkohsme arsim	0	378,944	0	0	0	-378,944	0%
Takse Hoteli	-	0	0	20,000	3,255	3,255	16%
Totali taksave vendore	**28,470,000**	**27,688,793**	97	**28,140,000**	**37,010,181**	**9,321,388**	**132%**
Te ardhura jo tatimore			0				
Te ardhura nga Tarife Uji Pijshem	6,000,000	9,834,550	164	20,000,000	14,343,956	4,509,406	**72%**
Tarife pastrimi	8,000,000	6,290,405	79	9,000,000	6,546,179	255,774	**73%**
Tarifa te tjera nga Urbanistika	500,000	367,085	73	400,000	407,500	40,415	**102%**
Leje transporti+ tarif parikim	450,000	316,900	70	450,000	245,600	-71,300	**55%**
Tarife vaditje	-	467770	0	500,000	487,620	19,850	**98%**
Tarife per leje zhvillimi + sistemeve jashtme			0	0	141550	141,550	**0%**
Tarife ndricimi	2,600,000	1,806,272	69	2,600,000	2,461,459	655,187	**95%**
Tarife Kabellori		15000	0	0	0	-15,000	**0%**
Tarife Gjelberimi	1,000,000	797,736	80	1,000,000	885,586	87,850	**89%**
Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave	2,000,000	1,007,100	50	3,500,000	1,652,435	645,335	47%
Totali tarifave vendore	**20,550,000**	**20,902,818**	102	**37,450,000**	**27,171,885**	**6,269,067**	**73%**

Lloji I taksës, tarifës	Plani Janar- Dhjetor 2020	Fakti Janar-Dhjetor 2020	%	Plani Janar-Dhjetor 2021	Fakti Janar-Dhjetor 2021	Diferencave vitit 2020 me vitin 2021	Realizimi ne % viti 2021
Tarife Vendore Konfirmime haratsh (AMPT)	0	1,500	0	0	0	-1,500	0%
Tarife Vendore Per shfrytezim Karburantesh	0	100,000	0	0	100,000	0	0%
Takse per perdorimin e hapsirave publike	0	18,400	0	0	0	-18,400	0%
Tarife sherbimi nga inst Kultures,sportit	0	20,000	0	0	0	-20,000	0%
Tarife vendor eleje drejtimi	0	6,000	0	0	108,704	102,704	0%
Certifikate Perdorimi			0	0	63,811	63,811	0%
Sponsor jo qeveritar	0	2,493,338	0	0	2,379,676	-113,662	0%
Grant nga nje nivel qeverisje	0	5,000,000	0	0	0	-5,000,000	0%
Totali te ardhura te paplanifikuara	**0**	**7,639,238**	0	**0**	**2,652,191**	**-4,987,047**	
Te ardhura te tjera			0			0	0%
Pagesa e prinderve çerdhe	600,000	598,925	100	600,000	958,843	359,918	160%
Pagesa e prinderve kopesht	1,800,000	1,460,205	81	1,300,000	2,469,137	1,008,932	190%
Totali te ardhurave te tjera	**2,400,000**	**2,059,130**	86	**1,900,000**	**3,427,980**	**1,368,850**	**180%**
QERA +Trualli	6,000,000	5,351,107	89	6,200,000	5,533,081	181,974	89%
Tarife per akte ligj. dhe adminis	800,000	667,594	83	700,000	1,145,315	477,721	164%
Te ardhura nga pullat e gjendjes civile	80,000	63,350	79	80,000	80,950	17,600	101%
Te ardhura nga gjobat	700,000	102,450	15	50,000	511,306	408,856	1023%
MZSH Zjarri		74000	0	50,000	304,000	230,000	608%
Te ardhura nga RENTA	1,000,000	3,651,544	365	1,500,000	161,554	-3,489,990	11%
Tarife e ndikimit ne mjedis	0	0	0	4,000,000	2,508,147		63%
Totali	**8,580,000**	**9,910,045**	116	**12,580,000**	**10,244,353**	**-2,173,839**	**81%**
Totali te Ardhurave 2021	**60,000,000**	**68,200,024**	**114**	**80,070,000**	**80,506,590**	**12,306,566**	**101%**

Aneksi 2.6.3

Pasqyra mbi kamatëvonesat

Nr	Detyrimi deri me 31.12.2020	Shtesa 2021	Paguar	Debitor 31.12.2021	Dite vonës 2020	Ditevones 2021	Ditevonese 2022	Gjithsej dite vonës	Kamatëvonesa
1	1,141,735	1,141,735	-	2,283,470	365	365	151	881	201,174

Nr	Detyrimi deri me	Shtesa	Paguar	Debitor	Dite	Ditevones	Ditevonese	Gjithsej	Kamatëvonesa
2	-	1,114,110	-	1,114,110		365	151	516	57,488
3	139,727	37,000	-	176,727	365	365	151	881	15,570
4	-	37,000	-	37,000		365	151	516	1,909
5	-	41,202	-	41,202		365	151	516	2,126
6	-	221,000	-	221,000		365	151	516	11,404
7	-	220,360	-	220,360		365	151	516	11,371
8	-	1,780,820	895,410	885,410		365	151	516	45,687
									289,239

Aneksi 2.6.4

Pasqyra e subjekteve me kontratë qiraje

Nr	Aktiviteti	Kontratat e lidhura (Numër/datë)	Viti 2021				Vlera vjetore	detyrimi deri me 31.12.2020	SHTESA 2021	PAGUAR	debitor 31.12.2021
			Sipërfaqia hequr (ha)	Sipërfaqja në përdorim							
				Ha	Km	Kohëzgjatja					
1	HEC	Nr88 date 06.12.2013			5.4	01.01.2013-01.03.2022	309,375	-	309,375	309,375	-
2	HEC1	Nr__ date 06.12.2013			3.288	01.01.2013-01.01.2022	764,286	-	764,286	764,286	-
3	HEC2	Nr89 date 06.12.2013			1.32	01.01.2013-01.01.2022	66,000	-	66,000	66,000	-
4	HEC.G... &G....1	Nr3493 date 08.09.2017	0.06571		6.907	17.06.2016-04.09.2023	1,141,735	1,141,735	1,141,735	-	2,283,470
5	Hec/ L.... 1&2	Nr.1414 date 14.05.2018	0.0391		5.924	14.05.2018 - 13.05.2027	858,980	858,980	858,980	1,717,960	-
6	Hec b.... 1	Nr.1765 dt.17.06.2019			4.155	17.06.2019 - 17.06.2028	517,532	-	517,532	517,532	-
7	Hec b... 2	Nr.1766 dt.17.06.2019			8.587	17.06.2019 - 17.06.2028	1,109,805	-	1,109,805	1,109,805	-
								2,000,715	**5,881,823**	**4,484,958**	**2,283,470**
1	Gurore	date 18.11.2010		1.567		18.11.2010-19.11.2030	37,000	139,727	37,000	-	176,727
2	Minier	Nr.312 date 18.04.2012		0.55		05.04.2012-05.04.2022	34,000	-	37,000	-	37,000
								139,727	**74,000**	**-**	**213,727**
1	Vep.Turistike	Nr.1118 dt.19.4.2019		0.5	0.29	19.04.2019-18.04.2029	48,650	-		48,650	(48,650)

Nr	Aktiviteti	Kontratat e lidhura (Numër/datë)	Viti 2021				Vlera vjetore	detyrimi deri me 31.12.2020	SHTESA 2021	PAGUAR	debitor 31.12.2021
2	R.Peshku	Nr 4712date 15.12.2017		0.2289		01.05.2017-01.05.2026	41,202	-	41,202	-	41,202
								-	**41,202**	**48,650**	**(7,448)**
1	Antenë	Nr.4641 date.12.12.2017		0.0276	0.41	03.10.2017-03.10.2026	235,150	-	235,150	235,150	-
2	Antenë	Nr.1253 date.09.05.2019			0.42	01.05.2019-30.04.2028	221,000	-	221,000	-	221,000
3	Antenë	Nr.2181date 23.07.2018		0.0288		23.07.2018-21.07.2027	230,000	-	230,000	230,000	-
4	Antenë	Nr.4640 date.12.12.2017		0.0273	0.056	24.12.2017-23.12.2026	220,360	-	220,360	-	220,360
								-	**906,510**	**465,150**	**441,360**
1	shfrytëzimin e lendes drusore ne këmbë	aneks-kontrat Nr.3091prot				15.11.2021-15.11.2022	1,790,820	-	1,780,820	895,410	885,410
2	Për dhënen në përdorim të kullotave dhe livadheve për kullotje,kositje bari për sezonin veror 2021	Nr.421/1 prot,datë 02.08.2021			34.6	02.08.2021-02.10.2021(sezonale)	17,600	-	17,600	17,600	-
3	Për dhënen në përdorim të kullotave dhe livadheve për kullotje, kositje bari për sezonin veror 2021	Nr.424/1 prot,datë 13.07.2021		2.1337		13.07.2021-13.10.2021(sezonal)	9,750	-	9,750	9,750	-
4	Për dhënen në përdorim të kullotave dhe livadheve për kullotje, kositje bari për sezonin veror 2021	Nr.423/1 prot,datë 28.07.2021		34.4		28.07.2021.28.10.2021 (sezonal)	43,000	-	43,000	43,000	-
5	Për dhënen në përdorim të kullotave dhe livadheve për kullotje, kositje bari për sezonin veror 2021	Nr.420/1 prot,datë 29.07.2021		19.2		29.07.2021-29.10.2021	21,800	-	21,800	21,800	-
6	Për dhënen në përdorim të kullotave dhe livadheve për kullotje, kositje bari për sezonin veror 2022	Nr.422/1prot, date 30.07.2021				Korrik - Tetor 2021 (sezonal)	15,500	-	15,500	15,500	-
7	Kontrate qiraje ambient ne pronesi te	Nr.1750 prot, date 25.05.2021									-

Nr	Aktiviteti	Kontratat e lidhura (Numër/datë)	Viti 2021				Vlera vjetore	detyrimi deri me 31.12.2020	SHTESA 2021	PAGUAR	debitor 31.12.2021
	bashkise										
								-	1,888,470	1,003,060	885,410
								2,140,442	8,792,005	6,001,818	3,816,519

Aneksi 2.6.5

Tarifat e munguara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në shfrytëzim karriere

Nr/leje	Datë	Sip/km2	Sip/ha	Tarifa	Vlera/vit
711	10.7.2003	0.015	0.15	495,000	74,250
771/1	28.6.2004	0.26	0.26	495,000	128,700
839/1	21.01.2005	0.184	1.84	495,000	910,800
950	18.7.2006	0.05	0.47	495,000	232,650
1284	18.12.2008	0.032	0.32	495,000	158,400
1335	15.4.2009	0.23	2.3	495,000	1,138,500
1395	17.8.2009	0.3	3	495,000	1,485,000
1457	24.2.2010	0.724	7.24	495,000	3,583,800
1594/1	16.7.2018	0.379	3.79	495,000	1,876,050
1605	7.01.2013	1.304	13.4	495,000	6,633,000
1711	29.5.2014	0.033	0.33	495,000	163,350
1773	3.11.2015	0.155	1.55	495,000	767,250
1830	25.01.2017	0.495	4.95	495,000	2,450,250
1861	16.7.2018	0.102	1.02	495,000	504,900
1925	13.10.2021	0.077	0.77	495,000	381,150
					20,488,050

Aneksi 2.1.2

Mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Prrenjas , rezultoi se :

- **Organizimi dhe Funksionimi :** Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB në sektorin publik" Bashkia Prrenjas ka ngritur NJAB. Për **vitin 2021** NJAB ka funksionuar me 2 specialiste , sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me Vendimin nr. 19 date 25.01.2021 mbi bazën e miratimit me VKB nr.108 datë 30.12.2021.

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të Administratës së Bashkisë Prrenjas e miratuar me nr. 38 date 04.03.2019
Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, pervoja dhe trajnimet e Audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

R	PERIUDHA 2021	FUNKSIONI	ARSIMIMI	VJETËRSI NE PUNE	VJETËRSI NË AUDITIM/ VITE	CERTIFIKIMI	TRAJNIME TE VIJUESHME
	A.B.	SPECIALISTE	EKONOMIK	**9**	**9**	**ÇERT .2013**	**PO**
	B.K.	SPECIALIST	EKONOMIK	**32**	**4**	**ÇERT. 2021**	**PO**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se këta punonjës janë të certifikuar dhe kanë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" nenet 11, "Punësimi i Auditit të Brendshëm", neni 19 "Certifikimi i Audituesve të brendshëm" dhe neni 20 "Trajnimi i vijueshëm profesional i Audituesve të brendshëm".

- **Komiteti i Auditit të Brendshëm:** Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 13 "Komitetit të Auditimit të Brendshëm" *i cili përcakton se:" Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*
a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
d) duke monitoruar zbatimin e rekoman-dimeve të dhëna;
dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik

NJAB ne mbështetje te Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik" në Bashkinë Prrenjas, e cila është miratuar nga titullari ne date 28.10.2021 me nr. prot 2902/1.

Planet Strategjike dhe Vjetore:

Ne mbështetje te Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Per vitin 2021 me shkresën nr.3227/1, datë 15.10.2020 është miratuar plani strategjik për vitet 2021 – 2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021.

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

Realizimi i Planeve Vjetore:

- **Për vitin 2021** janë parashikuar gjithsej 10 auditime në NJA, nga te cilat janë kryer 5 misione auditimi brenda planit vjetor dhe 2 misione auditimi jashtë planit vjetor me kërkesë te titullarit te bashkise e faktuar me shkresën nr. 849 prot date 19.04.2021 Ndjekje e Rekomandimeve te lëna nga KLSH dhe shkresat me nr. 335,336,337,338 prot date 04.02.2021 ndjekja e rekomandimeve te lëna nga auditimet e mëparshme .Këto auditime sipas llojit janë të përputhshmërisë dhe financiar dhe te kombinuara. Realizimi i auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditim e ta planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
4	Viti 2021	10	7	7	2	2		

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkisë Prrenjas për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.59/1, datë 11.02.2022, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Prrenjas për vitin 2021.Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit				
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre				Statusi i Angazhimit
		Gj	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:	Shërb	Angazh	

		it hs ej	A. të përputhshmërisë	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara	ime Këshillimi	ime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
1	Bordi i Ujitjes dhe Kullimit	1	**1**		**1**		**1**			**1**	
2	Detyrimet e Prapambetura	1	**1**							**1**	
3	Çerdhe	1	**1**							**1**	
4	Kopshti	1	**1**							**1**	
5	Kultura ,Turizmi dhe Arsimi	1	**1**		**1**		**1**			**1**	
6	Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga KLSh	1	**1**							**1**	
7	Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga auditimet e kryera	1	**1**							**1**	
8											

Gjetje-Rekomandimet

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2021 Nga auditimet janë evidentuar 38 gjetje, për per çdo gjetje janë dhënë rekomandimet përkatëse, nga të cilat 37 janë rekomandime të karakterit organizativ dhe 1 rekomandim shpërblim dëmi të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2021	38	10	27	1	1			1
TOTALI		**38**	**10**	**0**	**0**	**1**			**1**

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER										
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime,	Fondet e sig. Shoq, sig.shendetesore, përkujdesje shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës,	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve,	Sistemet e legalizimeve,uUrbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Bordi i Ujitjes dhe Kullimit					**8**						**2 specialist**
2	Detyrimet e Prapambetura	**6**										**“**
3	Çerdhe										**6**	**“**
4	Kopshti										**6**	**“**
5	Kultura ,Turizmi dhe Arsimi	**9**									**1**	**“**
6	Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga KLSh										**1**	**“**
7	Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga auditimet e kryera										**1**	**“**

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve per periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve te manualit te A.B. NJAB u ka dërguar shkresa njesive te audituara per informim mbi nivelin e zbatimit te tyre dhe ne auditimin e radhës është çështja e zbatimit te rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2021	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimin e sistemeve	Rekomandime të përmirësimin e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Bordi i Ujitjes dhe Kullimit	8	8	8	2	6			8		
2.	Detyrimet e Prapambetura	6	6	6	1	5			5	1	
3	Çerdhe	6	6	6	2	4			5	1	
4	Kopshti	6	6	6	2	4			5	1	
5	Kultura ,Turizmi dhe Arsimi	10	10	10	3	7			5		1
6	Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga KLSh	1	1	1		1			1		
7.	Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga auditimet e kryera	1	1	1		1			1		

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 38 masa të rekomanduara, janë pranuar 38 rekomandime, nga këto 10 rekomandime janë zbatuar, 27 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa 1 rekomandim është I pa zbatuara.

Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.
Nga auditimi i detajuar i dosjeve auditimeve të kryera në subjektet:
Për vitin 2021 dosjet:
1.Bordi i Ujitjes dhe Kullimit
2.Detyrimet e Prapambetura
3.Cerdhe
4.Kopshti
5.Kultura,Turizmi dhe Arsimi
6. Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga KLSh
7. Ndjekja e rekomandimeve te lëna nga auditimet e kryera

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:
a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;
b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit ;
c- Besueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se nuk janë respektuar me

kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 11,neni 12, shkronja "d", neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016", Kapitulli II 2.4.1 "Auditimi i përputhshmërisë" dhe 2.4.2 "Auditimi financiar"; Kapitulli III, pika 3.5;Kapitulli IV pika 4.1.1 "planifikimi i një angazhimi auditimi", pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" pika 6.1 "Niveli i dokumentimit";
Në të gjitha dosjet e auditimit mungon Memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit te auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, pratë kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit (universit) të auditimit, duke plotësuar edhe ;
- Kompleksitetin dhe riskun e sistemit/fushës që auditohet, duke plotësuar edhe Formatin e përgjithshëm të riskut;
- Plotësimi i Formatit të vlerësimit të riskut për sistemin/fushën që auditohet, përllogaritja e koeficientit të riskut për sistemin që auditohet. Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, duke plotësuar edhe Formatet 4 e 5.
- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.
- Eksperienca dhe numri i Audituesve;
- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;
- Kohëzgjatja(ose afatet kohore);
- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;
- Masat për sigurimin e cilësisë;

- Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim "vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07,2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar. Për pasojë nuk është bërë trajtimi si çështje më vehte vlerësimi dhe analizimi e komponentëve të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve te shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk ka dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kritereve për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët).Opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumin e çdo raporti angazhimi.
- Në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nuk janë reflektuar lidhjet organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime. Opinionin e përgjithshëm mbi funksionimin dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve të audituar nuk e kanë paraqitur në përmbledhjen ekzekutive.
- Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

- Në të gjitha dosjet nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).
- Në disa raste rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra "në zbatim të akteve ligjore"', duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët);
- Raportet nuk janë koncize në përmbajtjen e tyre ka rubrika dhe përshkrime jo korrekte, të panevojshme, ka përshkrime të gjata, të tepërta, të detajuara dhe të parëndësishme që nuk mbështesin dhënien e ndonjë opinioni apo vlerësim përfundimtar.
- Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi në kundërshtim me pikën 2.4.1 "Auditimi i përputhshmërisë" dhe 2.4.2 "Auditimi financiar"
- Nga shqyrtimi i përmbajtjes së Memove rezulton se janë tejet të gjata dhe nuk janë një përmbledhje e shkurtër e Raportit Përfundimtar, nuk është e qartë se kur është dërguar titullarit para apo pas plan-veprimit (pa datë) të dërguar nga Subjekti i audituar, nuk paraqet konkluzionet dhe rezultatet pas vlerësimit të sistemeve të audituar, por vetëm gjetjet dhe rekomandimet e adresuara, si dhe i mungon dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.
- Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 nuk janë realizuar auditime në sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë rrisku si: në sistemin e prokurimeve dhe në sistemin e pagesave.

Konkluzion: Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 100%. NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit te auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim "vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Në disa raste formulimi i gjetjeve ka mangësi, pasi situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, në ndonjë rast nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si apo nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra "në zbatim të akteve ligjore", duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste nuk është në

dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagesave sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj.

Aneksi 2.5

Mbi zbatimin e rekomandimeve në proces dhe të pazbatuara.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Prrenjas rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 117/17 prot, datë 17.01.2022. Ndërsa nga Bashkia Prrenjas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk ka kthyer përgjigje, **duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor**.

Është hartuar "Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Statusi: Pa zbatuar

2. *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*

Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Prrenjas, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 117/17 prot, datë 17.01.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 17.6..2022 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 "Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). **Nga Bashkia Prrenjas nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit.**

Statusi: Pa zbatuar

3. *MBI RAPORTIMIN RREGULLISHT NË KËSHILLIN BASHKIAK TË ECURISË TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH, SIÇ PËRCAKTOHET NË NENIN 50 -AUDITIMI I JASHTËM, PIKA 5, TË LIGJIT NR. 68/2017, DATË 27.04.2017 "PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE".*

Bashkia Prrenjas ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve, **por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audites të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

Statusi: Pa zbatuar

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit i cili ka krijuar detyrime të prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve, duke paraqitur risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, sepse ky buxhet do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura për investimet, mallrat e shërbimet dhe dëmshpërblimin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku gjendja progresive e detyrimeve deri në datë 31.12.2020 pasqyrohen në ***vlerë 16,204,679 lekë*** duke zvogëluar fondet në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 në investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit bashkia Prrenjas, veprime në mospërputhje me neni (50) "*Angazhimet buxhetore*", neni (52) "*Kryerja e shpenzimeve*", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni (56), ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017*"Për financat e vetëqeverisjes vendore",* pika (62) UMFE nr.2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*"; UMF nr.5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", UMFE (*plotësues*) nr.2, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat (*82-91*) "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*"; neni 70, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar. *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 9-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1-1-Rekomandimi: Titullari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Bashkia Prrenjas, për detyrimet e faturave të pa likuiduara me gjendje progresive deri në datën 30.12.2020 shuma **16,204,679 *lekë*** të analizojë situatën, të nxjerr përgjegjësitë, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe të marr masa për likuidimin e tyre, ndërsa të mos ketë angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion, për këtë qëllim kërkohet që;

-Titullari i bashkisë për daljen nga situata e vështirë financiare të përgatis një plan dhe ta dërgoj në Këshillin e Bashkisë për të shqyrtuar e miratuar brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij, njëkohësisht ky plani ti dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim që mund të japë rekomandime konkrete për rregullimin e situatës financiare, ndërsa nga njësia qeverisjes vendore të mos merret asnjë angazhim buxhetor pa pasur fonde në dispozicion.

-Titullar i bashkisë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit.

Nga verifikimi rezulton se:

Në lidhje me detyrimet e prapambetura, bashkia është në proces likujdimi. NJAB ka bere auditimin e detyrimeve te prapambetura per vitin 2021 dhe konstaton se :

a-Faturat e pa likuiduara gjendje në datën 31.12.2021 "Për vendimet gjyqesore", shuma 977,650 lekë

b-Faturat e pa likuiduara gjendje në datën 31.12.2021 "Për investimet e financuara nga FSHZH" në shumën 22,807,737 lekë.

c-Faturat e pa likuiduara gjendje në datën 31.12.2021 "Për detyrime te palikujduara sipas kontratave" në shumën 11,783 lekë

d- Faturat e pa likuiduara per detyrimet ndaj OSHEES per kontratat per periudhën viti 2007 – nëntor 2020 në shumën 11,756,834 lekë

Detyrime te prapambetura te krijuara nga fondi I pamjaftueshëm per shpërblim bonusi bebesh në shumën 3,130,000 lekë.

Statusi: Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat shkurtra. nënrubrika, llogari të arkëtueshme, gjendja e llog.(468) "*Debitorë të ndryshëm*", në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore raportuese më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 10,123,778 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerë 47,898,097 lekë me diferencë më tepër detyrime debitorë ndaj

bashkisë në shumën prej ***37,774,319 lekë*** e cila përfaqëson detyrimet shtesë të pa likuiduar nga subjektet ekonomik dhe familjare për mos pagesë të nivelit të taksave e tarifa vendore deri në datë 31.12.2020. Detyrimet debitorë ndaj Bashkisë Prrenjas janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore të pa arkëtuara deri në datë 31.12.2020. Nga analiza e kësaj
llogarie për vitin 2020, konstatohet se totali detyrimeve debitorë në shumën 47,898,097 lekë e cila përbëhet nga;

-Debitorë subjekte të biznesit është vlera 12,277,936 lekë.
-Debitorë subjekte të biznesit të vogël 5,555,356 lekë.
-Debitor subjekte familjar 30,064,805 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara debitorë shtesë për vitin 2020 nga mos pagesë e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi, si dhe subjekte familjar me vlerën prej ***37,774,319 lekë,*** si dhe mos programim, mos përllogaritje dhe mos realizim i detyrimeve të lindura nga niveli për taksën e tokës, apo debitor të tjerë ndaj njësisë publike vendore Bashkia Prrenjas.

Nga verifikimi rezulton se:

Në lidhje me rekomandimet e lëna nga KLSH për gjendjen debitore të biznesit të madh, të vogël dhe subjektet familjare per subjektet e karburantit , ujë Kopesht/ çerdhe , legalizime janë marrë këto masa :

1- Nga drejtoria e të Ardhurave është dërguar "Urdhër – Bllokim llogarie bankare me nr.3490 prot datë 28.12.2021 për B. Vogël në qytetin Prrenjas per 70 subjekte, në Njësite ADM Rrajce per 40 subjekte dhe per Njësinë Qukës 25 subjekte debitore. Per biznesin e madh janë bere Urdhër Bllokime per 15 subjekte me nr. Protokolli 61, 87, 86, 81, 82, 76, 77, 85, 83, 74, 79, 78, 80, 73, 75, datë 14.01.2022.

Nga drejtoria e të Ardhurave është dërguar "Kërkesë për Shlyerje detyrimesh "shkresa me nr.319 prot datë 03.02.2022

- *a- Për 93 subjekte B. Vogël në qytetin Prrenjas ku nga këto vlera e arkëtuar është = **668,662 lekë.***
- *b- Për 32 subjekte Biznes i vogël Njësia ADM Qukës ku vlera e arkëtuar është **= 136,005 lekë***
- *c- Për 42 subjekte B. Vogël Njësia ADM Rrajce ku vlera debitore e arkëtuar është = **238,593 lekë**.*
- *d- Detyrime biznesi i madh arkëtuar në shumën 1,923,793 lekë*

Per taksat dhe tarifat vendore nga subjektet familjare te cilët rezultojnë debitor ne 31.12.2022 janë bere këto arkëtime :

*Per familjaret qyteti Prrenjas nga shuma debitore janë arketuar 1,508,114 lekë; per familjaret Njësia Adm Rrajce nga shuma debitore janë arketuar 705.754 lekë; per familjaret Njësia Adm Stravaj nga shuma debitore janë arketuar 56.393 lekë; p**er** familjaret Njësia Adm Qukës nga shuma debitore janë arketuar 138,023 lekë; per abonentët e qyteti Prrenjas janë arketuar tarife uji 341,722 lekë; per abonentët e Njësisë Rrajce janë arketuar tarife uji 1,348,026 lekë; per abonentët e njësisë Qukës janë arketuar tarife uji 837,664 lekë dhe per abonentët e njësisë Stravaj janë arketuar tarife uji 46,054 lekë.*

Në total si rezultat i masave të marra nga vlera e detyrimeve prej 47,898,097 lekë është likujduar vlera 7,948,763 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 39,949,334 lekë.

Statusi: Në proces

3. Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata. nen rubrika, aktive afat gjata jo materiale, gjendja e llog.(**202) "*Studime dhe kërkime*",** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 6,037,127 lekë, ndërsa në

datën 31.12.2020 paraqitet e barabartë në vlerën 6,037,127 lekë. Kjo llogari përfaqëson projekte dhe studime të realizuara në periudhat paraardhëse për të cilat nuk ka evidencë dhe për këtë arsye nuk është llogaritur dhe amortizimi në masën 5% sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator në fuqi. Kjo vlerë raportohet e pa ndryshuar midis kostos historike dhe tepricës neto në (*formati nr.7/b*) "*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*".
Vlera prej 6,037,127 lekë me kosto historike i përket *projekteve e studimi* për investimet që mund të jenë kryer në objekte të cilat ka përfunduar zbatimi i punimeve e janë marr në dorëzim nga bashkia, pra kjo vlerë duhet të ishte e sistemuar në llogarinë përkatëse të investimit që është përfunduar, si pjesë e kostos totale të objekteve, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", aneksi (1), Klasa (2), pika (2.1), pika (36), paragrafi (4), si dhe me UKM nr.02, datë 08.05.2003 "*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, germa (c), nën germa (b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për sistemimin e llog.(202) "*Studime dhe kërkime*", të paraqesë në këtë llogari vetëm vlerat e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari duhet të pakësohet për vlerën që i shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet.
Nga verifikimi rezulton se:
Nga auditimi i bere per vitin 2021 nga NJAB rezulton se vlera e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" për vitin ushtrimor 2021 është paraqitur Kosto historike ne vlerën 7,100,000 dhe ne fund te vitit ushtrimor kosto historike është ne vlerën 13,137,127 lekë shume kjo e pa evidentuar analitikisht dhe e pa vene ne dispozicion per njësinë e Auditimit te brendshëm . Nuk janë marre masa per sistemimin e vlerës tek investimet e përfunduara.
Per vlerën 6,037,127 sqarimi nga ana e Financës është se janë te mbartura dhe nuk ka dokumentacion. Ndërsa per vlerën qe është shtuar per vitin 2021 ne shumen 7,100,000 lekë sqarohet nga Financa se janë dy projekte investimi te përfunduar nuk ka përfunduar.
Statusi: Në proces

4. Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(**210) "*Toka, Troje, Terrene*",** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 4,918,360 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 4,918,360 lekë vlerë e pandryshuar.
Nga analiza e llogarisë konstatohet se në llogari nuk janë pasqyruar:
a) Vlera e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Prrenjas, përkatësisht me VKM "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Prrenjas, qarku Elbasan*"; i ndryshuar, pasqyrohen jo të plota në kontabilitet për mungesë të vlerës së objektit, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", Kap. II, pika 11, aneksi (1), pika 2, Klasa 2; pika 30.
b) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011"*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kap. IV, pikat 74; 96 *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës. të marrë masa për të pasqyruar në llog,(210) "*Toka, Troje, Terrene"* edhe vlerën e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llog.(212) "*Ndërtime e konstruksione*" të kaluar në pronësi të Bashkisë Prrenjas me VKM njëkohësisht të kryhet inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision inventarizimi.
Nga verifikimi rezulton se:
Per këtë gjetje dhe rekomandim është nxjerre nga Titullari Urdhër përkatës dhe është ngritur Komisioni per marrjen e masave per te pasqyruar me saktësi llogarite 210 "Toka, Troje

terrene" dhe 212 "Ndërtime e konstruksione. Komisioni ka filluar pune me datë 07.02.2022 dhe është ne vazhdim te inventarizimit te AAGJM.
Deri ne periudhën qe raportojmë nuk është konkluduar per zbatimin përfundimtar te këtij Urdhër.
NJAB ka bere Auditimin e AAGJM per vitin 2021 dhe gjendja është po ajo qe paraqitet ne Raportin Përfundimtar te KLSH datë 17.01.2022.

Statusi: Në proces

5.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata. Nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(211) "*Pyje, kullota, plantacione*", në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 17,417,275 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 17,417,275 lekë vlerë e pandryshuar.
Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:
a) Në këtë llogari nuk është e pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Prrenjas me VKM "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkive*", e ndryshuar, veprim në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", Kap. II, Pika 11, aneksi 1,pika 2, Klasa 2.
b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, ndërsa llog.(211) "*Pyje, kullota, plantacione*" nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprime në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011"*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kap.(IV), pikat (74; 96). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektori Juridik dhe Drejtorinë e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, të marrin masa për inventarizimin e pronave, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë në dokumentet kontabël i vlerës së llog.(211) "*Pyje, kullota, plantacione*" të cilat janë në pronësi të Bashkisë Prrenjas.
Nga verifikimi rezulton se:
Per sa i përket gjetjes dhe rekomandimit te llogarisë (211) Pyje, kullota plantacione", Titullari ka nxjerre urdhër nr. 53 datë 01.02.2022 me nr. prot 287 "Per marrjen e masave per inventarizimin e pronave dhe te behet pasqyrimi I sakte ne dokumentin kontabël te llogaris (211) "Pyje ,kullota, plantacione" " Urdhër vihet ne dispozicion i fotokopjuar. Ky urdhër është ne vazhdim te zbatimit Nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria Juridike.
NJAB ka bere Auditimin dhe e ka trajtuar këtë llogari ne përputhje me VKM-n nr. 433 datë 08.06.2016 "Per Transferimin ne Pronësi te Bashkive te Pyjeve dhe te Kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrisë se Mjedisit e te ish Komunave dhe Bashkive.
Konstatojmë se sipas VKM-se se mësipërme ne piken 21 te vendimit, Bashkise Prrenjas i transferohen ne pronësi fonde pyjore dhe kullosore sipas shtojcës 19 bashkangjitur këtij vendimi.
shtojca fillon me nr. rendor 1(nje) dhe mbaron me nr. rendor 1009 (njëmijë e nënte).
Lista e vene ne dispozicion nga ana e Drejtorisë Pyjore fillon me nr. 1(nje) dhe mbaron me nr. 1009(njëmijë e nënte). Sipas listës bashkangjitur ne pronësi te bashkisë Prrenjas janë transferuar 1009 (njëmijë e njëzet e tete)ngastra te specifikuara me :
1.Kodin Kadastral
2.Ekonomine Pyjore dhe Kullosore ku ndodhet
3.Numurin e ngastrës nga 1- 1009
4.Kategorine e ngastrës (Pyje ,Kullota, Shkëmborë)
5.Siperfaqja ne ha. 17997.51
Bashkangjitur këtij relacioni është lista e ngastrave te transferuara nga Ministria e Mjedisit sipas VKM 433 shtojca 19 per Ekonominë Pyjore Bashkia Prrenjas te ndare ne sektorët përkatës sipas tabelave bashkangjitur:

Ekonomia Pyjore Kullosore Mal-Plak sipërfaqja 549.3 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Zall-Liras Xhyre sipërfaqja 267.5 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Lepushe sipërfaqja 2097.58 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Sopot sipërfaqja 1747.46 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Prrenjas sipërfaqja 7660.35 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Stravaj sipërfaqja 2224.78 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Turje sipërfaqja 1410.05 ha
Ekonomia Pyjore Kullosore Polis sipërfaqja 1143 ha
Sipas dokumentacionit te mësipërm ne pasqyrat e Bilancit nuk është pasqyruar vlera reale e llogarisë 211 e Transferuar ne Pronësi te Bashkise me VKM e cituar me sipër . Kjo përbën moszbatim te Udhëzimit te Ministrisë se Financave nr. 8 datë 09.03.2018 " Per procedurat e pregatitjes,paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore te njësive te Qeverisjes"

Statusi: Në proces

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 212, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 587,869,562 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 582,509,776 lekë me diferencë më pakë vlera 5,359,786 lekë e cila përfaqëson shtesë në investime të kryera gjatë vitit në objekte me vlerën 4,046,129 *lekë dhe amortizimi 9,405,915 lekë.*

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime për gjatë periudhës së mëparshme nëpërmjet kryerjes së investimit shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objektit, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet e mirëmbajtje e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen kostos fillestare AAGJM-së. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 4,046,129 lekë për 7 objekte të evidentuar sipas (*Aneksi nr.11*) bashkëlidhur, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", Kap.(II), pika (11), aneksi (1), pika (2), Klasa (2), germa (b).

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", neni (15), pikat (1; 2); UMFE nr. 30, datë 27.12.2011"*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kap.(IV), pikat (74;96) e UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", pika (36), paragraf (4). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>6.1.Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës, të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për këtë llogari, duke shtuar në vlerën e tij fillestare edhe vlerën e shpenzimeve të cilat përbëjnë investim të ri për objektet (*rikonstruksion etj*). Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.

<u>Nga verifikimi rezulton se:</u>

Përsa i përket llogarisë 212 "Ndertesa e konstruksione", është nxjerre nga titullari ne zbatim te rekomandimeve te KLSH, urdhër nr. 54 datë 01.02.2022 me nr. prot 288 "Per marrjen e masave per sistemimin e llogarisë (212) "Ndertesa e Konstruksione" dhe ngritjen e komisionit per inventarizimin e Aktiveve Afatgjata material (AAGJM).

Sa i përket zbatimit te këtij Urdhër mundet te themi te njëjtat gjera qe thamë per llogarinë 210 Komisioni i ngritur ka filluar punën per inventarizimin dhe regjistrimin e llogarisë 212 por nuk është konkluduar ne rezultat përfundimtar. NJAB gjate Auditimit te llogarisë 212 Ndërtime e konstruksione ka dale ne konkluzionin se nuk ka nje llogarisë me te mire llogaris Drejtorisë se Finance, Drejtorisë se Urbanistikes e cila disponon nje liste te AAGJM me vendimin e Këshillit te Qarkut Elbasan te vitit 2007 per llogarisë pronave te Njesive Vendore

Per këtë NJAB ka kryer auditim per llogarisë 2021 dhe ka konstatuar nje sere shkeljesh te cilat I ka paraqitur ne projekt raport dhe raportin e llogarisë. Per këtë llogari nuk ekziston Regjistrit Kontabël si per te gjitha llogarite e tjera te AAGJM. Komisioni është ne vazhdim te procesit per sistemimin e 116llogarisë 212 Ndërtime e konstruksione.

Statusi: Në proces

7. Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(213)"*Rrugë, rrjete vepra ujore*" në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 615,396,071 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 809,197,990 lekë me diferencë në shtesë vlera *193,801,919 lekë* e cila përfaqëson investime të kryera për gjatë vitit 2020 në rrugë, rrjete e vepra ujore në 23 objekte me vlerë 217,336,664 lekë, dhe amortizimi në vlerën 23,534,745 lekë.
Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM-ve me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", neni 15, pikat 1 dhe 2; UMFE nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kap.(IV), pika 74 dhe 96; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", pika 36, *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës, të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për këtë llogari, duke shtuar në vlerën e tij fillestare vlerën e shpenzimeve të cilat përbëjnë investim të ri për secilin objekt. Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). Në përfundim të punës komisioni të hartojë relacion për titullarin për rezultatet e inventarizimit.
Nga verifikimi rezulton se:
Te njëjtën gjë themi dhe per Llogarinë 213 "Rruge ,rrjete, vepra Ujore nuk ekziston pasqyrimi i sakte ne dokumentet kontabël te vlerës per secilin aktiv nuk ka nje regjistër ku te jene te pasqyruar te gjitha këto aktive me rubrikat përkatëse, Komisioni është ne vazhdim te përmbushjes te udhërit te Titullarit per inventarizimin dhe regjistrimin e këtyre AAGJM.

Statusi: Në proces

8. Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatshkurtër, nën/rubrika, të tjera aktive afatshkurtër, gjendja në llog.(486) "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë 0 (zero) lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 39,012,416 lekë me diferencë më tepër *39,012,416 lekë* e cila përfaqëson shtesë për detyrime të prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Prrenjas.
Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se detyrimet e prapambetura nuk janë raportuar në PF të vitit 2019 ku nga testet e detajuara rezultojnë detyrime ndaj OSHEE në shumën progresive 12,908,599 lekë, detyrime ndaj të tretëve për investime të FSHZH në shumën 22,807,737 lekë dhe një vendim gjyqësor i vitit 2019. Në bazë të testeve të detajuara rezulton se llogaria 486 sa trajtuar më sipër nuk korrespondon me llogarinë kundërparti tek pasivi i bilancit, llogaria 467 "Kreditor të ndryshëm" e cila paraqitet më 31.12.2020 në shumën 46,681,418 lekë për pasojë është nënvlerësuar për shumën 7,669,002 lekë nga të cilat 22 fatura të palikujduara në shumën 7,773,658 lekë të cilat nuk janë raportuar me arsyen se kanë lindur në muajin dhjetor 2020 dhe shuma tjetër prej 104,656 lekë pa adresim e mbartur në vite në librat e llogarisë, veprime në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap.(III), pikat (30; 50). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës, të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së faturave të prapambetura të palikujduara si dhe të analizohet situata për shumën 104,656 lekë e cila figuron e mbartur në librat e llogarisë.

Nga verifikimi rezulton se:
Sa i përket gjetjes dhe rekomandimit te mësipërm sqarojmë se per shumen 104,656 lekë, Bashkia Prrenjas i ka kërkuar Drejtorisë se Thesarit Librazhd me shkrese nr. prot 124 dhe nr. 124/1 heqjen e detyrimit te prapambetur per vlerat 3,600 lekë, blerje materiale hidraulike 2017 dhe vlera 89,273 lekë supervizimi punimesh ne objektin "Shpenzime per lyerje e meremetim,dizinfektim ambiente te bashkisë Prrenjas. Fatura nr. 170 per operatorin ekonomik "M.O" shuma e hequr nga Detyrimet e prapambetura është 104656 lekë – 3600 lekë – 89273 lekë =11783 lekë detyrime sipas kontratës te mbetura per likujdim dhe te pasqyruara ne detyrimet e prapambetura per vitin 2021.

Statusi: Zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(**215) "*Mjete transporti*",** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 21,054,465 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 37,491,960 lekë me diferencë shtesë për 16,000,000 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe peksimet nga amortizimi për periudhën raportuese.
Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:
- Në llog.(215) "*Mjete transporti*" është pasqyruar edhe vlera për 14 mjete transporti në gjendje teknike jashtë përdorimit të dëmtuara të cilat është kryer kontabilizim i gabuar në llog.(215)"*Mjete Transporti*" dhe përllogaritur amortizimi vjetor. Për këto 14 mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, ndërsa janë të dëmtuara vlera e tyre duhej të ishte e regjistruar dhe kontabilizuar në llog.(24) "*Aktive afatgjata të dëmtuara*" me analizë për çdo mjet e cila mbetet për tu sistemuar në pasqyrat e vitit ushtrimor pasardhës, në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes së Përgjithshme*", Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa (e); pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për sistemimin e veprimeve për AAGJM dhe inventarizimi fizik për evidentimin e 11 (*njëmbëdhjetë*) mjeteve të transportit të dëmtuar (AAGJM), duke kredituar llog.(215) "*Mjete Transporti*" dhe debituar llog.(24) "*Aktive afat gjata të dëmtuara*" në vlerën 11,955,191 lekë.
Nga verifikimi rezulton se:
Per gjetjen dhe rekomandimin e mësipërm sqarojmë se NJAB ka ushtruar kontroll per llogarinë 215 "Mjete Transporti" dhe ekziston lista me 25 automjete me vlerat përkatëse vitin e blerjes amortizimin. Gjate auditimit te llogarisë ne pasqyrat e Bilancit te 2021 konstatojmë se ne llogarinë 215"Mjete Transporti" është pasqyruar vlera per 25 mjete transporti me argumentimet përkatëse. Nuk kreditohet llogaria 215 per automjetet e pretenduara te dëmtuara ne vlerën 11,955,191 lekë dhe nuk debitohet llogaria 24 "AAGJ te dëmtuara kjo sipas rekomandimit te KLSH. Drejtoria e Financës ne bashkëpunim me Sektorin e Transportit nuk ka bere analizën e duhur per gjendjen reale te mjeteve.

Statusi: Zbatuar
10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se gjendja në llog.(**4342) "*Operacione me shtetin të drejta*",** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 90,909,558 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 me vlerë 80,758,369 lekë me diferencë më pak në vlerën prej 10,151,189 lekë. Duke bërë krahasimin me detyrimet koresponduese në pasiv të bilancit rezulton si vijon:
1-*detyrime të pasqyruara në llog.(42)"Detyrime ndaj personelit" në vlerën 11,502,091 lekë.*
2-*detyrime të pasqyruara llog.(435)"Sigurime shoqërore" në vlerën 3,347,689 lekë.*
3-*detyrime të pasqyruara në llog.(436) "Sigurime shëndetësore" në vlerën 464,638 lekë.*
4-*detyrimet të pasqyruara në llog.(431)"Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa" në vlerën 549,802 lekë.*

***5**-detyrime të pasqyruara në llog.(401-408)"Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 87,197,038 lekë.*
Në total këto 5 llogari të analizuara hollësisht të pasqyruara në pasiv të bilancit për këtë periudhë raportuese ushtrimore janë me vlerë 103,061,258 lekë, më shumë në vlerën 22,302,889 lekë, për pasojë llogaria "*kundër parti*" e pasqyruar në aktiv të bilancit Llog.(4342) "*Të tjera operacione me shtetin (të drejtat)*" është nënvlerësuar me shumën **22,302,889 lekë** e paargumentuar, veprime në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap.(III), pikat (30; 50). *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 39-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Financës, të marrë masa për të evidentuar vlerën 22,302,889 lekë dhe saktësuar llogarinë (4342) me qëllim pasqyrimin e saktë të detyrimeve me shtetin.
Nga verifikimi rezulton se:
Sa i përket gjetjes dhe rekomandimit per llogarinë 4342 "Te tjera operacione me shtetin(te drejta), Përgjegjësi i Financës sqaron se shuma 22,302,889 lekë e paargumentuar është sistemuar dhe argumentuar sipas rekomandimeve te lëna nga KLSH.

Statusi: Zbatuar

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike me objekt *"Rikonstruksion i rrugës së brendshme nga rruga Minatori deri tek rruga Blerimi"* nr. 2160 Prot., datë 24.07.2019, me vlerën 2,400,864 lekë, lidhur midis Bashkisë Prrenjas dhe OE "S.K" SHPK rezultoi se trashësia e pllakave është me dimensione më të vogla se ato të deklaruara. Numri i saktë i pllakave të cilat nuk janë sipas projektit, nuk mund të kalkulohet nga grupi i auditimit. *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 52-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
11.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik të analizojë situatën e dorëzimit me vonesë të punimeve, të evidentojë përgjegjësitë dhe të kërkojë nga OE "S.K" SHPK ndërrimin e pllakave me dimensione më të vogla dhe vendosjen e pllakave me dimensione sipas projektit.
Nga verifikimi rezulton se:
Per këtë rekomandim sqarojmë se ekziston nje proces verbal i mbajtur me datë 18.04.2022 ne zbatim te udhërit nr. 205 datë 27.03.2022 te Drejtorisë se Planifikimit Zhvillimit te territorit dhe aplikimit te projekteve 'Per ngritjen e Komisionit per analizimin dhe vlerësimin e observacioneve te dërguara nga OE S.K shpk per objektin "Rikonstruksion I Rrugës se brendshme nga rruga Minatori deri tek Rruga Blerimi"

Statusi: Zbatuar

B- MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese viti 2020 u konstatua se janë krijuar detyrime të pa likuiduara debitorë për vitin 2020 me progresive vlera totale prej *47,898,097 lekë* të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore Bashkia Prrenjas, detyrime nga subjekte ekonomik dhe familjare për mos likujdim të nivelit të taksave e tarifave etj. si dhe të taksës së tokës. Mos arkëtimi i detyrimeve për nivelin e taksave e tarifave vendore, përveç se është mos përputhje me detyrën funksionale nga punonjësit e Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore, njëkohësisht krijon mungesë financiare në treguesit në buxhet me pasojë ulje e nivelit të investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në shërbim të komunitetit, të evidentuara në ***(anekset nr.***

4, 5, 6) bashkëlidhur. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore*" i ndryshuar; nenet (4; 26; 32; 34) të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", nenet (70; 91) Kreu (XI) "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore*" të ligjit nr.9920 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar; ligjin nr.10926, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; neni (12) i UMF nr.24, datë 02.09.2008 dhe UMF nr.01, datë 17.01.2019 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019*". *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 9-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1-Rkomandimi: -Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara debitorë progresivit për vitin 2020, nga mos pagesë e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi, si dhe subjekte familjar me vlerë prej *47,898,097 lekë* dhe mos programim, mos përllogaritje dhe mos realizim i detyrimeve të lindura nga niveli për taksën e tokës, apo debitor të tjerë ndaj njësisë publike vendore Bashkia Prrenjas.

Nga verifikimi rezulton se:

Në lidhje me rekomandimet e lëna nga KLSH për gjendjen debitore të biznesit të madh, të vogël dhe subjektet familjare per subjektet e karburantit , ujë Kopështi/ çerdhe , legalizime janë marrë këto masa :

2- Nga drejtoria e të Ardhurave është dërguar "Urdhër – Bllokim llogarie bankare me nr.3490 prot datë 28.12.2021 për B. Vogël në qytetin Prrenjas per 70 subjekte, në Njësite ADM Rrajce per 40 subjekte dhe per njësinë Qukës 25 subjekte debitore. Per biznesin e madh janë bere Urdhër Bllokime per 15 subjekte me nr. Protokolli 61, 87, 86, 81, 82, 76, 77, 85, 83, 74, 79, 78, 80, 73, 75, datë 14.01.2022.

Nga drejtoria e të Ardhurave është dërguar "Kërkesë për Shlyerje detyrimesh "shkresa me nr.319 prot datë 03.02.2022

- *e- Për 93 subjekte B. Vogël në qytetin Prrenjas ku nga këto vlera e arkëtuar është = **668,662 lekë.***
- *f- Për 32 subjekte Biznes i vogël Njësia ADM Qukës ku vlera e arkëtuar është **= 136,005 lekë***
- *g- Për 42 subjekte B. Vogël Njësia ADM Rrajce ku vlera debitore e arkëtuar është = **238,593 lekë**.*
- *h- Detyrime biznesi i madh arkëtuar në shumën 1,923,793 lekë*

Per taksat dhe tarifat vendore nga subjektet familjare te cilët rezultojnë debitor ne 31.12.2022 janë bere këto arkëtime :

*Per familjaret qyteti Prrenjas nga shuma debitore janë arketuar 1,508,114 lekë; per familjaret Njësia Adm Rrajce nga shuma debitore janë arketuar 705.754 lekë; per familjaret Njësia Adm Stravaj nga shuma debitore janë arketuar 56.393 lekë; p**er** familjaret Njësia Adm Qukës nga shuma debitore janë arketuar 138,023 lekë; per abonentët e qyteti Prrenjas janë arketuar tarife uji 341,722 lekë; per abonentët e njësisë Rrajce janë arketuar tarife uji 1,348,026 lekë; per abonentët e njësisë Qukës janë arketuar tarife uji 837,664 lekë dhe per abonentët e njësisë Stravaj janë arketuar tarife uji 46,054 lekë*

Në total si rezultat i masave të marra nga vlera e detyrimeve prej 47,898,097 lekë është likujduar vlera 7,948,763 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 39,949,334 lekë.

Statusi: Në proces

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që është administruar në dosjen fizike të secilit operator ekonomik u konstatua se, Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore për 11 OE që tregtojnë në pikë fundore karburant dhe 1 OE që tregton në pikë fundore gaz të lëngshëm, nuk ka të administruar e dokumentuar autorizimin bazë dhe afatin e rinovimit të autorizimit, nuk ka të evidentuar saktësisht vlerën e arkëtuar në momentin e pasjes me autorizimin bazë, apo rinovimin në periudhën objekt auditimit, çka ka sjellë të ardhura të munguara në shumën ***5,091,850 lekë*** të

pa programuara në buxhetin e Bashkisë Prrenjas, veprim në mospërputhje me -neni 35, i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar; Kap.(II); Kap.(III), pika 4: Kap (II), pika (1), germa (b); pika (15) e VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*" i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 "*Për ndryshimin e VKM nr.970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto e nën produkteve të saj*".*(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 24-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave të analizojnë situatën, të marrin masa të menjëhershme për të pajisur, apo rinovuar me (*licencë/autorizim*) me afat 5 (*pesë*) vite kalendarik, operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi me veprimtari tregtim në stacione karburanti e gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë në territorin e bashkisë Prrenjas, ndërkohë që këta OE nuk janë të pajisur me (*licencë/autorizim*), ndërsa nga mos administrimi i autorizimit bazë, apo rinovimit të autorizimit të parashikuar në paketën fiskale viti 2020, ka sjellë mos pagesë të nivelit të tarifës përkatëse, për pasojë shuma e përllogaritur prej ***5,091,850 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.***

Nga verifikimi rezulton se:

Kanë bërë likujdimet dy subjekte, konkretisht subjekti "K." shpk për vlerën 867,051 lekë (datë 8.2.2022) dhe nga subjekti "G.R" shpk për vlerën 778,917 lekë (datë 28.2.2022. Në përfundim nga shuma 5,091,850 lekë likujduar vlera 1,645,968 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 3,445,882 lekë

Statusi: Në proces

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Prrenjas, nuk ka përllogaritur e aplikuar nivelin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për 10 operatorë ekonomik që kanë kryer punë publike në territorin e bashkisë e njësitë administrative në vartësi, të cilët me bashkinë Prrenjas kanë lidhur 10 kontrata për punë publike, ndërsa përpara fillimit të punimeve këta OE nuk kanë aplikuar në QKB për të hapur në vendin e ushtrimit të veprimtarisë (*sipas vendndodhjes së objektit të kontratës*) vend i ndryshëm nga selia e OE, për pasoj këta OE nuk janë ngarkuar me detyrime për nivelin e tarifave të pastrimit, gjelbërimit e ndriçimit për veprimtarinë në vendndodhjen e objektit të kontratës, të miratuara me paketën fiskale. Përllogaritja e detyrimeve për nivelin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit e ndriçimit në periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 sipas afatit të kontratës së punë publike të evidentuara (*NIPT sekondar*) detyrimet paraqiten në vlerën 126,250 lekë, veprime në mospërputhje me Kreu (VII), neni 35; pika (1/1), neni 43, të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar; UMF nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar dhe *VKB "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore (paketa fiskale) vit 2020"*. *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 28-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi e mos zbatimi i nivelit për tarifat vendore nga 6 OE me seli brenda apo jashtë territorit të bashkisë Prrenjas, të cilët ushtrojnë aktivitet për kontratat e lidhura për punë publike nga fondet për investime në bashkinë Prrenjas, për pasojë shuma ***161,250 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.***

Nga verifikimi rezulton se:

Për subjektet të cilat nuk kanë pasuar detyrimin në shuëmn161,250 lekë, nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore janë marra masa për bllokim të llogarive.

Me shkresën nr.111 prot datë 18.01.2022 per subjektin "H.I" shpk i cili ka bere pagesën me nr.08 fature datë 19.01.2022 në shumën ***15,622 lekë***

Me shkresën nr. 116 prot datë 18.01.2022 per subjektin "J.O" shpk i cili ka bere pagesën me nr.mandati730 datë 31.01.2022 ***me vlerën 3,130 lekë.***

Me shkresën nr. 118 prot . datë 18.01.2022 njoftuar subjekti "SH." nuk ka bere pagese.
Me shkresën nr. 112 prot dhe 113 prot datë 18.01.2022 njoftuar subjekti N.I shpk ka bere pagese per faturën nr. 3 datë 29.03.2022 ***ne vlerën 12,490*** *lekë dhe per faturën nr.2 Datë 29.03.2022 ne vlerën* ***10,935 lekë*** *.*
Në total nga shuma 161,250 lekë është likujduar shuma 42,177 lekë, duke mbetur për likujdim vlera ***119,073 lekë.***

Statusi: në proces

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Prrenjas kryejnë aktivitet tregtar në fushën minerare operator ekonomik të cilët kanë marr në përdorim sipërfaqe nga fondi pyjor/kullosor me të dhënat e pasqyruar në *aneksin nr. 7* bashkëlidhur. Nga të dhënat e pasqyruara në aneksin përkatës rezulton se, Bashkia Prrenjas administron 15 dosje me kontrata të lidhura me operator ekonomik për sipërfaqen e kontraktuar ku në raportin teknik të vlerësimit pjesë integrale e kontratës është përllogaritur vlera e qirasë detyrim i operatorit ekonomik për të arkëtuar çdo vit kalendarik për ha. Nga të dhënat e pasqyruara në aneksin përkatës për periudhën deri në datën 30.12.2020 rezulton se, Bashkia Prrenjas nga kontratat e lidhura për dhënie në përdorim me qira e sipërfaqes fondi pyjor/kullosor ka realizuar të ardhura në vlerën *1,552,876 lekë*, ndërkohë që referuar në përllogaritjen e raportit teknik të vlerësimit dhe në përllogaritjen e nivelit të tarifës për Ha/vit e parashikuar me VKM nr.391, datë 21.06.2006 "*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave*" i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 "*Për ndryshimin e VKM nr.391, datë 21.06.2006*", rezulton diferencë e pa arkëtuar në vlerën prej ***1,109,177 lekë e konsideruar e ardhur e munguara e pa programuar për buxhetin e bashkisë***, *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 30-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Prrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar likuidimin nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve të pajisur me leje minerare brenda territorit të Bashkisë Prrenjas, për detyrimin e qirasë në kontratat e lidhura për sipërfaqen në përdorim nga fondi pyjor/kullosor me pasojë ***të ardhura të munguar të pa programuara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas në vlerën prej 1,109,177 lekë.***
-Njëkohësisht Titullari Bashkisë Prrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të verifikuar në terren dhe për të administruar të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor e cila sipas të dhënave në regjistrin e AKBN-së është në përdorim nga 111 OE.
Nga verifikimi rezulton se:
Deri në datën e mbajtjes së aktverifikimet, nga shuma e rekomanduar prej 1,109,177 lekë është arkëtuar vlera 953,719 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 155,458 lekë.
Me shkresën nr. 537, datë 16.2.2022 dhe në zbatim të rekomandimit të KLSH është kërkuar informacion pranë AKBN mbi subjektet që operojnë në këtë njësi vendore. Me shkresën nr. 1011/1, datë 24.2.2022 AKBN informon Bashkinë Prrenjas se në territorin e kësaj njësie vendore operojnë 19 shoqëri për shfrytëzim kariere dhe HEC, ku 2 prej tyre janë me pezullim të përkohshëm.

Statusi: Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën raportuese ushtrimore deri në datën 31.12.2020, nga Bashkia Prrenjas janë realizuar të ardhura nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor, aset publik në pronësi të bashkisë, nëpërmjet kontratave të qirasë të lidhura me operatorët ekonomik subjekte juridik privat për ndërtimin e HEC-ve. Kontratat janë administruar nga Drejtoria e Monitorimit të Pyjeve e Kullotave, ndërsa realizimi i të ardhurave nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ku niveli i të ardhurave me vlerën e qirasë është përcaktuar qartësisht në raportin teknik të vlerësimit pjesë integrale e kontratës, me arkëtim të detyrimit e cili duhet të bëhet çdo vit kalendarik me hollësi për secilën kontratë me të dhënat në *aneksin nr. 9.* Nga procesi i auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion në lidhje me procedurën e realizimit të ta

ardhurave nga zbatimi i nivelit të tarifave në kontratat e lidhura mbi të dhënave të analizuara në aneksin përkatës u konstatua se Bashkia Prrenjas nga dhënia në përdorim e fondit pyjor/kullosor në pronësi të bashkisë, ka lidhur gjithsej 6 kontrata qiraje me operatorë ekonomik për ndërtim të HEC-ve, ku referuar në kushtet e kontratave dhe në vlerën e qirasë e përcaktuar në raportin teknik të vlerësimit pjesë përbërëse integrale e kontratës, Bashkia Prrenjas për çdo vit kalendarik nga data e lidhjes së kontratës deri në datën 31.12.2020 duhej të kishte realizuar të ardhura shtesë në vlerën prej *3,929,920 lekë*.
Në këto kushte si pasojë e mos arkëtimit të plotë nga operatorët ekonomik të detyrimit për çdo vit kalendarit të nivelit të tarifës së qirasë për secilën kontratë për periudhën deri në datën 31.12.2020 rezulton diferencë e pa arkëtuar shuma prej ***3,929,920 lekë shumë e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Prrenjas,*** si pasojë e mos përllogaritjes, mos aplikimit të saktë dhe mos arkëtimit të nivelit të tarifës e parashikuar në raportin teknik të vlerësimit pjesë përbërëse e kontratës, veprime në mospërputhje me VKM nr.391, datë 21.06.2006 "*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave*" i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 "*Për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave*", pika (2), lidhja (11;12). *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 33-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Prrenjas, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave e Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysheme për dhënë në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE-it në territorin e bashkisë Prrenjas, për të cilin ka rezultuar diferencë në përllogaritje, vlerësim dhe pagesë me ***vlerën 3,929,920 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për buxheti Bashkisë Prrenjas.***
Nga verifikimi rezulton se:
Deri në datën e mbajtjes së aktverifikimet, nga shuma e rekomanduar prej 3,929,920 lekë është arkëtuar vlera 2,249,509 lekë, duke mbetur për likujdim vlera 1,680,411 lekë.

Statusi: Në proces zbatimi

6.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e evidentuara në pasqyrën përkatëse, faqe 36 e raportit, për periudhën raportuese viti 2020 rezulton se, në territorin e bashkisë kanë kryer ndërtime pa leje (*in formale*) të legalizuara nga Drejtoria ALUIZN-it 9 subjekte familjar të cilët nuk kanë kryer likuidimin e detyrimit për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën *592,197 lekë.*
Në këto kushte vlera prej ***592,197 lekë konsiderohet e ardhur e munguar e pa kontabilizuar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas***, veprime në mospërputhje me neni 23 të ligji nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" i ndryshuar me ligjin nr.9786, datë 19.07.2007; ligjin nr. 9895, datë 09.06.2008; ligjin nr.10099, datë 19.3.2009; ligjin nr.10169, datë 22.10.2009; ligjin nr.10219, datë 04.02.2010; ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013; ligjin nr.50/2014 dhe ligjin nr.62/2015; Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 02.02.2009; me pika 2, neni 27, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar; ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore*" i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje e vlerave të zbatueshme për legalizim*" i ndryshuar. *(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.1, faqe 35-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore të analizojë situatën, të marrin masa të menjëhershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale *(pa leje*) të kryera nga subjekte ekonomik dhe subjekte familjare në territorin e Bashkisë Prrenjas e parashikuar në paketa fiskale me pasojë shuma prej ***592,197 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.***
Nga verifikimi rezulton se:
Deri në datën e mbajtjes së aktverifikimet, nga personat përgjegjës nuk është arkëtuar asnjë

vlerë.

Statusi: Pa zbatuar

D. <u>MASA DISIPLINORE:</u>

D/I. <u>Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin për Nëpunësit Civil:</u>
Mbështetur në neni 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", germat (b;c;ç) dhe nenin 58"*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", në VKM nr.115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*" dhe shkronja (k) neni (64), të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015"*Për vetëqeverisjen vendore*", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Prrenjas** që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020 dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për ***4 (katër) punonjës***, si më poshtë:

1-S.K., me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimit Social.
2-A.B., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit dhe Financës.
3-Z.C., me detyrë Specialist në Sektorin e Transportit dhe Parkingjeve.
4-B.K, me detyrë Specialist i Buxhetit.

D/II. <u>Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.</u>
Mbështetur në neni 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, shkronja (e) dhe (ç) të nenit (11), Kreu (IV) dhe neni (37) të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Prrenjas,** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për ***12(dymbëdhjetë) punonjës***, si më poshtë:

1-J.B, me detyrë Drejtor i të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.
2-E.D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.
3-R.D, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore.
4-E.D, me detyrë Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore, NJA Rrajcë.
5-**L.K**, me detyrë Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore, NJA Qukës.
6-M.V, me detyrë Specialist Finance.
7-L.L, me detyrë Drejtor i Pyjeve dhe Kullotave.
8-S.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Regjistrimit DPK.
9-N.D, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Aseteve dhe Mbrojtjes Civile.
10-M.B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Aseteve.
11-R.B, me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit.
12-G.A, me detyrë Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.
<u>Nga verifikimi rezulton se:</u>
1.Urdher nr. 323 datë 25.5.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte", S.K.
2.Urdher nr. 325 datë 27.5.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte", Z.C.
3.Urdher nr. 326 datë 27.5.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte", A.B.
4.Urdher nr. 327 datë 27.5.2022 'Per dhënie mase disiplinore " Vërejte", B.K.
5.Urdher nr. 166 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim", E.D.
6.Urdher nr. 167 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" E.D.
7.Urdher nr. 168 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" S.H.
8.Urdher nr. 169 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" R.D.

9.Urdher nr. 170 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" R.B.
10.Urdher nr. 171 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" M.B.
11.Urdher nr. 172 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" M.V.
12.Urdher nr. 173 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" L.L.
13. Urdhër nr. 174 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" L.K.
14.Urdher nr. 175 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" J.B.
15.Urdher nr. 176 datë 10.03.2022 'Per dhënie mase disiplinore "Vërejte me shkrim" G.A.

Statusi: Zbatuar

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore) pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë*:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Nga verifikimi rezulton se:

Nga Bashkia Prrenjas nuk është njoftuar Departamenti i Administratës Publike dhe Komisonerit Civil.

Statusi: Pa zbatuar

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT